

# Raiffeisen Bank Albania

Annual Report 2013

# WEL

Corporate Social Responsibility is very important for Raiffeisen Bank. It is part of the corporate culture therefore the bank through sponsorship has supported a large number of projects, which aim the improvement of the social, health and environmental conditions of the community in Albania. The projects supported by Raiffeisen Bank during 2013 have been diverse and always in accordance with its sponsorship policy.

Përgjegjësia Sociale është shumë e rëndësishme për Raiffeisen Bank. Ajo është pjesë e kulturës së korporatës prandaj dhe Banka nëpërmjet sponsorizimeve ka mbështetur një numër të madh projektsh, të cilat synojnë përmirësimin e kushteve sociale, shëndetësore dhe mjedisore të komunitetit në Shqipëri. Projektet e mbështetura nga Raiffeisen Bank gjatë vitit 2013 kanë qenë të larmishme dhe gjithmonë në përputhje me politikën e sponsorizimeve të saj.

# COME



# **Raiffeisen Bank Albania**

**Raport Vjetor 2013**

# Përmbajtje

<b>Raporti i Bordit Mbikqyrës</b>	<b>116</b>
<b>Mesazh nga Drejtori Ekzekutiv</b>	<b>117</b>
<b>Misioni</b>	<b>118</b>
<b>Perspektivat dhe Planet për vitin 2014</b>	<b>119</b>
<b>Raporti i Bordit Drejtues</b>	<b>122</b>
Zhvillimet Ekonomike	122
Rezultatet Financiare	123
<b>Raporti i Segmenteve</b>	<b>130</b>
Segmenti Korporatë	130
Biznesi i Vogël (SE)	131
Divizioni i Produkteve Korporatë dhe SE	131
Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve	133
Divizioni i Produkteve	134
Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Elektronik	135
Kanalet e Shpërndarjes	136
<b>Thesari dhe Bankingu i Investimeve</b>	<b>138</b>
Të ardhurat fikse	138
Tregu i parasë	138
Këmbimet Valutore	139
Njësia e Shitjeve	139
<b>Përgjegjësi Sociale</b>	<b>142</b>
<b>Burimet Njerëzore dhe Trajnimet</b>	<b>144</b>
<b>Raporti i Audituesit të Pavarur</b>	<b>151</b>
<b>Raiffeisen Leasing</b>	<b>208</b>
<b>Rreth Raiffeisen INVEST Sh.a</b>	<b>210</b>
<b>Një vështrim mbi Raiffeisen Bank International</b>	<b>212</b>
<b>Zhvillimi i RBI-së</b>	<b>214</b>
<b>Rrjeti i Raiffeisen Bank Sh.a</b>	<b>215</b>
<b>Adresa dhe Kontakte</b>	<b>216</b>
<b>Fjalori Raiffeisen</b>	<b>219</b>





Antarët e Bordit Drejtues të Raiffeisen Bank Sh.a

**Christian Canacaris**

Drejtor i Përgjithshëm

**Raphaela Bischof-Rothauer**

Anëtar Bordi për Operacionet dhe TI

**John McNaughton**

Anëtar Bordi për Retail

**Alexander Zsolnai**

Zëvendës Drejtor i Bordit Drejtues

# Raporti i Bordit Mbikqyrës

Zonja dhe Zotërinj,

Pas vitesh, me rritje të ulët ose negative, më në fund viti 2013 tregoi shenjat e para të rimëkëmbjes ekonomike në zonën e euros si dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore. Ne pamë gjithashtu zhvendosje të rritjes ekonomike në Evropën Qendrore ku Polonia, Republika Çeke dhe Sllovakia morrën një rol udhëheqës në rajon. Gjithashtu vendimet politike të marra për të ardhmen e Bankave të Bashkimit Evropian i dhanë më tepër qartësi sektorit bankar në Evropë. Megjithatë mjedisi ekonomik mbetet i vështirë për bankat. Veçanërisht kërkesat për rritjen e kapitalit në afat-shkurtër dhe rregulloret shumë komplekse, si psh taksat bankare, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një barrë për kufizimet në kredidhënie për bankat kryesore.

Në vjeshtë të 2013, Grupi RBI prezantoi programin "Fit for Future 2016" me qëllimin për të ulur nivelin e kostove nga 2012 deri në vitin 2016. Kjo do të thotë që për tre vitet në vazhdim do të kompensojmë inflacionin dhe do të kursejmë rreth 450 milionë Euro në total. Ne jemi krenar për rezultatet e arritura me rritjen e kapitalit me rreth 2.78 miliard Euro. Rritja e kuotave të lira në treg i bëri aksionet tona edhe më tërheqëse si për investitorët privat dhe për insitucionet. Këto procedura do të përdoren për të arritur objektivat tona, për 12 deri në 18 muaj, për të arritur një fazë të plotë në Bazel III CET në raportin 1 nga 10 për qind deri në fund të periudhës së tranzicionit. Këto veprime u ndërmorrën për të mbështetur modelin tonë të suksesshëm të biznesit në rajon dhe për të garantuar një zhvillim të qendrueshëm të Grupit në këtë ambient sfidues. Prandaj, Grupi RBI është krenar të publikojë një fitim para tatimit prej 835 milionë eurosh.



Për sa i përket Raiffeisen Bank Sh.a, jam krenar të them se pavarësisht një viti mjaft të vështirë ne arritën të implementojmë me sukses sistemin e ri bankar duke mbajtur raportin kosto të ardhura nën 40 përqind, një rezultat të cilin e vlersojmë mjaft duke marrë parasysh kushtet. Në të njëjtën kohë kompania e manaxhimit të aseteve pati një vit mjaft të mirë duke arritur 360 milionë Euro në asete.

Më lejoni të përfitoj nga kjo mundësi për të falenderuar të gjithë punonjësit e Raiffeisen Bank në Shqipëri për punën e tyre të vazhdueshme në një ambient sfidues dhe për përpjekjet e tyre të vazhdueshme për t'i shërbyer klientëve tanë dhe për të sjellë përfitime në të gjithë Grupin Raiffeisen.

Në emër të Bordit Mbikqyrës,

Helmut Breit, Kryetar



# Mesazh nga Drejtori Ekzekutiv

Kemi kënaqësinë tju njoftojmë se Raiffeisen Bank Sh.a ka mbyllur me sukses vitin financiar 2013. Jam veçanërisht krenar për këtë pasi gjatë vitit 2013 ne u përballëm me shumë sfida.

Megjithatë falë bashkëpunimit të të gjithë segmenteve të biznesit ne arritëm objektivat tona dhe konsoliduam edhe më tepër pozicionin tonë lider në të gjithë treguesit kryesorë. Tani jemi gati për vitin 2014. Më tepër se 700,000 klientë në mbarë vendin, të cilëve u ofrojmë një gamë të gjerë produktesh kursimi, kredie dhe pagesa, kanë besim tek ne.

Pavarësisht mjedisit të vështirë ekonomik në Shqipëri, ku i gjithë tregu bankar është ka pësuar rënie prej 1.8 përqind në kredi krahasuar me një vit më parë, Raiffeisen Bank mbetet e para në treg. Në përgjigje të këtyre kushteve të vështira ne përmirësuar proceset dhe shërbimet duke e bërë bankën tonë më eficiente dhe ulëm raportin kosto të ardhura me 39.69 përqind në vitin 2013.

Ne vazhduam fokusin tonë në përmirësimin dhe zgjerimin e gamës së shërbimeve dhe produkteve që i ofrojmë klientëve tanë gjatë vitit. Gjatë vitit 2013, ne prezantuam një shërbim të ri i quajtur M-Pay. Ky është një shërbim tërësisht i ri dhe inovativ për tregun shqiptar i cili u prit shumë mirë nga shumë klientë. Sëbashku me internet dhe mobile banking, M-Pay i lejon klientët tanë të hynë në llogarinë e tyre dhe të kryejnë transaksione 24 orë në ditë në shtatë ditë të javës, kudo që ndodhen.

Për më tepër, Raiffeisen Leasing vazhdon të jetë zgjedhja e preferuar si për bizneset edhe për individët, të cilët kërkojnë financim në makineri, paisje, makineri transporti dhe makina. Kjo kompani renditet e para në tregun e lizingut në Shqipëri.

Përveç kësaj, Raiffeisen Invest është kompania e vetme e licënuar në tregun shqiptar që ofron treg për fondin e investimeve, e cila gjithashtu ofron për bizneset dhe individët produktin e fondit privat të pensioneve. Vitin e kaluar ne prezantuam dy fonde investimi përkatësisht në euro dhe në lekë. Të dyja ishin në të gjithë treguesit të suksesshme. Në vitin 2014, ka ende sfida të cilat qëndrojnë para nesh dhe ne do të duhet të punojmë shumë për të arritur objektivat tona. Megjithatë, punonjësit tanë janë të mirë trajnuar, të fokusuar dhe të vendosur që Raiffeisen Bank Sh.a të mbetet numri një në sektorin bankar vendas.

Së fundi, në emër të bordit drejtues, do të doja të falenderoja sinqerisht të gjithë punonjësit tanë, klientët dhe bizneset partnere për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre gjatë vitit 2013 dhe unë pres që viti 2014 të jetë një tjetër vit tepër i suksesshëm.



Christian CANACARIS  
Drejtor Ekzekutiv

# Misioni

Ne rrisim standartet bankare dhe bëjmë ndryshimin në jetën e konsumatorit duke ofruar produkte konkurruese dhe shërbime me cilësinë më të mirë.

Ne kërkojmë marrëdhënie afatgjata me klientët.

Si anëtare e Raiffeisen Bank International, ne bashkëpunojmë ngushtë me RBI-në dhe me antarët e tjerë të grupit.

Ne arrijmë një kthim mbi kapitalin të qendrueshëm dhe mbi mesataren.

Ne i japim mundësi punonjësve tanë të jenë sipërmarrës, të tregojnë iniciativë dhe nxisim zhvillimin e tyre.

# Perspektivat dhe Planet për vitin 2014

Pas sfidave të vitit 2013, Raiffeisen Bank planifikon të vazhdojë zhvillimin e saj dhe ti ofrojë edhe më tepër ekonomisë së vendit. Konkurenca do të jetë e ashpër edhe gjatë vitit 2014. Ne do t'i përgjigjemi duke vazhduar fokusin ndaj një marrëdhënieje bashkëpunuese me klientët dhe duke vazhduar investimet në produkte, shërbime dhe risitë e teknologjisë.

Në vitin 2013, Raiffeisen Bank në Shqipëri implementoi sistemin e ri bankar për një shërbim më të shpejtë dhe më eficient për te rritur më tej kënaqësinë e klientit. Cilësia e shërbimit ndaj klientit në të gjitha segmentet do të vazhdojë të jetë prioritet. Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve, përmirësimi i efikasitetit, thjeshtësimi i procedurave dhe përfaqja nëpërmjet kanaveve të ndryshme do të na ndihmojnë për të arritur objektivat. Qëllimi ynë është të mbajmë pozicionin e bankës me portofolin më të madh në vend në kredidhënie, duke vendosur theks të veçantë në rritjen e cilësisë së portofolit të kredive.

Për sa i përket segmentit korporatë, ne do të vazhdojmë të fokusohemi jo vetëm në kredidhënie, por gjithashtu në ofrimin e një game të gjerë shërbimesh bankare për biznesin dhe punonjësit e tyre. Zgjerimi i shërbimeve bankare elektronike do të mbetet një prioritet. Ne gjithashtu planifikojmë të sjellim produkte dhe shërbime të reja në treg. Bankingu elektronik dhe celular sigurojnë fleksibilitet maksimal dhe lehtësi në kryerjen e veprimeve bankare kudo dhe kurdo si për bizneset dhe për individët. Në të njëjtën kohë rrjeti i degëve do të vazhdojë të përmirësohet duke krijuar standarde të reja dhe disa degë do të rialokohen në pozicione më të përshatshme.


Ne kaluam vështirësitë e këtij viti falë punonjësve më të mirë në tregun bankar në Shqipëri. Ne punuam dhe fituam ndaj sfidave si një skuadër. Për këtë arsye dëshirojmë të falenderojmë të gjithë punonjësit për përpjekjet dhe punën e tyre. Ne do të mbajmë këtë ritëm dhe për t'u përballur me sfidat e reja të vitit 2014.

Gjithashtu falenderojmë sinqerisht të gjithë klientët dhe bizneset partnere për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre gjatë vitit 2013. Ne mbetemi të përkushtuar për të përmbushur kërkesat tuaja bankare, duke ju ofruar një shërbim me cilësi të lartë në ç'do moment që ju keni nevojë. Ne do të bëjmë më të mirën për të qenë gjithmonë zgjedhja juaj e parë si partner bankar.

Bordi Drejtues  
Raiffeisen Bank Sh.a



**Christian Canacaris**  
Drejtor i Përgjithshëm



**Alexander Zsolnai**  
Zëvendës Drejtor i  
Bordit Drejtues



**Raphaela Bischof-Rothauer**  
Antar Bordi për  
Operacionet & TI



**John McNaughton**  
Antar Bordi  
për Biznes Retail





**Raiffeisen Bank financon mbjelljen e 390 pemëve në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës**

Raiffeisen Bank ka sponsorizuar mbjelljen e 390 pemëve në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Me këtë rast, në 17 Dhjetor në parkun e Liqenit Artificial u organizua një ceremoni në të cilën ishin të pranishëm Drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank, Z. Christian Canacaris dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Lulzim Basha.

# Raporti i Bordit Drejtues

## Zhvillimet Ekonomike

Ngadalësimi i ekonomisë shqiptare arriti maksimumin e tij në tremujorin e tretë të 2013 kur ekonomia u tkurr me 2 përqind nga viti në vit. Në tremujorin e fundit të 2014, ekonomia shqiptare ju kthye sërisht rritjes pozitive prej 1 përqind dhe vlerësimet paraprake të INSTAT presin që rritja e Prodhimit të Bredshëm Bruto (PBB) të jetë rreth 0.44 përqind nga viti në vit. Viti 2013 ishte viti me performancë më të dobët ekonomike për Shqipërinë, në 16 vitet e fundit.

Raporti i eksporteve ndaj importeve është rritur në 41 përqind kundrejt 27 përqind që ishte përpara fillimit të krizës ekonomike, për arsye se kërkesa e brendshme agregate u ul ndjeshëm kundrejt kërkesës së jashtme. Kërkesa e jashtme mbetet sektori me kontributin kryesor për rritjen ekonomike.

Qeveria e re, e dalë prej koalicionit fitues të zgjedhjeve të 23 Qershorit, PS dhe LSI, konstatoi detyrime të papaguara të shtetit ndaj sektorit privat të krijuara nga qeveria paraardhëse. Këto detyrime përlogariten paraprakisht në rreth 400 – 500 milion Euro. Njohja e këtij borxhi ndikoi në rritjen e borxhit publik në mbi 68 përqind për vitin 2013 dhe pritet të arrijë në mbi 72 përqind deri në fund të vitit 2014. Qeveria shqiptare, për financimin e këtij borxhi nënshkroi një marrëveshje financimi me FMN-në me vlerë 330 milion Euro. Kjo shumë do të disbursohet brenda tre vjetëve shtetit shqiptar me tre këste të barabarta duke filluar nga Marsi i vitit 2014.

Përlogaritet që, rreth 25 përqind e këtij borxhi të shtetit ndaj sektorit privat lidhet me nivelin e kredive të këqija të cilat arritën në 23.5% të totalit të kredive deri në Dhjetor 2013. Pagesa e këtyre borxheve pritet të rrisë besimin dhe do të çojë në një rimëkëmbje të sektorit bankar.

Defiçiti buxhetor u rrit ndjeshëm gjatë vitit 2013, i ndikuar edhe nga zgjedhjet e përgjithshme të cilat influencuan në një politikë fiskale të lehtësuar ku të ardhurat u ulën me 3 përqind nga viti në vit deri në Tetor 2013 dhe shpenzimet u rritën me 7 përqind. Prej këtyre treguesëve pritet që defiçiti buxhetor të ketë arritur në 6 përqind deri në fund të vitit 2013, krahasuar me objektivin që ishte 3.5 përqind.

Me miratimin e paketës së re fiskale për vitin 2014, qeveria synon konsolidimin fiskal dhe tkurrjen e defiçitit buxhetor. Kjo paketë parashikon një taksim progresiv (të shkallëzuar) të të ardhurave, ndryshe nga taksa e sheshtë e cila u aplikua nga qeveria e shkuar. Nga kjo formë taksimi pritet që të përfitojnë individët me të ardhura të ulëta si dhe bizneset e vogla.

Nga ana tjetër paketa fiskale parashikon një rritje të taksës për produktet e akcizës si dhe një rritje të tatimit të fitimit për bizneset e mëdha nga 10 përqind në 15 përqind.


Pritshmëria për rritjen ekonomike gjatë vitit 2014 është rreth 2 përqind nga viti në vit. Kjo rritje e ulët është e kushtëzuar nga rritja borxhit publik dhe rritja e defiçitit buxhetor të cilat pritet të ndikojnë në rritjen e sektorit publik.

Kërkesa e brendshme pritet që të stimulohet nga ripërtëritja e sektorit financiar, megjithatë efektet reale pritet të ndihen jo më herët se viti 2015. Rritja e taksave për bizneset e mëdha dhe taksimi progresiv pritet që të kenë një ndikim negativ në përthithjen e investimeve të huaja direkte. Megjithatë një përmirësim eventual i rezultateve të luftës ndaj korrupsionit, së bashku me reformat e pritshme në drejtësi dhe në sistemin fiskal mund të kompensojnë në stimulimin e investimeve të huaja direkte.

Gjithashtu projekti TAP (Trans Adriatic Pipeline) me një vlerë fillestare investimi prej 400 milion Euro, pritet të fillojë gjatë vitit 2014 dhe të përfundojë deri në vitin 2019.

Kërkesa e jashtme e cila ka qenë edhe motorri i ekonomisë gjatë viteve të fundit, pritet të vazhdojë të jetë e tillë edhe gjatë vitit 2014, me sektorë si energjitika, nxjerrja dhe përpunimi i naftës dhe industria e tekstilëve, të jenë sektorët kryesorë.


### Rritja Reale e Prodhimit të Brendshëm Bruto (% nga viti në vit)



## Rezultatet Financiare


Totali i aktiveve në fund të vitit 2013 ishte 291,796 milion Lekë (2012: 318,919 milion Lekë). Në 2013 vazhdoi zgjerimi i mëtejshëm i portofolit të kredisë, i cili në fund të vitit 2013 përfaqësonte 40 përqind (2012: 39 përqind) të totalit të aktiveve të bankës. Investimet në letra me vlerë vazhdojnë të zënë një pjesë të madhe të totalit të aktiveve të bankës duke përfaqësuar rreth 38 përqind të këtij totali në 2013 (2012: 38 përqind).

### Struktura e Bilancit - Aktivi (në '000 LEK)




Totali i huave dhe paradhënieve për klientët në fund të vitit 2013 ishte 128,452 milion Lekë (2012: 135,995 milion Lekë) duke përfaqësuar kështu një rënie prej 6 përqind të portofolit të kredisë gjatë këtij viti. Sektori i Korporatave përfaqëson 70 përqind të totalit të portofolit të kredisë dhe zuri vendin kryesor në këtë portofol me një tepricë kredisë prej 89,534 milion Lekë (2012: 93,379 milion Lekë). Segmentet e Ndërmarrjeve të Mesme shënuan një rënie në portofolin e kredisë përkatësisht 2 përqind. U shënuan një rënie në portofolin e kredisë prej 35 përqind për segmentin e ndërmarrjeve të vogla me një tepricë prej 2,274 milion Lekë (2012: 3,511 milion Lekë).

**Struktura e Hua dhe Paradhënie për klientët**  
(në '000 LEK)



Në vitin 2013 portofoli i kredisë përbëhet kryesisht nga një kombinim i kredisë afatmesme prej 21 përqind (2012: 24 përqind) dhe paradhënies bankare prej 43 përqind (2012: 41 përqind). Kredia afatgjatë përfaqëson 22 përqind të totalit të portofolit të Bankës për 2013 (2012: 23 përqind).


**Kredi gjatë vitit 2013**  
(in '000 LEK)






Totali i detyrimeve në fund të vitit 2013 ishte 291,796 milion Lekë (2012: 318,919 milion Lekë). Në 2013, pjesën më të madhe të detyrimeve e zënë depozitat e klientëve, të cilat përbëjnë rreth 84 përqind (2012: 89 përqind) të totalit të detyrimeve.

### Struktura e Bilancit - Pasiv (në '000 LEK)




Ashtu si në 2012, profili i depozitave të klientëve tregon një tendencë të depozituesve për t'u larguar nga depozitat me afat të shkurtër maturimi. Me qëllim përfitimin nga interesat më të larta, klientët po investojnë kursimet e tyre në depozita me afat më të gjatë maturimi. Totali i depozitave të klientëve në fund të vitit 2013 është 179,314 milion Lekë (2012: 226,994 milion Lekë).

### Struktura e Depozitave (në '000 LEK)




2013 shënoi një rënie 12 përqind të fitimit pas taksës në krahasim me 2012 në 4,647 milion Lekë (2012: 5,306 milion Lekë) duke ndryshuar raportin e kthimit mbi kapitalin nga 20 përqind në 2012 në 16 përqind në 2013. Dividendi i deklaruar dhe i paguar në 2013 është 5,313 milion Lekë (2012: 3,729 milion Lekë).

### Struktura e Kapitalit Aksioner (në '000 LEK)



E ardhura neto nga interesat u rrit me 1 përqind ose nga 10,797 milion Lekë në 2012, në 10,898 milion Lekë në 2013. Rritja e të ardhurës nga interesat bashkë me rënie të totalit të aktiveve të bankës prej 10 përqind, ndikoi në përqëndrimin e kësaj të ardhure (llogaritur si raport i të ardhurës nga interesat mbi mesataren vjetore të totalit të aktiveve) duke e ulur atë me 20 pikë ose shprehur ndryshe nga 3 përqind në 2012 në 4 përqind në 2013.

### Të ardhura neto (në '000 LEK)




Shpenzimet administrative në total gjatë 2013 arritën në 2,110 milion Lekë (2012: 1,968 milion Lekë). Efienca operuese e Bankës – raporti kosto/të ardhura ndryshoi nga 41 përqind në 39 përqind.

Shpenzimet për stafin u ulën me 4 përqind ose 2,427 milion Lekë në 2013 krahasuar me 2,520 milion Lekë në 2012.


### Shpenzime operative 2012

(në '000 LEK)



### Fitimi & ROE

(në '000,000 ALL)





Genuar

GENIAR FEMIJË TË DASHUR  
SPONSOR GJENERAL

Raiffeisen  
BANK  
Filiali çdo afër





Tema e këtij eventit, organizuar nga **“Jetimët në Fokus”** sponsorizuar nga Raiffeisen Bank, ishte “Festimet e fundvitit, pasioni i fëmijëve jetimë – le të festojmë së bashku si komunitet” Në këtë event morën pjesë 220 fëmijë jetimë nga Tirana, Berati, Kavaja, Çorovoda, dhe Poliçani. Në fund të eventit u shpërndanë dhurata për të gjithë fëmijët pjesëmarrës.

# Raporti i Segmenteve

## Segmenti Korporatë

Viti 2013 mund të konsiderohet viti i sfidave për segmentin korporatë dhe për bankën në përgjithësi. Përpos masave shtrënguese të vendosura nga Komuniteti Evropian në përmbushje të përmirësimit të strukturës së kapitalit për të gjithë bankat Evropiane, Banka Raiffeisen vazhdoi të ruante pozicionin drejtues në tregun vendas përsa i përket kredisë së biznesit.

Në fokus të veçantë gjatë vitit 2013 ka vazhduar të jetë edhe cilësia e portofolit të kredisë, kjo e arritur nëpërmjet manaxhimit më të mirë të riskut, përmirësimit të cilësisë së kolateralit dhe evidentimit në kohë të vështirësive të hasura nga biznesi, të shoqëruara me propozimin e zgjidhjeve më të favorshme për palët.

Është e rëndësishme të theksojmë se Raiffesisen Bank ka privilegjin t'u shërbejë 1,338 klientëve Korporatë që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj. Raiffeisen Bank është përpjekur që përveç përmirësimit dhe zgjerimit të shërbimit ndaj klientëve ekzistues të tërheqi pranë bankës edhe klientë të rinj, në mënyrë që të ketë një bazë klientësh gjithmonë më të shëndetshme dhe reciprokisht të kontribuojë në suksesin e përbashkët. Vetëm gjatë vitit 2013 segmenti korporatë ka pasur një rritje të bazës së klientëve me rreth 10 përqind krahasuar me vitin 2012.

Disa nga faktorët kryesor që kanë ndikuar në rezultatet e arritura janë:

- I. Struktura më efiçente dhe trajnim të forcës shitëse;
- II. Përmirësimi i vazhdueshëm i teknikave të shitjes duke zhvilluar iniciativa të reja shitjeje të cilat janë prezantuar gjatë vitit 2013 për segmentin Korporatë dhe SE.
- III. Ofrimi i produkteve të specializuara;
- IV. Sinergji më e mirë me strukturat e tjera brenda bankës si dhe me bankat e tjera të grupit Raiffeisen Bank International;

Ekspertët e Divizionit të Korporatave ofrojnë një spektër të gjerë produktesh, shërbimesh, zgjidhjesh financiare, në përputhje me nevojat e bizneseve. Suksesi i këtij segmenti bazohet në aftësitë për të vendosur marrëdhënie afatgjata partneriteti me klientët duke kuptuar dhe analizuar me kujdes planet e zhvillimit të biznesit, dhe duke ofruar zgjidhje të shpejtë dhe të dedikuara nëpërmjet një niveli të lartë profesionalizmi. Kjo me qëllim ofrimin e të gjithë suportit të nevojshëm për të arritur një rritje të qëndrueshme në perspektivë afatgjatë për bizneset e korporatave.

Konsolidimi i tregut për klientët korporatë që operojnë në Shqipëri ka kërkuar strukturimin e produkteve bankare të ofruara klientëve të këtij segmenti. Gjithashtu gjatë vitit 2013 është arritur që të zgjerohet gama e produkteve për të qenë më pranë nevojave të biznesit, ku ndër ta përmendim:

- "Faktoring-un", financimin afatshkurtër, i lançuar si një produkt relativisht i ri në treg dhe që kërkon ekspertizë të zgjeruar.
- "Karta e Kreditit për Bizneset", financim afatshkurtër i lançuar në tregun vendas për të mbështetur transaksionet e përditëshme të kompanive.

Nga pikpamja e segmentimit të klientëve, Divizioni i Korporatave u shërben:

- Korporatave vendase të cilat operojnë në tregun shqiptar;
- Korporatave ndërkombëtare aktualisht prezente ose të interesuara të investojnë në tregun shqiptar;
- Institucioneve Publike dhe Pushtetit Qëndror dhe Lokal;
- Institucioneve Financiare jo-bankare.

Stafi i Divizionit Korporatë në sajë të eksperiencës disa vjeçare, është i gatshëm t'u sigurojë klientëve alternativën më të mirë bankare në Shqipëri duke garantuar besueshmëri, efektivitet, siguri dhe orientim drejt shërbimit ndaj klientit.

## Sektori Publik

Sektori Publik vijon të jetë një ndër sektorët më të rëndësishëm në Raiffeisen Bank. Për t'i shërbyer më mirë këtij segmenti, Departamenti i Institucioneve Publike, Qëndrore dhe Lokale, në bankën Raiffeisen kujdeset për krijimin e një klime pozitive dhe të favorshme me të gjitha Institucionet Publike, duke forcuar edhe më tej bashkëpunimin afatgjatë bilateral.

Si banka më e madhe në vend dhe partneri kryesor financiar i qeverisë shqiptare, bazuar edhe në simbiozën e marrëdhënieve të shkëlqyera të krijuara midis bankës dhe të gjitha Institucioneve, është bërë e mundur materializimi i projekteve të ndryshme me interes të gjerë publik si:

- Sistemi elektronik i pagesave dhe raportimit të arkëtimit buxhetore;
- Pagesat elektronike të detyrimeve tatimore nga bizneset;
- Pagesat online të detyrimeve doganore nga bizneset;

Këto projekte kanë kontribuar kryesisht në përdorimin transparent, eficient dhe të përgjegjshëm të burimeve financiare publike. Lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave dhe informacionit midis institucioneve të ndryshme publike dhe bankës, duke ofruar një shërbim të përmirësuar për publikun e gjerë.

## Biznesi i Vogël (SE)

Viti 2013, ashtu siç edhe pritej solli një ambient makroekonomik tepër sfidues, i cili kërkoi veprime të shpejta dhe fleksibilitet për një biznes gjithmonë në ndryshim. Për të dhënë klientëve një suport sa më afatgjatë dhe të plotë, në fillim të vitit 2013 segmenti i Biznesit të Vogël prezantoi një strukturë të re organizimi, sipas të cilit është bërë ndarja në tre zona gjeografike. Kjo strukturë funksionoi me sukses dhe siguroi rezultate mjaft të kënaqshme në fund të këtij viti.

Një strukturë e tillë ka forcuar dhe përmirësuar marrëdhëniet me klientët, pasi ata besojnë në mundësitë tona për të mbështetur dhe drejtuar drejt suksesit. Raiffeisen Bank ka mbështetur klientët e saj duke i ofruar një shërbim të kualifikuar financiar, përkushtim dhe përpjekje për të identifikuar nevojat e tyre, dhe duke siguruar konsulencë nëpërmjet një stafi të besueshëm dhe të motivuar. Për të qenë sa më pranë dinamikës dhe zhvillimeve të biznesit janë organizuar vizita të shpeshta, takime dhe mjaft evente.

Pavarësisht nga situata e vështirë e këtij viti, volumi i kredive të këqija është zvogëluar me 3 përqind krahasuar me vitin 2012.

Gjatë vitit 2013, segmenti SE ka arritur të mirëmbajë numrin e klientëve duke ofruar këshillim financiar si dhe një gamë të gjerë produktesh të personalizuar sipas natyrës së bizneseve.

Falë një bashkëpunimi të ngushtë midis forcës shitëse, departamentit të Produkteve dhe Shërbimeve, rrjetit të degëve dhe njësie të tjera mbështetëse, Segmenti i SE-së ka forcuar më shumë marrëdhëniet me klientët e tij, duke u bërë partneri i tyre besnik dhe profesional në këtë treg konkurrues, për t'i mbështetur ata në situata të ndryshme dhe të paparashikueshme financiare.

## Divizioni i Produkteve Korporatë dhe SE

### Produktet e Manaxhimit të Likuiditeteve

Viti 2013 ishte një vit intensiv për Njësinë e Manaxhimit të Likuiditeteve. Njësia e produkteve ka qenë e fokusuar në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve, si dhe ofrimin të paketave sa më konkurruese për klientët Korporatë dhe Bizneset e Vogla, qofshin këto kompani vendase dhe ndërkombëtare.

Gjatë këtij viti Raiffeisen ka vazhduar të jetë partneri strategjik për klientët e bankës dhe u ka ofruar shërbime sipas kërkesave specifike të tyre ku vlejnë të përmenden zhvillimet e mëposhtme:

- Projekti "Pagesat elektronike për zyrën e Taksave - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve": Shërbimi i ri "E-Payment" me Drejtorinë e Tatim Taksave i mundëson tatimpaguesve (Mikro, SE, Korporatë) të paguajnë detyrimet e taksave direkt nga WEB-i i tatimeve për në sistemin e bankës, ku procesimi dhe autorizimi i pagesës ekzekutohet automatikisht.
- "Raportimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave": Raportimi në kohë reale i të gjitha veprimeve të procesuara në degët tona dhe të urdhëruara nga klientët e bankës në favor të zyrës së Doganore.

## Financimi i Projekteve dhe Investimeve Afatgjata

Njësia e Financimit të Projekteve dhe Investimeve Afatgjata është e angazhuar në vlerësimin dhe financimin e investimeve të Projekteve Financiare dhe Pasuri të Paluajtshme sikurse transaksione të strukturuar të financimeve afatgjata që lidhen me blerje asetesh apo përthithje kompanish.

Raiffeisen Bank ka finalizuar me sukses disa projekte gjatë vitit 2013, duke ofruar për klientët e korporatave një zgjidhje profesionale e cila i përshtatet nevojave të tyre të financimit. Njësia është e fokusuar jo vetëm në forcimin e bashkëpunimit me klientët, por edhe në rritjen e bashkëpunimit me institucione të tjera financiare (kombëtare e ndërkombëtare) të cilat shohin tek banka një partner të denjë.

Të dedikuar në suksesin e çdo projekti, cilësitë kryesore të cilat na dallojnë janë: kreativiteti, kompetenca si dhe njohja e mirë e tregut të synuar.

## Produktet e Financave Tregtare

Njësia e Financave Tregtare ofron shërbimin e këshillimit të klientëve të saj për përdorimin e duhur të Transaksioneve të Financave Tregtare si Garancitë Bankare, Letër Kreditë dhe Mbledhje Dokumentacioni, në mënyrë që të reduktojnë riskun e marrëdhënieve tregtare me partnerët respektivë ndërkombëtar dhe vendas.

Raiffeisen Bank i mbështet klientët e saj në realizimin e këtyre transaksioneve në kohë dhe me cilësi. Banka ka ekspertizën e duhur teknike dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin e klientëve në lidhje me avantazhet e përdorimit të Produkteve të Financave Tregtare. Puna e kësaj strukture në bashkëpunim me forcën shitëse ka kontribuar në mbajtjen e një rendi rritës të ndjeshëm të volumeve në këtë fushë nga viti në vit.

Njësia e Produkteve të Financave Tregtare suporton gjithashtu klientët korporatë të bankës në njohjen dhe konsiderimin e produktit të Faktoringut si një mundësi alternative e financimit të nevojave të tyre për likuiditet.

Në fushën e Financave Tregtare, banka ka krijuar një avantazh konkures në krahasim me bankat dhe institucionet e tjera financiare duke patur një nivel të lartë specializimi, i cili përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme me suportin e RBI-së në Vjenë, bashkëpunimin e vazhdueshëm me bankat e rritit si dhe duke patur struktura të balancuara dhe kanale të gjera shpërndarjeje.

Raiffeisen Bank Shqipëri duke filluar nga gushti i vitit 2013 ka shtuar një produkt të ri, “Kartën e Biznesit MasterCard”, në gamën e gjerë të produkteve të ofruara.

“Karta e Biznesit Master Card” do të ketë një limit të aprovuar për kompaninë nga banka me një funksion ripërdorimi të limitit të shlyer muaj pas muaji. Kjo kartë mund të përdoret nga kartëmbajtësit e autorizuar nga kompania për qëllime biznesi deri në limitin e aprovuar nga kompania për secilën kartë.

Karta e Biznesit MasterCard mund të përdoret nga kartëmbajtësit për të kryer transaksione si vijon:

- • Kryerje pagesash për mallra dhe shërbime në më tepër se 20 milion terminale POS në të gjithë botën
- • Kryerje pagesash/blerje në internet, prentim biletash dhe kryerje telefonatash ndërkombëtare
- • Tërheqje parash në çdo terminal që mban Logon e MasterCard

Karta e Biznesit Master Card do të ofrohet në dy monedha Euro dhe Lek dhe do të ofrohet për klientët e segmentit Korporatë dhe SE. Ky produkt synon të lehtësojë operimin e përditshëm të kompanisë dhe punonjësve të saj.

## Zhvillimi i Biznesit Korporatë dhe Bizneseve të Vogla

Objektivi kryesor gjatë vitit 2013 i Njesisë së Zhvillimit të Biznesit Korporatë dhe Bizneseve të Vogla ka qenë përmirësimi i shërbimeve të ofruara për Korporatat dhe Bizneset e Vogla në Shqipëri, nga stafi i alokuar në degët e bankës. Raiffeisen Bank ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme proceset ditore të performuara në degë për klientët Korporatë dhe SE dhe ka siguruar mbështetjen adeqate në mënyrë që të sigurohej shërbimi i duhur brenda në kohë dhe cilësi. Stafi i dedikuar në degët kryesore ku dhe grupi i targetuar i klientëve është alokuar, ka rritur ndjeshëm eficientësinë dhe profesionalizmin në shërbimet e ofruara këtyre klientëve.

Një nga detyrat kryesore të Njesisë së Zhvillimit të Biznesit është menaxhimi i ankesave të klientëve korporatë dhe SE kundrejt bankës. Në këtë kuadër njësia ka adresuar një sërë problemesh dhe ka propozuar zgjidhje që kanë çuar në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara këtyre segmenteve të biznesit.



# Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve

## Segmenti i Klientëve Individë

Segmenti i klientëve individë ka ndjekur të njëjtin ritëm me vitin e kaluar për fuqizimin e klientëve duke u ofruar fleksibilitet më të madh, më shumë zgjedhje dhe kontroll dhe duke rikonfiguruar modelin e biznesit rreth nevojave të klientit. Përjasja e klientëve sipas ciklit të jetës, e hedhur në treg në fund të 2012, tashmë është histori suksesi ku rreth 1/3 e klientëve aktivë kanë zgjedhur një paketë shërbimesh bankare të bazuar në nevojat specifike të stilit të jetës. Kjo arritje është bërë e mundur vetëm brenda një viti.

Dedikimi dhe shërbimi shumë cilësor i ofruar tek klientët pagamarrës, i ndërthurur me fushata të ndryshme të ideuara për të shpërblyer këta klientë, i kanë dhënë një shtysë pozitive ruajtjes së bazës së klientëve. Kjo gjë e kombinuar me programet për të marrë klient të rinj ka sjellë rritjen e mëtejshme të bazës së madhe të klientëve.

Gjatë vitit 2013 Raiffeisen Bank ka forcuar aftësitë për të bërë shitje të kryqëzuar nëpërmjet Manaxhimit të Marrëdhënies me Klientin (CRM) duke realizuar 18 përqind më shumë fushata CRM dhe me një rritje prej gati 50 përqind të numrit mesatar të ofertave për klient krahasuar me vitin e kaluar.

CRM i avancuar i ka bërë të mundur bankës që të kuptojë me ritme të shpejta nevojat e klientëve dhe t'u bëjë atyre oferta të personalizuar në mënyrë inteligjente. Në 2014 banka do të vazhdojë të zhvillohet në këtë drejtim duke implementuar një sistem të sofistikuar CRM.

Gjithashtu, programet "On-boarding i klientëve" do të përdoren për të inkurajuar klientët e rinj të përdorin shërbimet bankare që në momentet e para të marrëdhënies me bankën, duke krijuar kështu, besnikëri dhe përfitim që në fillimet e marrëdhënies.

Duke pasur bazën më të madhe të klientelës në sistemin bankar në Shqipëri, banka është dedikuar të përdori metoda të avancuara për të personalizuar marrëdhënien me klientët duke i shtyrë ata drejt përdorimit më të madh të shërbimeve të bankës dhe drejt rritjes së të ardhurave për bankën.

## Segmenti Premium

Premium Banking vazhdon të ofrojë një nivel të veçantë dhe të personalizuar të shërbimit për klientët Premium. Këtë vit fokusi ka qenë forcimi i marrëdhënieve me klientët Premium duke ofruar produkte tërheqëse, çmime konkurruese dhe standarte të larta të shërbimit bankar.

Deri në fund të vitit 2013, Premium Banking kishte mbi 32,000 klientë nga të cilët rreth 15 përqind i përkasin kategorisë së klientëve "Premium CLUB", kategoria e klientëve më të mirë Premium, e cila gjatë këtij viti u rrit me 16 përqind.

Faqja e internetit, Premium Web, lançuar këtë vit, ka kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e kënaqësisë së klientëve. Klientëve premium u ofrohet një nivel i lartë shërbimesh bankare në 16 degët kryesore të bankës, nga 22 Menaxherët e Dedikuar të Shërbimit Premium.

Vlerat për klientët Premium përbëhen nga një kombinim i shërbimit të personalizuar, këshillimit në planifikimin financiar dhe produkteve të përshtatura për të përbushur nevojat e tyre. Këshillimi financiar ofron një zgjidhje gjithëpërfshirëse për nevojat financiare të klientit.

Menaxherët e Dedikuar të Shërbimit Premium janë të trajnuar për të ofruar ekspertizën e duhur në drejtimin bankar dhe investimit të produkteve, nëpërmjet shqyrtimit të nevojave unike për çdo klient, aspiratat dhe zhvillimin e një plani për trajtimin dhe investimet e parave të tyre.

Asnjë bankë tjetër nuk ofron një nivel të lartë të këshillimit dhe të shërbimit bankar si Premium Banking në Raiffeisen Bank. Gjatë vitit 2014 do të vazhdojë fokusi në nivele të larta të ofrimit të shërbimeve bankare të lidhura me këshillimin financiar dhe produkte të përshtatura.


## Segmenti i Bizneseve Mikro

Gjatë vitit 2013 Segmenti Mikro vazhdoi të fokusohet në mbështetjen e bizneseve të vogla, në aktivitetin e tyre të përditshëm, duke ofruar partneritet në përbushjen e nevojave të menjëherëshme dhe ato në të ardhmen. Qëllimi kryesor ka qenë rritja e bazës së klientëve, që në fund të vitit 2013 rezultoi në rreth 3,900 llogari të reja të hapura duke krijuar kështu një bazë prej 15,500 klientësh. Ngadalësimi ekonomik ka reflektuar rënie të aktivitetit kreditues duke e mbyllur vitin 2013 me një portofol të Aktiveve Mikro prej 14.5 milion Euro. Ndërsa portofoli i Pasiveve u mbyll me rreth 22.9 milion Euro, duke u rritur me 2.4 milion Euro në krahasim me vitin 2012, kjo si rezultat i afrimit të klientëve të rinj dhe aktivizimeve.

Klientët e bankës në aktivitetin e tyre të përditshëm vazhdojnë të marrin shërbime jo vetëm nga të gjitha degët e rrjetit, por edhe nga stafi i dedikuar prej 30 menaxherë të marrëdhënieve me klientët, të vendosur në 30 degë. Menaxherët e marrëdhënies me klientët janë të trajnuar për të ofruar këshillim në shërbimet financiare përkatëse për pronarët e bizneseve të vogla.

Vlerat e Raiffeisen Bank janë një kombinim i produkteve konkurruese dhe mbështetjes së dedikuar ndaj biznesit, duke ofruar një partneritet të konsoliduar për këtë segment. Banka vazhdon të investojë në zhvillimin e forcës shitëse, për të siguruar një standard të lartë shërbimi dhe mbështetje për këtë segment klientësh. Në vitin 2014, segmenti i biznesit Micro do të fokusohet në rritjen e bazës së klientëve dhe rritjen e një portofoli kredie me cilësi të lartë.

**Volum i Aktiveve, Pasiveve and Numri i Klientëve,**  
Janar - Dhjetor 2013



## Divizioni i Produkteve

### Kreditë

Kërkesa e tregut për kredi konsumatore është ngadalësuar në mjedisin ekonomik aktual. Gjatë vitit 2013 Raiffeisen Bank ka promovuar në mënyrë aktive produktet e saj më të mira të kredidhënies me 4 fushata marketingu. Kreditë e pasiguruara kanë vazhduar të jenë suksesi ynë më i madh i shitjes, duke arritur 1/3 e volumeve të shitura në treg.

Raiffeisen Bank ka vazhduar të ofrojë një gamë të gjerë dhe të larmishme produktesh me karakteristika dhe norma interesi konkurruese, përmes një procesi të përmirësuar kreditimi, duke rritur kështu efikasitetin dhe kënaqësinë e klientëve. Kriteret e kreditimit, të cilat reflektojnë cilësinë e mirë të portofolit janë lehtësuar për të bërë kreditë më të arritshme.

### Produktet e kursimit

Gjatë vitit 2013 depozitat e klientëve individë vazhduan të zinin zërin kryesor në bilancin e bankës.

Normat e tregut shënuan nivelin më të ulët në vitin 2013, për shkak të likuiditetit të tepërt në sistemin bankar. Si rrjedhojë, normat e interesit për depozitat me afat u ulën në mënyrë të ndjeshme. Raiffeisen Bank i ka ofruar klientëve të saj mundësi alternative për mënyrën e manaxhimit dhe investimit të pasurisë, nëpërmjet kompanisë bijë të saj Raiffeisen Invest, e vetmja kompani në Shqipëri e cila ofron mundësinë e investimit të fondeve për publikun. Pjesa më e madhe e klientëve ka vazhduar të besojë në Raiffaisen Bank duke i mbajtur depozitat e tyre me afat, pavarësisht normave të ulëta të interesit që janë ofruar. Një pjesë e mirë e klientëve zgjedhën të investojnë kursimet e tyre në fondet e ofruara nga Raiffeisen Invest, duke përfutur kështu të ardhura vjetore të mira, më të larta se depozitat me afat të ofruara në treg.

Fondet e Investimit të Raiffeisen Invest, të cilat ofrohen në të gjithë rrejtin e degëve Raiffeisen, kanë tërhequr gjithashtu klientë të rinj si dhe forma të tjera të investimit. Kombinimi i produkteve tradicionale të kursimit në Raiffeisen Bank me fondet e ofruara nga Raiffeisen Invest, i ka dhënë klientëve individë më tepër mundësi zgjedhjeje për të rritur të ardhurat e tyre.

Përmirësimet e mëtejshme të platformës së re dhe bashkëkohore të sistemit të depozitave ka lejuar që klientëve t'u ofrohen mundësi të shumëllojshme zgjedhjeje mes gamës më të gjerë të ofruar në treg të produkteve dhe maturiteteve, kapitalizimit të interesit dhe rinovimit automatik. Raiffeisen Bank është e vetmja bankë që ofron kushte kaq fleksibël të mbështetura gjithashtu nga politika strikte që sigurojnë standart më të lartë të transparencës ndaj klientëve.

## Pagesat dhe Transfertat

Numri total i pagesave dhe transfertave të kryera nga klientët individë, premium dhe mikro gjatë vitit 2013 është rritur me 25 përqind kundrejt vitit të kaluar, ndërsa komisionet e gjeneruara nga këto shërbime janë rritur me 8 përqind, duke reflektuar tarifën e ulëta për të inkurajuar përdorimin më të madh të sistemit bankar për këto lloj transaksionesh. Gjithashtu vlen për t'u theksuar fakti që pavarësisht se dërgesat e emigrantëve në Shqipëri kanë rënë ndjeshëm gjatë këtij viti, në Raiffeisen Bank ato përsëri shënuan rritje dhe si rrjedhojë banka vazhdoi të përmirësojë pozicionin e saj në treg.

Pagesat dhe transfertat ende përfaqësojnë mundësi të konsiderueshme rritjeje në Raiffeisen Bank, gjë e cila do të arrihet përmes zhvillimit të vazhdueshëm të tregut.

## Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Elektronik

### Rrjeti i terminaleve POS

Në vitin 2013 Raiffeisen Bank zhvilloi dhe zgjeroi më tej rrjetin e saj të terminaleve POS në mbarë vendin. Ky shërbim u ofron klientëve tanë si dhe çdo klienti të bankave të tjera vendase dhe të huaja mundësinë e përdorimit të kartave të debitit dhe kreditit të markave VISA, Visa Electron, MasterCard dhe Maestro për blerje në pikat e shitjeve si dhe tërheqje cash pranë degëve të bankës. Në fund të vitit 2013 rrjeti POS arriti në një total prej 1,423 terminalesh. Rrjeti i terminaleve POS u shtri në mbi 30 qytete të vendit duke ofruar këtë shërbim mbi 60 kategorive të ndryshme biznesesh duke përfshirë hotele, agjenci udhëtimi, dyqane, restorante, pika karburanti, markete si dhe qendrat tregtare më të mëdha në vend. Edhe gjatë vitit 2013 banka rriti performancën e këtij rrjeti në terma transaksionesh dhe volumesh.

### Shërbimi i Pranimit të Pagesave me Karta nëpërmjet Internetit

Raiffeisen Bank është banka e parë në treg që ofroi shërbimin E-commerce në tregun shqiptar në vitin 2012. Gjatë vitit 2013 ky shërbim iu ofrua një numri gjithmonë e në rritje biznesesh si agjenci udhëtimi, dyqane kozmetike, rezervime hotele, pajisje elektroshtëpiake, abonime televizive, shërbime interneti, etj. Shërbimi i blerjes me karta nëpërmjet Internetit ofron mundësinë që bizneset të shesin produktet dhe shërbimet e tyre nëpërmjet internetit. Banka e ofron këtë shërbim në kuadrin e Teknologjisë së Sigurisë 3-D. Teknologjia e Sigurisë 3-D është standardi më i avancuar i sigurisë së pagesave.

### Rrjeti ATM

Gjatë vitit 2013 Raiffeisen Bank ishte në krye të tregut bankar shqiptar me 195 ATM, një diferencë e konsiderueshme me bankat e tjera në vend. Llojet e kartave të pranura në rrjetin ATM janë VISA, VISA Electron, PLUS, MasterCard, Maestro dhe Cirrus, pa kufizime për ndonjë vend apo bankë lëshuese. Tërheqjet në monedhën EURO ofrohen në 34 ATM në mbarë vendin, me një fokus të veçantë në zonat turistike, qendrat tregtare dhe zonat më të populluara. Rrjeti ATM i Raiffeisen Bank është i çertifikuar plotësisht për teknologjinë e leximit të kartave me Chip për markat Visa dhe MasterCard duke i dhënë Bankës një avantazh të konsiderueshëm dhe duke u ofruar kartëmbajtësve nivelet më të larta të sigurisë së transaksioneve. Gjithashtu rrjeti ATM i Raiffeisen Bank ofron elementë të tjerë sigurie në veprimet me karta duke përfshirë mbrojtëset e tastierës si dhe kamera të integruara. Shërbime të tjera të ofruara në bankomate janë edhe ndryshimi i kodit PIN për kartat e debitit dhe të kreditit si dhe nxjerrje të shkurtër llogarie.

### Kartat e Kreditit

Gjatë vitit 2013 produkti i kartës së kreditit vijoi të këtë rritje të dukshme në treg me një rritje mbi 30 përqind në numrin e kartave të shitura. Në fund të 2013 Raiffeisen Bank zotëroi rreth 40 përqind të tregut të këtij produkti duke spikatur dukshëm. Banka ofron karta të markës MasterCard, produktet Standard dhe Gold. Gjithashtu ky vit shënoi një rritje të rëndësishme në volumin e veprimeve të kryera me këto karta, arritje e mundësuar nga zhvillimi i fushatave për nxitjen e përdorimit të kartave të kreditit të kryera gjatë muajve të ndryshëm të vitit. Gjatë 2014 Raiffeisen Bank do të vazhdojë të rrisë ndjeshëm produktin e Kartës së Kreditit duke u fokusuar në nxitjen e përdorimit pranë pikave të shitjes (POS) si edhe rritjen e elementëve të sigurisë për përdorimin e kartave.

### Kartat e Debitit

Në vitin 2013 Raiffeisen Bank vazhdoi të jetë banka lider në tregun e kartave të debitit duke zotëruar rreth 30 përqind të këtij tregut. Gjithashtu gjatë këtij viti rreth 50,000 karta të reja debiti u lëshuan për klientët e bankës. Numri i veprimeve të kryera me këto karta në rrjetet ATM dhe POS është rritur gjithashtu.

### Bankingu Elektronik

Në rolin e liderit të tregut në Shqipëri, Raiffeisen Bank vazhdon t'i përkushtohet inovacionit dhe transformimit të vazhdueshëm të tregut, duke synuar gjetjen e mënyrave të reja, moderne të bankingut.

Raiffeisen Bank u ofron klientëve lehtësitë e Internet Banking i cili mundëson informacion 24 orë/ 7 ditë të javës mbi gjendjet dhe historikun e veprimeve në llogaritë bankare, kryerjen e transaksioneve dhe pagesave të ndryshme.

Në 2011 Raiffeisen Bank hodhi në treg shërbimin e Mobile Banking, një standard i ri shërbimi më i plotë dhe gjithëpërfshirës. Shërbimi m-banking punon në çdo telefon që suporton teknologjinë Java, pra pothuaj të gjithë shqiptarët mund të përdorin lehtësisht këtë kanal elektronik të përparuar.

Viti 2013 shënoi një rritje të madhe të numrit të klientëve të rregjistruar dhe atyre që e përdorën shërbimin.

Në vitin 2013 një shërbimi i ri pagese me celular MPAY ju shtua gamës së shërbimeve elektronike bankare të ofruara nga banka. MPAY i ofron klientëve mundësinë që të paguajnë faturat e tyre utilitare ose të rimbushin numrin e tyre celular me parapagesë, në çdo kohë, vetëm duke përdorur pajisjen e tyre celulare. Shërbimi u hodh në treg në Prill dhe deri në fund të vitit u regjistruan më shumë se 29,000 klientë.

## Call Center

Aktiviteti i Call Center është i fokusuar në dy drejtime kryesore: shqyrtimi i kërkesave të klientëve nëpërmjet telefonatave hyrëse dhe zhvillimi i fushatave.

Tetë agjentë në njësinë hyrëse 'Incoming' ofrojnë shërbim 24/7, duke siguruar informacion mbi produktet dhe shërbimet e bankës, sipas nevojave të klientëve të identifikuar nëpërmjet telefonatave hyrëse.

Bazuar në strategjinë e Departamentit të Zhvillimit të Segmenteve të Klientëve, Njësia e Telemarketing kontakton klientët e zgjedhur, nëpërmjet telefonit dhe SMS-ve për oferta të dedikuara që janë pjesë e menaxhimit të marrëdhënieve me klientët e bankës. Gjatë vitit 2013 janë performuar 155 fushata me një total prej 184,000 klientë të targetuar.

## Kanalet e Shpërndarjes

Vëmendja e vitit 2013 u përqëndrua tek ruajtja e drejtimit strategjik për përmirësimin në nivel të përgjithshëm të cilësisë së eksperiencës së klientit në degët e bankës, si dhe përmirësimin e efektivitetit të rrjetit. Raiffeisen Bank ruajti pozicionin e saj lider si banka më e madhe në Shqipëri me 103 degë të cilat ofrojnë shërbim përgjatë gjithë gjeografisë së vendit.

Nga perspektiva e zhvillimit të biznesit, fokusi kryesor ishte thellimi i marrëdhënieve me bazën e gjerë të klientëve dhe së fundmi arritja e statusit të bankës primare me një numër në rritje klientësh. Rritja e gamës së shërbimeve financiare të përdorura nga klientët është fokusi i ditës nga stafi i degëve. Shumë vëmendje iu kushtua sigurimit të bashkëveprimit të një niveli sa më të lartë profesional me klientët. Kjo gjë u arrit në sajë të investimit të vazhdueshëm në zhvillimin e individëve. Viti 2013 ishte gjithashtu një vit suksesi edhe për shpërndarjen e Fondit të Investimit. Klientët e bankës vazhduan të përfitojnë nga kthimet e larta dhe popullariteti i produktit mbeti i fortë.

Për sa i përket efikasitetit të degëve, përpjekjet u vendosën për maksimizimin e nivelit të shërbimit ndaj klientëve duke shpërndarë në mënyrë më optimale burimet njerëzore. Raiffeisen Bank vazhdon të përdori mjetet e kontrollit të cilësisë të zhvilluara në vitin 2012.

Lidhur me segmentin Mikro, Raiffeisen Bank arriti rezultate shumë të mira në përmirësimin e cilësisë së portofolit, të cilat kontribuan në mënyrë të konsiderueshme në të ardhurat neto të segmentit. Ishte gjithashtu një vit rekord duke tërhequr rreth 4,000 klientë të rinj. Nga fundi i vitit 2013 u prezantua një model i ri këshillues, me qëllim për të vlerësuar më mirë nevojat e bizneseve të vogla dhe ofrimin e zgjidhjeve financiare sa më të përshtatshme.

Kanalet alternative të shitjes në Raiffeisen Bank vazhduan në mënyrë aktive të mbështesin rrjetin e degëve. Agjentët e shitjeve direkte dhe përfaqësuesit e RSF-ve arritën rezultate solide përgjatë një viti të shënjuar më tepër nga sfidat makroekonomike. Ata mbetën të përkushtuar për të plotësuar rrjetin e degëve duke identifikuar, kualifikuar apo shitur klientëve aktualë apo potencialë produktet dhe shërbimet e ofruara nga banka.

Si përfundim, 2013 ka qenë viti i zhvillimit të marrëdhënieve më të ngushta dhe më të forta me bazën aktuale të klientëve ekzistues. Kjo mund të arrihet nëpërmjet ofrimit të shërbimit superior ndaj klientëve duke mundësuar standarte të larta profesionale.



### **ECO-Fashion Show - Sfilatë mode "ekologjike"**

Shoqata e Kërkimeve Urbane me mbështetjen e Raiffeisen Bank organizuan një sfilatë mode "ekologjike" të titulluar Eco-Fashion Show.

Mesazhi që transmeton ky spektakël është: **Redukto - Riciklo - Ripërdor - Rikrijo**

Në këtë mënyrë të gjithë ndikojmë direkt dhe indirekt në uljen e sasisë së plehrave dhe gjithashtu japim disa ide inovative në drejtim të reduktimit, riciklimit e rikrijimit, në mënyrë që të gjithë të japim kontributin tonë për të shkuar drejt një ekonomie jeshile dhe një mjedisi të qëndrueshëm.

# Thesari dhe Bankingu i Investimeve

## Të ardhurat fikse

Viti 2013 rezultoi i suksesshëm për Raiffeisen Bank, që vijon të mbetet një prej investitorëve kryesor në tregun shqiptar të letrave me vlerë. Pavarësisht një kuadri rregullator strikt të imponuar nga Bashkimi Evropian veçanërisht për aktivet e konsideruara me risk të lartë, njësia e të ardhurave fikse arriti të përmbushë qëllimet përkatëse.

Përgjatë gjithë vitit banka ka patur një portofol të mirëstrukturuar, i cili është i përbërë nga portofoli i investimeve me letra me vlerë të mbajtura deri në maturim dhe nga portofoli i tregtueshëm. Investimet afatgjata të Raiffeisen Bank në obligacione thesari ishin mbi 80 përqind e portofolit të letrave me vlerë. Në fund të muajit dhjetor 2013 portofoli i tregtueshëm kapi shifrën prej 295 milionë Euro. Përgjatë vitit 2013 Raiffeisen Bank ka pasuruar portofolin me obligacione korporatash të emtuara në Euro, në mënyrë që të alternojë investimet edhe në monedha të tjera.

Rënia e normave të interesit përgjatë vitit 2013 impaktoi investimet afat shkurtër dhe afatgjata duke e bërë këtë vit edhe më sfidues për njësinë e të ardhurave fikse, që pavarësisht vështirësive arriti të performojë suksesshëm gjatë muajve që lamë pas. Manaxhimi më së miri i investimeve të reja dhe ekzistuese prodhuan një rezultat të lartë të portofolit të tregtueshëm.

Midis të tjerave qëllimi dhe strategjia e bankës mbetet të rrisi dhe diversifikojë mundësitë dhe alternativat e investimeve për klientët, duke ju ofruar letra me vlerë të maturimeve të ndryshme. Prandaj mund të themi që Raiffeisen Bank është kontribuesi kryesor në tregun sekondar të bonove dhe obligacioneve të thesarit, duke i tregtuar ato në degët e saja në të gjithë vendin. Gjatë vitit 2013 volumi dhe numri i transaksioneve të obligacioneve të thesarit të tregtuara në tregun sekondar ishte dyfish më i lartë krahasuar me një vit më parë.

Raiffeisen Bank është një nga bankat nismëtare në pasurimin e tregut vendas me instrumente financiare dhe në këtë kontekst gjatë vitit 2013, banka kreu transaksione REPO me bankat lokale duke kontribuar në zhvillimin e tregut financiar. Raiffeisen Bank vijon të kryej aktivitetin e kujdestarit të letrave me vlerë të emtuara nga qeveria e Shqipërisë duke mundësuar investitorët e huaj dhe ata vendas të marrin pjesë në tregun e letrave me vlerë. Ky shërbim si edhe të tjerë që do të ofrohen në një të ardhme të afërme, janë pjesë e përpjekjeve dhe sfidave të bankës për të qenë pjesë e zhvillimit të tregut financiar vendas.

## Tregu i parasë

Njësia e Tregut të Parasë si një pjesë e rëndësishme e departamentit të thesarit në Dealing Room ka ndërmarrë një rol aktiv në arritjen e objektivit të bankës për riskun (RWA) për 2013, nëpërmjet përdorimit të instrumentave të ndryshëm për mirëmbajtjen e rezervës minimale pranë Bankës Qëndrore. Kjo njësi ka kontribuar vazhdimisht në mbajtjen në nivelet e duhura të koeficientit për administrimin e treguesit të likuiditetit sipas rregullores së re të Bankës së Shqipërisë.

Portofoli i Tregut të Parasë përgjatë gjithë vitit 2013 është mirëmanaxhuar duke bërë një shpërndarje sipas maturimeve të ndryshme në përputhje me rregulloret në fuqi duke përmbushur nevojat për likuiditet në çdo moment dhe në çdo monedhë.

Kjo njësi ka dhënë kontributin e saj në manaxhimin e likuiditetit duke rritur ndjeshëm numrin e transaksioneve ndërbankare sidomos në atë vendas duke e zhvilluar më tej aktivitetin nërbankarë duke përdorur instrumenta të ndryshëm. Pavarësisht nga kushtet e pafavorshme të tregut gjatë vitit 2013, njësia e Tregut të Parasë ka dhënë kontributin e saj maksimal për një manaxhim të suksesshëm të likuiditetit duke dhënë një performancë sa më të mirë në këto kushte të tregut me interesa minimale në historinë e tij.

Njësia e Tregut të Parasë mbetet pjesë aktive e një tregu lokal në zhvillim duke kontribuar edhe në kuotimet ditore për publikimin e TRIBID/TRIBOR. Këto kuotime janë një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të tregut duke pasqyruar aktivitetin e tij. Kjo njësi ka përditësuar vazhdimisht çmimet duke dhënë impaktin e saj në zhvillimin e tregut si dhe gjetjes së mundësisë së vazhdueshme për financim me likuiditet në afatshkurtër.

## Këmbimet Valutore

Edhe ky vit ka qenë një vit i suksesshëm për Njësinë e Këmbimeve Valutore. Njësia e Këmbimeve Valutore nëpërmjet analizave të situatave të ndryshme financiare që ndikuan në tregjet ndërkombëtare dhe lokale u tregua e kujdesshme në menaxhimin e pozicionit valuator dhe riskut nga luhatshmëria e kurseve të këmbimit duke finalizuar vitin 2013 me rezultate të larta financiare.

Gjatë këtij viti të dhënat e dobëta mbi treguesit ekonomik në vendet evropiane kanë treguar një recesion të ekonomisë Evropiane veçanërisht në tremujorin e parë të vitit të cilat u reflektuan në një luhatshmëri të madhe të kurseve të këmbimit në tregjet ndërkombëtare.

Kriza në ekonominë evropiane dhe veçanërisht e vendeve fqinje ka pasur ndikimin e saj edhe në tregun shqiptarë duke ulur ndjeshëm aktivitetin financiarë të bizneseve vendase.

Në tregun lokal monedha europiane ka qenë më e qëndrueshme duke u krahasuar me dollarin amerikan i cili është karakterizuar nga luhatshmëri të mëdha duke reflektuar trendin në tregjet ndërkombëtare.

Njësia e Këmbimeve Valutore dha suportin e saj maksimal në tregun lokal duke mbajtur një spread të vogël në ofertë/kërkesë të monedhave dhe duke kuotuar çmime shumë konkurruese në tregjet ndërbankare dhe për klientët.

Volumi i transaksioneve të këmbimeve valutore është rritur në krahasim me vitin 2012, duke arritur në 300 milion në muaj, ku veprimet EUR/USD zënë pjesën më të madhe.

## Njësia e Shitjeve

Njësia e shitjeve të Thesarit edhe gjatë vitit 2013, arriti të ruante pozicionin e saj në treg, duke u shërbyer në çdo moment klientëve të Raiffeisen Bank.

Falë kushteve preferenciale të ofruara për të gjitha segmentet e biznesit, kjo njësi luajti një rol kyç në eksplorimin e mundësive dhe dhënien e zgjidhjeve për klientët në lidhje me produktet e këmbimit valutor dhe normave të interesit. Përveç rritjes së fitimit dhe të qënies pranë nevojave të klientit, një objektiv themelor ishte edhe forcimi akoma më shumë i marrëdhënieve me klientët, një faktor shumë i rëndësishëm gjatë krizave financiare.

Edhe pse në një vit të vështirë përsa i takon situatës ndërkombëtare financiare, njësia e shitjeve pranë departamentit të Thesarit arriti që të realizonte objektivat e saj, duke u mbështetur në marrëdhënien e fortë me dealing room dhe njesitë e tjera të biznesit të bankës.



UNIVERSITY OF CAMBRIDGE  
ESOL Examinations  
Authorized BULATS Agent



UNIVERSITY OF  
ESOL Examinations  
Authorized BULATS Agent

International  
Public Speaking  
Competition 2014

Internatio  
Public Spea  
Competition

Sponsor of ESOL



Refreshment

Sustained  
of English







### **Raiffeisen Bank mbështet Konkursin Kombëtar Anglisht Folës në Shqipëri**

Raiffeisen Bank ka mbështetur në vitin e pestë të tij Konkursin Kombëtar Anglisht Folës në Shqipëri organizuar nga Unioni Anglisht Folës në Shqipëri.

Raiffeisen Bank gjithmonë synon që të jetë e pranishme pranë aktiviteteve që kanë për qëllim të ndihmojnë në zhvillimin e arsimit dhe kanë një ndikim pozitiv në jetën e të rinjve shqiptarë.

# Përgjegjësi Sociale

Përgjegjësia Sociale është shumë e rëndësishme për Raiffeisen Bank. Ajo është pjesë e kulturës së korporatës prandaj dhe Banka nëpërmjet sponsorizimeve ka mbështetur një numër të madh projektesh, të cilat synojnë përmirësimin e kushteve sociale, shëndetësore dhe mjedisore të komunitetit në Shqipëri. Projektet e mbështetura nga Raiffeisen Bank gjatë vitit 2013 kanë qenë të larmishme dhe gjithmonë në përputhje me politikën e sponsorizimeve të saj.

Fokus kryesor i politikës së sponsorizimeve mbetet sektori i arsimit, ku kontributi i Raiffeisen Bank edhe gjatë këtij viti ka qenë i konsiderueshëm. Një projekt i rëndësishëm në këtë kuadër ishte iniciativa e Raiffeisen Bank për të dhuruar e një lule për të gjithë mësuesit në ditën e festës së tyre në 7 Mars. Mësuesit janë pjesa më e rëndësishme e këtij sektori, ata janë faktori kryesor i edukimit, formimit dhe përgatitjes së brezit të ri, i cili është e ardhmja e vendit. Prandaj dhe banka vendosi të shprehë në mënyrë modeste mirënjohjen dhe respektin për ta dhe profesionin e tyre fisnik. Drejtoritë Arsimore në të gjithë vendin shprehën gatishmërinë e tyre për realizimin e këtij projekti që pati një ndikim shumë pozitiv në komunitet e më gjerë.

Ndërkohë kontributi i Raiffeisen Bank në këtë sektor ka vijuar me mbështetjen e projekteve edukative e kulturore për shkollat e mesme në Gjirokastrë, Shkodër, Tiranë, Lezhë, Kavajë, Ksamil etj., si dhe për Universitetet e Shkodrës, Elbasanit, Korçës e Durrësit për pajisjen tyre me kompjutera apo aktivitete, të cilat kanë pasur synim plotësimin e nevojave të studentëve për të zhvilluar sa më mirë procesin mësimor.

Si pjesë e përgjegjësisë sociale të saj, Raiffeisen Bank ka vijuar gjithashtu mbështetjen edhe për projektet me karakter social. Kështu për të tretin vit rradhazi është organizuar me sukses projekti i kampeve verore në bashkëpunim me Terres des Hommes. Këtë vit kampet e ngritura në Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë integruan më shumë se 1,000 fëmijë që vinin nga familje me vështirësi sociale e ekonomike, fëmijë romë, me aftësi të kufizuara, etj. Këta fëmijë përfituan nga mjedisi i sigurt dhe miqësor në këto kampe verore.

Projekte të tjera me karakter social, të cilat kanë gjetur mbështetjen e Raiffeisen Bank kanë qenë, aktivitete të organizuara për fëmijet jetimë me rastin e festave të fundvitit apo dhurimi i librave për shtëpinë e fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë.

Gjithashtu, një projekt shumë i rëndësishëm me karakter social-kulturor është dhe “Gjimnastrada”, projekt i cili është kthyer në traditë për fëmijët e të rinjtë e kryeqytetit dhe jo vetëm. Çdo vit “Gjimnastrada” mbledh fëmijë e të rinj të grup moshave nga 5 deri në 18 vjeç, të cilët shpalosin talentin dhe aftësitë e tyre në disiplinat e dancit sportiv, aerobisë, etj. Vitin e kaluar morën pjesë grupe të rinjsh nga shumë qytete të vendit madje edhe nga Kosova e Maqedonia.

Sektori i shëndetësisë ka qenë në fokus të mbështetjes së Raiffeisen Bank gjatë vitit të kaluar. Projekti më i rëndësishëm në këtë sektor ishte bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë, në kuadër të të cilit Raiffeisen Bank mundësoi blerjen e materialeve spitalore shumë të rëndësishme për diagnostikimin e të sëmurëve pranë klinikës onkologjike pranë QSUT-së.

Projektet mjedisore gjithashtu kanë gjetur mbështetjen e Raiffeisen Bank. Projekt i rëndësishëm në këtë fushë ka qenë bashkëpunimi me Bashkinë e Tiranës, nëpërmjet të cilit Raiffeisen Bank ka sponsorizuar mbjelljen e pemëve në Parkun e Liqenit Artificial të Tiranës. Rreth 390 pemë u mbollën në këtë zonë duke ndikuar në mënyrë të drejtë për drejt në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në kryeqytet. Gjithashtu projekt për mbjelljen e pemëve janë realizuar edhe me Bashkinë Kuçovë e Lushnjë.

Ndërkohë ka vijuar mbështetja për aksionet e pastrimit të bregdetit të organizuara nga shoqata “Forumi i Mendimit të Lirë”. Këtë vit me ndihmën e Korpusit të Vullnetarëve si dhe të vetë stafit të Raiffeisen Bank në këto zona, u pastruan plazhi i Zvërnecit dhe i Gjirit të Lalzit.

Raiffeisen Bank në Shqipëri përveç ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare mbetet gjithmonë e përkushtuar të kontribuojë dhe të përkrahë projektet në ndihmë të komunitetit dhe përmirësimit të jetës së tij si pjesë e përgjegjësisë së saj sociale.



### **Raiffeisen Bank mbështet aksionet për pastrimin e bregdetit të Spillesë në Kavajë**

Raiffeisen Bank për të pestin vit radhazi ka mbështetur nismën e Forumit të Mendimit të Lirë në aksionet e organizuara për pastrimin e bregdetit. Gjatë viteve të kaluara, Raiffeisen Bank ka mbështetur aksionet e pastrimit në zona të ndryshme bregdetare të vendit, të cilat janë mjaft të frekuentuara nga pushuesit, si Gjiri i Lalzit, Velipoja, Zvernëc, etj. Këtë vit 150 vullnetarë morën pjesë në aksionin e Korpusit të Vullnetarëve për pastrimin e plazhit të Spillesë në Kavajë.

# Burimet Njerëzore dhe Trajnimet

Me një staf me mbi 1,400 punonjës, Raiffeisen Bank është një nga punëdhënësit më të mëdhenj dhe më të mirë në Shqipëri, që ofron një mjedis shumë konkurrues përsa i përket paketës së kompensimit, zhvillimit dhe motivimit të stafit. Gjatë viti 2013 procesi i rekrutimit dhe selektimit të punonjësve ka pasur si prioritet zhvillimin e brendshëm të burimeve njerëzore. Kandidatet e brendshëm, në bazë të performancës ishin potenciali kryesor për pozicionet vakante të shpallura në Bankë.

Kështu, gjatë vitit 2013, u përzgjedhën 20 kandidatë të brendshëm u përzgjedhën si fitues të pozicioneve vakante. Në të njëjtën kohë, për të përmbushur nevojat për pozicione në nivele fillestare kryesisht në rrejetin e degëve, janë punësuar 68 punonjës të rinj, nga të cilët 10 praktikantë, pas përfundimit me sukses të programit të praktikës.

Raiffeisen Bank prej disa vitesh tashmë ka krijuar një traditë të Programit të Praktikës. Objektivi i saj është të tërheqë studentët me rezultate më të larta, të cilët tregojnë një nivel të lartë motivimi, dëshire dhe interesi për të punuar në mjedisin financiar.

Raiffeisen Bank është e përkushtuar ndaj Përgjegjësisë Sociale të Korporatës dhe programi i praktikës është një element i rëndësishëm i saj. Ne u hapim dyert studentëve të rinj nga Universitetet më prestigjiozë të vendit, që të mund të mësojnë në praktikë se si funksionon një bankë dhe t'i ndihmojmë të përgatiten sa më mirë për tregun e punës.

Gjatë vitit 2013, Raiffeisen Bank ka mbështetur gjerësisht programin FASTIP, jo vetëm duke financuar çdo vit studentët të cilët ndjekin studimet e tyre në degën "Menaxhim Bankar", por duke i përfshirë ata në aktivitetin e përditshëm bankar, për të ndërthurur sa më mirë programin mësimor me praktikën. Përmes këtij programi, studentët kanë mundësinë të njihen me frymën dhe kulturën e një kompanie ndërkombëtare dhe në fund të studimeve u ofrohet mundësia të punojnë në bankë.

Raiffeisen Bank, përveç menaxhimit të talenteve të saj, mbështet edhe iniciativat si Junior Achievement, që synojnë krijimin e liderëve të rinj, nxitjen e aftësive sipërmarrëse të tyre për t'i përgatitur ata në tregun e punës.

Shumë vullnetarë nga departamente të ndryshme të Bankës u treguan të gatshëm për të dhënë mësim në Programet e Junior Achievement si: Etika e Biznesit, Aftësitë e Suksesit, Kompania e Studentëve, të jesh sipërmarrës, si dhe ndanë me nxënësit e shkollave të mesme njohuritë dhe eksperiencën e tyre të vlefshme. Një tjetër nismë e Junior Achievement është edhe "Drejtues për një Ditë", e cila krijon një mundësi unike për nxënësit që të mësojnë nga drejtues ekzekutivë, nën mentorimin e tyre përgjatë një dite. Përmes kësaj nismë, nxënësit njihen me rolin e drejtuesit, me veprimtarinë e institucionit pritës, si dhe informohen për një zgjedhje më të mirë për karrierën e tyre të ardhshme.

Përveç kujdesit për të afruar dhe përzgjedhur rekrutet më të mirë në treg, Raiffeisen Bank është e përkushtuar gjithashtu në zhvillimin e stafit, në rritjen e njohurive dhe aftësimin profesional të tyre.

Banka beson që trajnimet dhe programet zhvilluese që ofron janë një investim strategjik për të arritur objektivat e biznesit. Për të gjithë të rekrutuarit e rinj banka implementon që prej disa vitesh 'Programin Orientues', që i përgatit të rinjtë për detyrat e reja që u caktohen dhe u lehtëson atyre integrimin në mjedisin e punës.

Gjatë punësimit në Raiffeisen Bank stafi ka gjithashtu mundësi të shumta për zhvillim dhe kualifikim. Banka ofron një gamë të gjerë programesh trajnimi dhe iniciativa zhvillimi profesional të organizuara përmes burimeve të brendshme të ekspertizës apo përmes ekspertëve të kontraktuar nga jashtë banke.

Gjatë vitit 2013 në planin vjetor të trajnimeve janë reflektuar kërkesat e secilit departament për trajnime që synojnë përditësimin dhe shtimin e njohurive teknike apo aftësive e kompetencave që nevojiten për të përballuar sfidat dhe për të arritur objektivat dhe rezultatet e kërkuara. Në këtë kuadër janë organizuar 3,917 ditë trajnimi në klasë dhe mbi 90 përqind e stafit kanë marrë të paktën një trajnim.

Përveç trajnimeve në klasë, stafi i bankës ka mundësinë që të ndjekë dhe trajnime elektronike në platformën eLearning, e cila shërben si një mjet për të menaxhuar njohuritë dhe informacionin. Menuja e trajnimeve në platformë është pasuruar në vitin 2013 me dhjetë module të reja. Përveç moduleve të zhvilluara së brendshmi në këtë platformë ofrohen dhe trajnime të zhvilluara nga Grupi RBI. Numri i frekuentuesve të trajnimeve online në 2013-ën është rritur duke regjistruar 3,236 pjesëmarrës dhe kjo shifër dëshmon për një interesim të gjerë rreth kësaj metode mësimi që ofron mjaft fleksibilitet.

Divizioni i Burimeve Njerëzore mbështet synimet afatgjata të biznesit duke u fokusuar në krijimin dhe implementim e politikave për identifikimin dhe menaxhimin e talentëve dhe punonjësve që shfaqin potencial të lartë për arritje dhe performancë konstante. Menaxhimi i këtyre talentëve dhe mbajtja e tyre përbën një faktor të rëndësishëm në suksesin e kompanisë.

Gjatë vitit 2013 vëmendje i është kushtuar implementimit të programeve për zhvillim të lidërshpit dhe aftësive menaxhuese për drejtuesit e bankës. Programet e trajnimit për drejtuesit e bankës synojnë të forcojnë kompetencat dhe sjelljet që duhet të reflektojnë drejtuesit e bankës për të udhëhequr skuadrat e punës drejt një suksesi të vazhdueshëm.

Programet e rotacionit janë një tjetër mjet që Raiffeisen Bank ofron për zhvillimin e stafit të saj përmes shkëmbimeve të eksperiencës me kolegë brenda bankës dhe jashtë bankës. Gjatë vitit 2013 kanë vijuar iniciativa të tilla brenda banke me qëllim për të njohur më mirë proceset e ndërlidhura të punës, duke i parë nga një këndvështrim më i gjerë. Banka gjithashtu ka ofruar mundësinë për punonjës të përzgjedhur për të marrë pjesë në programe rotacioni në RBl apo banka të tjera të Grupit Raiffeisen përmes vizitave të punës disajavore ose mujore për të vëzhguar praktikat më të mira apo për të punuar si pjesë e skuadrave ndërkombëtare për implementimin e iniciativave dhe projekteve të Grupit RBl.





**Raiffeisen Bank mbështet për të tretin vit radhazi kampet verore për fëmijët në situata jetese të vështira**

Raiffeisen Bank ka mbështetur sërish këtë vit kampet verore organizuar nga Terre des homes në Shqipëri. Është viti i tretë ku banka jonë ka dhënë kontributin e saj bujar në programin e kampeve verore 2013.

1,006 fëmijë përfituan nga mjedisi i sigurt dhe miqësor në të cilin duke luajtur, argëtuar dhe mësuar u ndihmuan të zbusin efektet e jetës së tyre të vështirë. Ky kamp, duke u fokusuar gjerësisht tek grupet vulnerabël, fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët nga institucionet rezidenciale dhe qendrat ditore, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët viktimë të dhunës në familje, abuzuar apo fëmijë që kanë braktisuar shkollën, solli të gjithë bashkë në një mjedis plot harmoni dhe bashkëpunim.

## **Grupi Raiffeisen**

Pasqyrat e konsoliduara sipas Standardeve  
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe  
Raporti i audituesit të pavarur



# Pasqyra përmbledhëse

<b>INFORMACION I PËRGJITHSHËM</b>	<b>150</b>
<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR</b>	<b>151</b>
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	152
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	153
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	155
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TË PARASË	156
1. Hyrje	157
2. Bazat e përgatitjes	157
3. Politikat kontabël të rëndësishme	157
4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël	166
5. Adoptimi i standardeve të reja të rishikuara dhe interpretimet	167
6. Deklarime të reja kontabël	169
7. Paraja dhe ekuivalentët e saj	170
8. Shuma të kushtëzuara	170
9. Investime në letra me vlerë	171
10. Hua dhe paradhënie për klientët	173
11. Letrat me vlerë të vlefshme për shitje	179
12. Aktiv tatimor i shtyrë	179
13. Emri i mirë	180
14. Aktive jo-materiale	180
15. Ndërtesa dhe pajisje	181
16. Aktive të tjera	182
17. Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve bankare	183
18. Detyrime ndaj klientëve	183
19. Detyrime të tjera	185
20. Borxhi i varur	186
21. Kapitali	186
22. Rezerva të tjera	186
23. Interesi jo kontrollues	186
24. Të ardhura nga interesat	186
25. Shpenzime interesi	187
26. Të ardhura nga komisionet	187
27. Shpenzime komisioni	187
28. Të ardhura neto nga tregtimi	187
29. Shpenzime të tjera operative	188
30. Primi i sigurimit të depozitave	188
31. Shpenzime personeli	188
32. Shpenzime të përgjithshme administrative	188
33. Tatimi mbi fitimin	189
34. Administrimi i rrezikut financiar	189
35. Administrimi i kapitalit	199
36. Angazhime dhe detyrime të mundshme	200
37. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare	201
38. Paraqitja e instrumentave financiarë sipas kategorisë së matjes	202
39. Palët e lidhura	203
40. Ngjarje pas datës së raportimit	204

# Informacion i përgjithshëm

## Drejtesit dhe Administratorët më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

### Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikëqyrës)

Helmut Breit	Kryetar
Heinz Hodl	Anëtar
Peter Lennkh	Anëtar
Ferenc Berszan	Anëtar
Andreas Engels	Anëtar

### Komiteti i Kontrollit

Heinz Hödl	Kryetar
Johannes Kellner	Anëtar
Susana Mitter	Anëtar

### Bordi Drejtues

Christian Canacaris	Drejtor Ekzekutiv
Alexander Zsolnai	Nën kryetar i Bordit të Drejtimit
John McNaughton	Anëtar
Raphaela Bischof-Rothauer	Anëtar

## Selia e regjistruar

Rruga e Kavajës, Ndërtesa 71, Apt. 4  
Tiranë, Shqipëri  
Telefon: +355 4 2381 381  
Fax +355 4 2275 599

## Auditues

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k  
Blvd. Dëshmorët e Kombit  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 10-të  
Tiranë, Shqipëri  
Telefon +355 42 242254/280423  
Fax +355 42 241639

# Raporti i Audituesit të Pavarur



Për Aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të Raiffeisen Bank sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të bashkëlidhura të Raiffeisen Bank sh.a. dhe filialeve të saj ("Grupi") të cilat përbëhen nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013, pasqyra e konsoliduar e fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e konsoliduar e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë si dhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe e shënimeve të tjera shpjeguese.

## Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për çdo kontroll të brendshëm që drejtimi i përcakton si të rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qofshin për shkak të mashtrimit apo gabimit.

## Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara duke u bazuar në auditimin tonë. Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të përfituar siguri të arsyeshme për mungesën e gabimeve materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për mbledhjen e evidencave të auditimit që mbështesin shumat dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara, qofshin ato për shkak mashtrimesh apo gabimesh. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara për të përcaktuar procedurat e auditimit që i përshtaten rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe arsytueshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara. Ne besojmë se evidenca e marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur opinionin tonë.

## Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara të bashkëlidhura japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të Grupit më 31 dhjetor 2013 si dhe të performancës së tij financiare dhe të flukseve të parasë për vitin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

## Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 janë audituar nga një shoqëri tjetër auditimi, raporti i së cilës daton më 27 mars 2013 dhe shpreh një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare. Opinioni ynë nuk është i kualifikuar mbi këtë çështje.

*PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k*

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.  
6 qershor 2014  
Tiranë, Shqipëri

*Kodra*

Auditues ligjor  
Kledian Kodra, FCCA

**Pasqyra e konsoliduar pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013**  
(shumat në LEK'000)

<b>Aktivët</b>	<b>Shënime</b>	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
Paraja dhe ekuivalentët e saj	<b>7</b>	35,394,831	38,153,089
Shuma të kushtëzuara	<b>8</b>	24,527,024	28,243,158
Investime të mbajtura për tregtim	<b>9.1</b>	43,867,966	41,281,170
Investime të mbajtura deri në maturim	<b>9.2</b>	65,885,928	81,381,682
Hua dhe paradhënie për klientët	<b>10</b>	116,345,848	124,576,719
Investime të mbajtura për shitje	<b>11</b>	-	37,785
Parapagim i tatimit mbi fitimin		181,178	190,190
Aktiv tatimor i shtyrë	<b>12</b>	73,902	-
Emri i mirë	<b>13</b>	92,783	92,783
Aktive afatgjata jomateriale	<b>14</b>	1,442,261	1,225,926
Ndërtesa dhe pajisje	<b>15</b>	1,881,596	1,987,074
Aktive të tjera	<b>16</b>	2,103,238	1,749,047
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>291,796,555</b>	<b>318,918,623</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	<b>17</b>	4,610,794	1,941,112
Detyrime ndaj klientëve	<b>18</b>	246,445,957	284,395,826
Detyrim tatimor i shtyrë	<b>12</b>	-	262
Detyrime të tjera	<b>19</b>	3,235,863	1,513,284
Borxh i varur	<b>20</b>	7,154,318	-
<b>Totali detyrimeve</b>		<b>261,446,932</b>	<b>287,850,484</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	<b>21</b>	14,178,593	14,178,593
Fitimi i pashpërndarë		13,233,130	13,927,529
Rezerva të tjera	<b>22</b>	2,835,352	2,860,599
<b>Aktivët neto që i atribuohen aksionarëve Bankës</b>		<b>30,247,075</b>	<b>30,966,721</b>
<b>Interest i pakicës</b>	<b>23</b>	<b>102,548</b>	<b>101,418</b>
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>30,349,623</b>	<b>31,068,139</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>291,796,555</b>	<b>318,918,623</b>

Këto pasqyra financiare të konsoliduara u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës më 5 mars 2014 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Christian Canacaris  
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai  
Nën Kryetar i Bordit Drejtues

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 10 deri në 63, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**  
(shumat në LEK'000)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura nga interesat	<b>24</b>	15,953,427	18,935,579
Shpenzime për interesa	<b>25</b>	(5,055,314)	(8,138,185)
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>		<b>10,898,111</b>	<b>10,797,394</b>
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	<b>10,19</b>	(4,082,740)	(2,822,695)
<b>Të ardhura neto pas zhvlerësimi te huave</b>		<b>6,815,371</b>	<b>7,974,699</b>
Të ardhura nga komisionet	<b>26</b>	2,106,805	1,500,585
Shpenzime për komisionet	<b>27</b>	(621,856)	(318,384)
<b>Të ardhura neto nga komisionet</b>		<b>1,484,949</b>	<b>1,182,201</b>
Të ardhura neto nga investimi	<b>11</b>	32,340	-
Të ardhura neto nga tregtimi	<b>28</b>	2,887,730	2,585,396
Shpenzime të tjera operative, neto	<b>29</b>	238,768	42,244
		<b>3,158,838</b>	<b>2,627,640</b>
Primi i sigurimit të depozitave	<b>30</b>	(855,698)	(802,684)
Shpenzime për personelin	<b>31</b>	(2,427,117)	(2,520,468)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	<b>14,15</b>	(576,959)	(572,462)
Shpenzime të përgjithshme administrative	<b>32</b>	(2,109,654)	(1,968,247)
Other operating expense	<b>29</b>	(386,349)	(143,991)
		<b>(5,969,428)</b>	<b>(5,863,861)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>5,103,381</b>	<b>5,776,688</b>
Tatimi mbi fitimin	<b>33</b>	(456,659)	(471,021)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>4,646,722</b>	<b>5,305,667</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
<i>Zëra që mund te riklasifikohen më pas në fitim humbje:</i>			
<b>Investime të mbajtura për qëllime shitje:</b>			
- Fitime minus humbje që rezultojnë gjatë vitit	<b>11</b>	<b>(37,785)</b>	-
Fitime minus humbje që mund të riklasifikohen në fitim humbje pas nxjerrjes jashtë përdorimit ose zhvlerësimit		-	<b>12,072</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(37,785)</b>	<b>12,072</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>4,608,937</b>	<b>5,317,740</b>

**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**  
(shumat në LEK'000)

	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012</b>
<b>Fitimi i atribuohet:</b>		
- Aksionarëve të bankës	4,630,834	5,289,166
- Interesi i pakontrollueshëm	15,888	16,501
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>4,646,722</b>	<b>5,305,667</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse i atribuohet:</b>		
- Aksionarëve të bankës	4,593,178	5,301,201
- Interesi i pakontrollueshëm	15,759	16,539
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	<b>4,608,937</b>	<b>5,317,740</b>
Fitimet për aksion nga fitimet që i atribuohen aksionarëve të Bankës, bazë dhe të pakësuara (shprehur në lekë për aksion)	<b>661,548</b>	<b>755,595</b>

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 10 deri në 63.

**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**  
(shumat në LEK'000)

	I atribuohen aksionarëve të Bankës					Interesi i Pakontrollueshëm	Totali i kapitalit
	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva e rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali		
<b>Teprica më 1 janar 2012</b>	<b>9,926,093</b>	<b>6,314,300</b>	<b>25,713</b>	<b>13,128,324</b>	<b>29,394,430</b>	<b>84,917</b>	<b>29,479,347</b>
Kritje e kapitalit	4,252,500	-	-	(4,252,500)	-	-	-
Transferimi nga rezerva e përgjithshme në fitimin e pashpërndarë	-	(3,491,486)	-	3,491,486	-	-	-
Dividend i paguar gjatë vitit	-	-	-	(3,728,947)	(3,728,947)	-	(3,728,947)
Fitimi i vitit	-	-	-	5,289,166	5,289,166	16,501	5,305,667
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 11)	-	-	-	12,072	12,072	-	12,072
<b>Teprica më 31 dhjetor 2012</b>	<b>14,178,593</b>	<b>2,822,814</b>	<b>37,785</b>	<b>13,927,529</b>	<b>30,966,721</b>	<b>101,418</b>	<b>31,068,139</b>
Transferimi nga rezerva e përgjithshme në fitimin e pashpërndarë	-	12,538	-	(12,538)	-	-	-
Dividend i paguar gjatë vitit	-	-	-	(5,312,695)	(5,312,695)	(14,758)	(5,327,453)
Fitimi i vitit	-	-	-	4,630,834	4,630,834	15,888	4,646,722
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 11)	-	-	(37,785)	-	(37,785)	-	(37,785)
<b>Teprica më 31 dhjetor 2013</b>	<b>14,178,593</b>	<b>2,835,352</b>	<b>-</b>	<b>13,233,130</b>	<b>30,247,075</b>	<b>102,548</b>	<b>30,349,623</b>

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 10 deri në 63.

**Pasqyra e konsoliduar e fluksit të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**  
(shumat në LEK'000)

<b>Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional</b>	<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>5,103,381</b>	<b>5,776,688</b>
<i>Zëra jo-monetarë në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse e të ardhurave</i>		
Zhvlërësimi dhe amortizimi	14,15	576,959
Humbje nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	11	5,445
Humbje/(Fitim) nga shitja e aktiveve të qendrueshme		(53,181)
Humbje nga zhvlërësimi neto nga aktivet financiare		4,082,740
E ardhura neto nga interesat		(11,289,080)
Të ardhura neto nga rivlerësimi i instrumentave të vlefshme për shitje		(42,167)
Ndryshimi në provigjone për debitorë të tjerë		(1,095)
Ndryshime në provigjone për detyrime të mundshme		214
Efekti i rivlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj		62,176
<b>Fluksi parasë nga aktiviteti operacional përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues</b>	<b>(1,554,608)</b>	<b>(1,686,738)</b>
Rënie/(Rritje) në shumat e kushtëzuara		3,716,134
Rënie / ( Rritje) në hua dhe paradhënie për klientët		3,664,598
Rënie / ( Rritje) në REPO të anasjellta /në REPO		-
Rritje investimeve të tregtueshme		(2,540,110)
Rënie në letrat me vlerë të vlefshme për shitje		(37,785)
Rritje në aktive të tjera		(313,758)
Rritje / (Rënie) në detyrimet ndaj institucioneve financiare		2,866,892
Rënie / (Rritje) në detyrimet ndaj klientëve		(35,934,167)
Rritje në detyrimet e tjera		1,684,372
<b>Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional pas ndryshimeve në kapitalin qarkullues</b>	<b>(28,448,432)</b>	<b>(28,448,432)</b>
Interesa të fituara		16,810,171
Interesa të paguara		(7,039,906)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(522,273)
<b>Paraja neto e (përdorur)/gjeneruar nga aktiviteti operacional</b>	<b>(19,200,440)</b>	<b>(5,274,043)</b>
<b>Fluksi i parasë nga aktiviteti investues</b>		
Të ardhura nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	11	32,340
Blerje e ndërtesave dhe pajisjeve	15	(363,316)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	14	(329,560)
Të ardhura neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		58,240
Të ardhura neto nga blerja dhe maturimi i letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim		70,762,975
Blerje e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim		(55,338,868)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetin financues</b>	<b>14,821,811</b>	<b>23,025,297</b>
<b>Fluksi i parasë nga aktiviteti financues</b>		
Dividend i paguar nga fitimi i pashpërndarë nga viti i kaluar		(5,327,453)
Rritja në borxhin e varur		7,010,000
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetin financues</b>	<b>1,682,547</b>	<b>(3,728,947)</b>
<b>(Rënie)/Rritje neto në para dhe ekuivalentët e saj gjatë vitit</b>	<b>(2,696,082)</b>	<b>14,022,307</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit</b>	<b>7</b>	<b>38,153,089</b>
Efekti i rivlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj		(62,176)
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	<b>7</b>	<b>35,394,831</b>
		<b>38,153,089</b>

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara e paraqitura në faqet 10 deri në 63.



# 1. HYRJE

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 për Raiffeisen Bank sh.a. ("Banka") dhe filialeve të saj ("Grupi"). Raiffeisen Bank Sh.a., më poshtë referuar ("Banka") është një institucion bankar i cili vepron në përputhje me Ligjin 9901, datë 14 Prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", dhe Ligjin 9662, datë 18 Dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe me ligjet e tjera të rëndësishme. Banka është themeluar dhe vendosur në Shqipëri dhe zhvillon aktivitetin e saj operativ në Shqipëri. Raiffeisen Bank Sh.a. është bijë 100% e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri, e cila është pala kontrolluese finale.

**Aktiviteti kryesor.** Aktiviteti kryesor i biznesit të Grupit janë operacionet bankare me pakicë në kuadër të Republikës së Shqipërisë. Banka vepron nëpërmjet një rrjeti prej 102 vendodhje shërbimi më 31 Dhjetor 2013, (31 Dhjetor 2012: 103 vendodhje shërbimi) në të gjithë Shqipërinë, të cilat administrohen në 8 rrethe dhe nuk ka operacione jashtë shtetit.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 janë autorizuar për tu publikuar nga Bordi Drejtues më 05 Mars 2014. Aprovim i pasqyrave financiare nga Aksionarët do të kryhet në Mbledhjen Vjetore të Përgjithshme të Aksionarëve.

## 2. BAZAT E PËRGATITJES

### a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Grupit janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas parimit të koston historike, të modifikuara sipas njohjes fillestare të instrumentave financiar bazuar në vlerën e drejtë, dhe sipas rivlerësimit të aktiveve financiare të mbajtura për tregtim dhe instrumentat financiar të kategorizuara me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjes. Politkat kryesore kontabël janë paraqitur më poshtë.

**Monedha e prezantimit.** Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe. Ndryshe siç tregohet, informacioni financiar i paraqitur në Lek është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

## 3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kontabël në vijim janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe.

### a) Konsolidimi i pasqyrave financiare

Filialet janë ato investime, përfshirë njësitë ekonomike të strukturuar, që Grupi i kontrollon sepse Grupi (i) ka fuqi për të drejtuar aktivitetet përkatëse të njësisë ku është investuar që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme kthimin e tyre, (ii) ka ekspozim, ose të drejta, të kthimit të ndryshueshme nga përfshirja e tij me njësinë ku është investuar, dhe (iii) ka aftësinë për të përdorur fuqinë e tij mbi të investuarit duke ndikuar në shumën e kthimit të investitorit. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave substanciale, duke përfshirë të drejtat substanciale votuese potenciale, janë konsideruar kur vlerësohet nëse Grupi ka mundësi për një entitet tjetër. Që një e drejtë të jetë e pavarur, mbajtësi duhet të ketë aftësinë praktike për ta ushtruar atë të drejtë kur vendimet për drejtimin e aktiviteteve përkatëse të filialit duhet të bëhet. Grupi mund të ketë pushtet mbi një filial edhe kur ajo mban më pak se shumica e fuqisë votuese. Në një rast të tillë, Grupi vlerëson madhësinë e të drejtave të votimit në krah të madhësinë dhe shpërndarjen e zotërimeve të bartësve të tjerë të votave për të përcaktuar fuqinë në qoftë se ajo është de- facto mbi filialet. Të drejta mbrojtëse e investitorëve të tjerë, të tilla si ato që kanë të bëjnë me ndryshimet themelore të aktiviteteve të filialit ose të zbatohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, nuk ndalojnë Grupin nga kontrollimi i filialit. Filialet janë të konsoliduara nga data në të cilën kontrolli i transferohet Grupit, dhe janë të decentralizuara nga data në të cilën përfundon kontrolli.

Metoda e blerjes kontabël është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet dhe detyrimet e keqja të konstatuara në një kombinim biznesi janë matur me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga shtrirja e çdo interes jo-kontrollues. Grupi mat interesin jo-kontrollues që përfaqëson interesin e tanishëm të pronësisë dhe i jep të drejtë mbajtësit të një pjesë proporcionale të aktiveve neto në rast të likuidimit të një transaksioni me bazë transaksioni, qoftë në: (a) vlerën e drejtë, ose (b) mos kontrollimin e një pjesë proporcionale të interesit për aktivitet neto të të blerit. Interesat jo kontrolluese që nuk përfaqësojnë interesat pronësore, maten me vlerën e drejtë.

### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### a) Konsolidimi i pasqyrave financiare (vazhdim)

Emri i mirë matet duke zbritur aktivet neto të të blerit nga totali i kostos për të blerit, shuma e interesave jo-kontrolluese të të blerit dhe vlerës së drejtë të një interesi në të blerit mbajtur menjëherë përpara datës së blerjes. Çdo shumë negative («emër i mirë negativ»), njihet në fitim ose humbje, pasi menaxhimi rivlerëson nese ajo ka identifikuar të gjitha asetet e blera dhe të gjitha detyrimet e detyrimet e keqia, si dhe shqyrton përshtatshmërinë e matjes së tyre.

Transferimi i pagesës për njësinë e blerë matet me vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentat e kapitalit të lëshuara dhe detyrimet nga marrëveshje te këqia, por përjashton blerjen e kostove tvlidhura si këshillimi, ligjori, vlerësimi dhe shërbime të ngjashme profesionale. Kostot e transaksionit që ndodhin gjatë lëshimit të instrumentave të kapitalit i zbriten kapitalit; transaksionet e ndodhura për lëshimin e borxhit i zbriten vlerës së mbartur dhe të gjitha transaksionet e tjera të lidhura me blerjen shpenzohen. Transaksionet midis kompanive, balancat dhe fitimet e pa-realizuara midis grupit të kompanive eliminohen; humbjet e perealizuara gjithashtu eliminohen përveç rastit kur kostot nuk mund të recuperohen. Banka dhe të gjitha filialet përdorin politika kontabiliteti uniforme dhe konsistente me politikat e Grupit.

Bazuar në natyrën e aktivitetit, filialet e këtij Grupi kanë disa politika specifike të kontabilitetit të cilat janë detajuar në shënimin 3 (n) për Raiffeisen Leasing sh.a. dhe në shënimet 3 (t) dhe 3 (u), për Raiffeisen INVEST.

**Blerjet dhe shitjet e interesave jo-kontrolluese.** Grupi zbaton modelin e njësisë ekonomike për të kontabilizuar transaksionet me pronarët për interesin jo-kontrollues. Çdo diferencë midis shumës së blerjes dhe vlerës kontabël të interesave jo-kontrolluese të fituar është regjistruar si një transaksion i kapitalit direkt në kapitalin neto. Grupi njeht dallimin mes konsiderimit të shitjes dhe vlerës kontabël të interesave jo-kontrolluese të shitur si një transaksion kapitali në pasqyrën e ndryshimeve në kapital.

**Interesat pjesëmarrës.** Interesat pjesëmarrës janë subjektet mbi të cilat Grupi ka ndikim të rëndësishëm (direkt ose indirekt), por nuk i kontrollon, zakonisht zotëron mes 20 dhe 50 për qind të të drejtave të votës. Investimet në interesa pjesëmarrës kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto, dhe njihen fillimisht me kosto. Vlera kontabël e interesave pjesëmarrës përfshin emrin e mirë te identifikuar të blerjes minus humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Dividendët e marrë nga interesat pjesëmarrës zvogëlojnë vlerën kontabël të investimit. Ndryshimet e tjera pas blerjes në pjesën e Grupit të aktiveve neto të një pjesëmarrje njihen si vijon: (i) pjesa e Grupit në lidhje me fitimet ose humbjet e interesave pjesëmarrës të regjistruhen në pasqyrën e konsoliduar e të ardhurave për vitin si pjesë e rezultatit të sipërmarrjeve, (ii) pjesa e Grupit e të ardhurave të tjera përmbledhëse njihet në kapitalin neto dhe të paraqitura veçmas, (iii) të gjitha ndryshimet e tjera në pjesën e Grupit të vlerës kontabël të aktiveve neto të sipërmarrjeve njihen në fitim ose humbje brenda pjesës së rezultatit nga spermarrjet. Megjithatë, kur pjesa e humbjeve të Grupit në një pjesëmarrje e barabartë ose tejkalimi i interesit të tij në pjesëmarrje, duke përfshirë çdo të arkëtueshme tjetër të pasigurtë, Grupi nuk njeht humbje të mëtejshme, nëse nuk i ka shkaktuar detyrime ose pagesa në emër të pjesëmarrjes.

Fitimet e perealizuara nga transaksionet midis Grupit dhe sipërmarrjeve të tij eliminohen deri në masën e interesit të Grupit ndaj sipërmarrjeve; humbjet e perealizuara eliminohen gjithashtu, përveçse nëse transaksioni jep dëshmi për një zhvlerësim të aktivitetit të transferuar.

**Heqja e filialeve, pjesëmarrjeve ose sipërmarrjeve të përbashkëta.** Kur Grupi pushon të ketë kontroll ose influencë të konsiderueshme, çdo interes i mbajtur në njësinë rimatet me vlerën e drejtë, me ndryshimin në vlerën kontabël njihet në fitim ose humbje. Vlera e drejtë është shuma fillestare kontabël për qëllimet e më pas të kontabilitetit për interesin e ruajtur si një pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët ose aktiv financiar. Përveç kësaj, çdo shumë e njohur më parë në kapitalin neto në lidhje me atë subjekt, llogaritet sikur Grupi kishte hequr direkt aktivet ose detyrimet e lidhura. Kjo mund të thotë se shumat e njohura më parë në të ardhurat e tjera janë të ricikluar në fitim ose humbje. Nëse interes pronësor në një pjesëmarrje është zvogëluar, por ndikim të rëndësishëm ruhet, vetëm një pjesë proporcionale e shumave të njohura më parë në kapitalin neto riklasifikohen në fitim ose humbje, kur është e përshtatshme..

#### b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj regjistruhen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në ditën e transaksionit. Aktivet dhe pasivet monetare të emetuara të monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e bilancit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kosto së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës së drejtë. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistruhen në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave.

### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### b) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kurset zyrtare të Grupit për monedhat kryesore (LEK ndaj njësisë së monedhës së huaj) më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2013		31 dhjetor 2012	
	Fund viti	Mesatar	Fund viti	Mesatar
Dollari Amerikan (USD)	101.86	105.53	105.85	108.20
Monedha e Bashkimit European (EUR)	140.20	140.23	139.59	139.04

#### c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen si fitime ose humbje në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit, ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur përllogarit interesin efektiv, Grupi merr parasysh rrjedhjet e ardhshme të parave sipas kontratës, por jo humbje të ardhshme krediti.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, të cilat janë një pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një aktiviteti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura si fitime ose humbje në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave përfshijnë:

- interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuara mbi bazën e normës së interesit efektiv
- interesat nga letrat me vlerë të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat për aktivitetet dhe detyrimet e tregtueshme konsiderohen si pjesë e aktivitetit tregtar të Grupit dhe paraqiten së bashku me të gjitha ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të tregtueshme në fitimin neto nga tregtimi.

#### d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisione dhe tarifa, duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve për llogaritë, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave, njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh, të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përftohen.

#### e) Të ardhurat neto nga tregtimi

Të ardhurat neto nga tregtimi përfshijnë fitimet minus humbje të lidhura me aktivitetet dhe detyrimet e tregtueshme dhe gjithashtu të gjitha ndryshimet në vlerë të drejtë, të realizuara ose jo, interesin, dividendët dhe ndryshimet në këmbimin valutor.

#### f) Pagesat e qirasë dhe shpenzime të tjera operative

Pagesat e bëra nën qiranë operative janë njohur në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetës së qirasë. Shpenzimet e qirasë njihen në momentin që ato ndodhin.

### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### g) Përfitimet e punonjësve

##### **Plan pensioni me kontribute të përcaktuara**

Detyrimet për planet e pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzim në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Grupi paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuar për pensione.

##### **Leja vjetore e paguar**

Grupi njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

##### **Përfitimet afatshkurtra**

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi.

Një provigjion mund të regjistrohet për shumën që pritet të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para ose planet e pjesëmarrjes në fitime, nëse Grupi ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

##### **Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës**

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës regjistrohen si shpenzim atëherë kur Grupi, në mënyrë të dukshme, ka vendosur të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur oferta është bërë, është e mundshme që oferta do të pranohet dhe numri i personave që do të pranojnë ofertën mund të matet në mënyrë të besueshme.

#### h) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Vlera e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore të pritshme kur diferencat e përkohshme do të rimerren, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm, kundrejt të cilit diferencat tatimore të zbritshme të mund të përdoren. Një pasiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktiv i tatimor i shtyrë dhe pasivi tatimor i shtyrë rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur të realizohet respektivisht përfitimi apo detyrimi fiskal i lidhur me të. Taksa të tjera shtesë lidhur me dividendin njihen kur njihet edhe detyrimi për pagimin e dividendit.

#### i) Aktivet dhe detyrimet financiare

##### *i. Njohja*

Huatë dhe parapagimet dhe depozitat njihen fillimisht me kosto në datën e krijimit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare të tjera fillimisht njihen në datën e tregtimit, datë në të cilën Grupi bëhet palë e kontratës.

##### *ii. Çregjistrimi*

Aktivt financiarë çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Grupit ndaj rrjedhjeve monetare që rrjedhin nga aktiv i financiar mbarojnë ose nëse Grupi ia transferon aktivin financiar një palë tjetër, duke humbur kontrollin ose duke transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me aktivin. Çdo interes në aktive financiare të transferuara që përfitohet ose i mbetet Grupit, njihet si një aktiv ose detyrim më vete. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Grupit të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer, ose janë anuluar. Grupi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve, për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve. Në transaksionet, në të cilat Grupi as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, aktiv i çregjistrohet nëse kontrolli mbi të humbet. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vete si aktive ose detyrime, sipas rrestit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli, Grupi vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së tij të vazhdueshëm, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Grupi është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### i) Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### iii. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësi.

##### iv. Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar të tregut, ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Grupi përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet dhe sëap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të tilla instrumenta, të dhënat për t'u përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg. Përcaktimi i vlerës së drejtë detajohet në Shënimin 4 "Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve" të pasqyrave financiare të konsoliduara dhe Shënimin 37 "Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare".

##### v. Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen (kompensohen) me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e konsoliduar e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Grupi ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregues të Grupit.

##### vi. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Grupi vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivitet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivitet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje, që sjell humbje, ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitet dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivitet, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Grupi merr në konsideratë evidencat për zhvlerësim të aktiveve të tij, si në mënyrë specifike ashtu edhe në baza kolektive. Të gjitha aktivitet financiare të konsiderueshme trajtohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivitet financiare të konsiderueshme, të cilat specifikisht nuk kanë evidencë për zhvlerësim, trajtohen në grup për ndonjë zhvlerësim të ndodhur, por të paidentifikuar ende. Aktivitet, të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme, trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku. Evidenca objektive që aktivitet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijë mospagesa, ose shkelja nga huamarrësit, ristrukturimi i një huaje, të dhëna që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si për shembull ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi, ose kushte ekonomike që lidhen me mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Grupi përdor modelimin statistikor të trend-eve historike të probabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rimarrjes dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin manaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rimarrjeve krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivitet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, rimarrja e zhvlerësimit pasqyrohet në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave.

##### vii. Klasifikimi në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Grupi i klasifikon aktivitet dhe detyrimet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes kur:

- Aktivitet ose detyrimet trajtohen, vlerësohen dhe raportohen me vlerën e drejtë të tyre;
- Klasifikimi shmang ose redukton në një masë të konsiderueshme një mospërputhje kontabël që në kushte të tjera do të ishte e pranishme; ose,
- Aktivi ose detyrimi përmban një derivativ që modifikon në mënyrë të konsiderueshme rrjedhjet monetare që do të kërkoheshin në rast të kundërt mbi bazën e kushteve kontraktuale.

### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### j) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjendje të pakushtëzuara të Bankës Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe aktive shumë likuide me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Grupi për administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Këto aktive mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar.

#### k) Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme

Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Grupi i blen ose i mban kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e portofolit, i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit, ose për përfitime afatshkurtra. Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar, duke i kaluar kostot direkte të transaksionit si fitim ose humbje në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave. Çdo fitim ose humbje si pasojë e ndryshimit në vlerën e drejtë njihet si pjesë e "Të ardhurave neto nga tregtimi" në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave. Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme nuk rriklasifikohen pas regjistrimit fillestar.

#### l) Derivatët jo të tregtueshëm

Derivatët e mbajtur për qëllime të manaxhimit të rrezikut përfshijnë të gjitha aktivët dhe detyrimet derivative të cilat nuk janë të klasifikuara si aktive ose detyrime të tregtueshme. Derivatët maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar. Kur një derivat nuk është i tregtueshëm dhe nuk klasifikohet në një marrëdhënie mbrojtje (hedge) të kualifikuar, të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të tij njihen menjëherë në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave si një përbërës i të ardhurave neto të tregtimit. Vlera e drejtë e sëap-eve (Këmbesave) të normës së interesit është shuma e vlerësuar që Grupi do të mund të përfitonte ose paguante për të përfunduar sëap-in në datën e raportimit, duke marrë parasysh normat aktuale të interesit dhe besueshmërinë e kundërpative të sëap-it. Vlera e drejtë e kontratave të ardhshme të këmbimit ('forëard') të monedhave të huaja është çmimi i tyre i tregut në datën e raportimit, pra vlera aktuale e kurseve të ardhshme ('forëard') të kuotuar në treg.

#### m) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Grupi nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër. Kur Grupi blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv thelbësisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivët në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit. Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### n) Qeratë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare sa herë që kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë ligjore janë transferuar nga qiradhënësi të qiramarrësi, dhe në këtë mënyrë të arkëtueshmet e pagesës së qerasë trajtohen nga Grupi si shlyerje e principalit të ardhurave financiare të rimbursuara dhe shpërblyera për investime dhe shërbime të Grupit. Të gjitha kontratat e tjera janë të klasifikuara si qera operative. Shumat që detyrohen nga qiramarrësit nën qira financiare janë të njohura si të arkëtueshme në vlerë e investimit neto të Grupit. Kostot e drejtpërdrejta fillestare të shkaktuara nga Grupi përfshihen në matjen fillestare të qirasë financiare të arkëtueshme dhe zvohelohet sasinë e të ardhurave të njohura përgjatë afatit të qirasë. Norma e interesit të nënkuptuar në qira është përcaktuar në mënyrë të tillë që kostot fillestare të drejtpërdrejta përfshihen automatikisht në qira financiare të arkëtueshme; nuk ka nevojë të shtohen ato veç e veç. Shpërndarja e të ardhurave financiare është bazuar në një model që pasqyron një kthim të vazhdueshëm periodik të investimit neto të kompanisë në qiranë financiare. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, duke përfshirë kostot për shërbimet, aplikohen kundrejt investimit bruto në qira për të zvogëluar si kryesore dhe të ardhurat e pafituara financiare. Pagesat minimale të marra sipas qerasë financiare ndahen në mes të ardhurave financiare dhe reduktimit të aktivitetit të shquar. Pagesat e qirasë kushtëzuara kontabilizohen duke rishikuar pagesat minimale të qirasë mbi periudhën e mbetur të qirasë kur rregullimi është i konfirmuar.

#### o) Letrat me vlerë

Investimi në letra me vlerë matet fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim kontabilizohen mbi bazën e klasifikimit, si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave, ose të disponueshme për shitje.

### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### o) Letrat me vlerë (vazhdim)

##### i. Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë klasifikuar si të disponueshme për shitje apo me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së konsoliduar përmbljedhëse të të ardhurave, për të cilat Grupi ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim mbahen më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit, do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i disponueshëm për shitje dhe do ndalonte Grupin për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhën aktuale dhe për dy vitet pasuese.

##### ii. Vlera e drejtë përmes pasqyrës së konsoliduar përmbljedhëse të të ardhurave

Grupi mban disa letra me vlerë për investime me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje, siç përshkruhet në politikën kontabël 3 (i) (vii).

##### iii. Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Investimet e disponueshme për shitje janë investime jo-derivative, të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital, të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto. Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen me vlerën e tyre të drejtë. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e konsoliduar përmbljedhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit që lidhen me investimet e disponueshme për shitje njihen në pasqyrën e konsoliduar përmbljedhëse të të ardhurave. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në kapital deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, moment në të cilin vlera progresive e njohur në kapital kalon si fitim ose humbje në pasqyrën e konsoliduar përmbljedhëse të të ardhurave.

#### p) Emri i mirë

Emri i mirë mbahet me kosto minus humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka. Grupi teston emrin e mirë për zhvlerësim të paktën çdo vit dhe sa herë që ka shenja se emri i mirë mund të jetë çvlerësuar. Emri i mirë është i ndarë për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare, apo grupeve të njësive gjeneruese të mjeteve monetare, të cilat priten të përfitojnë nga sinergjitë e kombinimit të biznesit. Këto njësi ose grup njësisish përfaqësojnë nivelin më të ulët në të cilin Grupi monitoron emrin e mirë, dhe nuk janë më të mëdha se një segment shfrytëzimi. Fitimet ose humbjet e nxjerrjes jashtë përdorimit të një operacioni brenda një njësie gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë të përfshijë vlerën kontabël të emrit të mirë të shoqëruar me operacionin e deponuar, zakonisht matet në bazë të vlerave relative të operacionit të deponuar dhe pjesë të parave të gatshme gjenerimin njësi cila ruhet.

#### q) Aktivet afatgjata materiale

##### i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërhuara nga vetë Grupi përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga Drejtimi dhe koston e çmontimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura. Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

##### ii. Kostot vijuese

The Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike, në të ardhmen që i atribuohen atij elementi, do të rrjedhin në Grup, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e konsoliduar përmbljedhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

##### iii. Zhvlerësim

Zhvlerësimi njihet me metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së vlerësimit të përdorimit të çdo zëri të aktiveve afatgjata materiale. Aktivitetet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit. Toka dhe punimet në proces nuk zhvlerësohen. Jetëgjatësitë të vlerësuar për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### q) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

	2013 (në vite)	2012 (në vite)
• Ndërtesa	20	20
• Kompjutera dhe pajisje informatike	4 to 8	4
• Automjete	5	5
• Përmirësime	1 to 10	2 to 4
• Të tjera (Pajisje Zyre)	5	5

Jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

#### r) Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale të blera nga Grupi paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivet afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej aktivitet. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave.

Shpenzimi i amortizimit njihet bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën aktivi është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e aktiveve afatgjata jomateriale është 8 vjet. Shpenzimet e kërkimit të kryera me qëllim përfitimin e një njohurie shkencore ose teknike regjistrohen si shpenzim në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

#### s) Aktive të riposeduara

Në disa rrethana të caktuara, pronat e vëna në hipotekë mund të rimerren nëpërmjet ekzekutimit të koleteraleve të hipotekuar për huatë e klasifikuara si hua të këqija. Pronat e rimarra në zotërim vlerësohen me më të voglën midis vlerës së ankandit të fundit dhe vlerës së drejtë pasi i janë zbritur kostot e shitjeve, të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara si "Aktive të tjera". Qëllimi i Drejtimit ndaj pronave të rimarra në zotërim është shitja sa më e shpejtë e tyre, duke i përdorur arkëtimet nga shitja për uljen e borxheve të këqija.

#### t) Fondi vullnetar i pensionit dhe Fondet e investimit

Raiffeisen INVEST vepron si një Kompania Menaxhuese për Fondet me kontribute të caktuara si më mëposhtë:

- Fondi me kontribute të caktuara "Fond i pensioneve vullnetar Raiffeisen", i cili është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë më 18 tetor, 2010;
- "Raiffeisen Prestige", i cili është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë më 13 dhjetor, 2011;
- "Fondi i Investimeve Raiffeisen Euro Invest", i cili është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë më 26 shtator, 2012.

Kërkesat e ligjit të ri nr 10197 datë më 10 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe ligji nr 10198 datë më 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", përfshijnë përgjegjësinë e shoqërisë administruese për të përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara për të kompaninë dhe fondet.

Më 30 nëntor 2011, në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të aksionarit të vetëm, objekti i kompanisë së menaxhimit të aktivitetit është zgjeruar për të përfshirë:

- menaxhimi i fondit të pensioneve vullnetare përmes mbledhjes dhe investimit të fondeve në bazë të ligjit nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare", si dhe në përputhje me parimin e rrezikut-përhapjes (diversifikim), me qëllim të sigurimit të përfitimeve të daljes në pension për personat që marrin pjesë në fondin e pensioneve. Kompania mund të ofrojë edhe shpërndarjen e pensionit,
- për të krijuar dhe / ose menaxhuar sipërmarrjet kolektive të investimit në bazë të ligjit nr. 10.198, datë 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive",
- Aktivitetet e tjera të përcaktuara në ligjin nr. 10.198, datë 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".



### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### t) Fondi vullnetar i pensionit dhe Fondet e investimit

Më 31 dhjetor 2013, vlera e aktiveve neto të fondit të pensionit vullnetar Raiffeisen kishte shumën 174,493 mijë Lek (2012: 113,908 mijë Lek), shuma e Raiffeisen Prestige 42,593,056 mijë Lek (2012: 15,221,687 mijë Lek) dhe shuma Raiffeisen Invest Euro 7,735,486 mijë Lek (2012: mijë Lek 786,208).

#### u) Planet e kontributeve të përcaktuara (Fondi i Pensionit Vullnetar dhe fondet e investimeve)

Në një fond me kontribute të përcaktuara, shuma e përfitimeve të ardhshme të pjesëmarrësve përcaktohet nga kontributet e paguara dhe fitimi nga investimet e fondit. Detyrimet njihen në fitim ose humbje kur matorohen dhe paraqiten si interesa të kredituara të fondit të pensioneve nën të ardhurat nga investimi dhe të ardhurat nga transaksioni. Fondet veprojnë në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar" dhe ligjit nr. 10198 me date 10 dhjetor 2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive". Gjithashtu, strategjia investuese e aktiveve të këtyre Fondeve bazohet në politikën e brendshme të investimeve të Shoqërisë Administruese dhe në rregulloren "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kurifi maksimal i investimeve të fondit të pensionit" e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare. Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 portofoli i investimeve të fondeve përfshin obligacione qeveritare dhe bono thesari, depozita afatshkurtra në banka të nivelit të dytë dhe të tjera para dhe ekuivalentë të saj. First Investment Bank (FiB) Shqipëri sh.a. vepron si bankë depozitare për të gjitha Fondet.

##### **Vlera neto e aktiveve**

Vlera neto e aseteve është e barabartë me totalin e aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

##### **Vlera e njësive së Fondit**

Vlera e njësive është e barabartë me vlerën neto të aktiveve, pjesëtuar me numrin e njësive në datën e raportimit. Bazuar në politikën e secilit Fond, vlera fillestare e një njësie ka qenë e barabartë me 1,000 Lek.

##### **Të ardhurat nga interesi**

Të ardhurat nga interesi përfshijnë të ardhurat nga kuponat e obligacioneve dhe interesave të depozitave. Të ardhurat nga interesi paraqitet bazuar në bazë të përllorarit.

##### **Komisione të Shoqërisë Administruese**

Secili Fond duhet t'i paguajë Shoqërisë Administruese një tarifë, e cila është e ndryshme për çdo Fond. Raiffeisen Prestige ka aplikuar një komision prej 1.25% (në vit) mbi vlerën neto të aktiveve (2012: 1%). Fondi Raiffeisen Invest Euro paguan një komision prej 1.5% mbi vlerën neto të aktiveve (2012: 1.5%). Fondi Vullnetar i Pensioneve paguan një komision prej 1.5% (vjetore) mbi vlerën neto të aktiveve (2012: 1.5%).

##### **Fitimi/ humbja e realizuar dhe fitimet/ humbjet e përcaktuara**

Fitimi/ humbjet e realizuara njihen në bazë të shitjes së letrave me vlerë me një diferencë ndërmjet çmimit të ofruar me vlerën e principalit dhe interesin e maturuar e letrave me vlerë të blera me prim apo zbritje. Këto dallime njihen në fitim ose humbje kur ndodhin. Fitim/ humbjet e përcaktuara njihen si diferencë midis kostos dhe vlerës së drejtë. Kur letrat me vlerë janë shitur fitimi/ humbja e përcaktuar transferohet në fitimin ose humbjen e periudhë.

#### v) Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet kryesore të financimit të Grupit. Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit. Grupi klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumente kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit. Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### w) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësive gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje monetare, të cilat janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësive gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse zhvlerësimi

### 3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

#### w) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)

është ulur apo nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

#### x) Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkojnë për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjonet caktohen duke skontuar rrjedhjet e pritshme të parave me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

#### **Humbjet nga provigjonet e huave për detyrime dhe angazhime të mundshme**

Angazhimet dhe detyrimet e mundshme të tilla si marrëveshjet undraën të jepen në rast se ata detyrohen formalisht. Detyrimet mund të zhvillohen në një mënyrë që nuk priten fillimisht. Për këtë arsye ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse një dalje e burimeve që përpëmbajnë një përfitim ekonomik është bërë e mundshme. Në qoftë se detyrimi rezulton me një obligim aktual, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, duhet njohur një provigjon në pasqyrat financiare të konsoliduara. Vetëm angazhimet e përvokueshme mund të shkaktojnë një rrezik kredie, prandaj vetëm angazhimet dhe pasiguritë e përvokueshme mund të jenë subjekt i provigjionit. Për ekspozimet e rëndësishme, vlerësimi bëhet në mënyrë individuale. Në rastet e vlerësimeve të bazuara në portofol, ndërtimi i portofolit dhe llogaritja e provigjioneve të bazuara në portofol duhet të bëhen siç tregohet në zhvlerësimet e Huave dhe Paradhëniet për klientët.

#### y) Paraqitja e pasqyrës së pozicionit financiar sipas likuiditetit

Grupi nuk ka një cikël operativ në mënyrë të qartë të identifikueshme dhe për këtë arsye nuk paraqet aktivet dhe pasivet aktuale dhe afatgjata ndaras në pasqyrën e pozicionit financiar. Në vend të kësaj, analiza e aktiveve dhe pasiveve sipas maturiteteve të tyre të pritshme paraqitet në Shënimin 34.

#### z) Krahasueshmëria

Të gjitha shumat janë raportuar apo zbulohen me informacionin krahasues.

## 4. VLERËSIMET DHE GJYKIMET TË RËNDËSISHME KONTABËL

Grupi bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumat e njohura në pasqyrat financiare, dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe të faktorëve të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat. Menaxhimi gjithashtu bën gjykimet e caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Vlerësimet që kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare dhe vlerësimeve që mund të sjellë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

#### (i) Provigjone për humbje nga kreditë

Grupi rishikon rregullisht protofolin e kredisë për të përcaktuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave për vitin, Grupi bën gjykimet nëse ka ndonjë të tregues të dukshëm që tregon se ka një ulje të ndjeshme në flukset e vlerësuarat të mjeteve monetare të ardhshme nga një portofoli i kredive para se rënia mund të identifikohet me një kredi specifike e atij portofoli. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup, ose të kushteve ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me mungesat në aktivet në grup. Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike për humbjet nga aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe prova objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofolin kur caktohen flukset e ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar të dy sasinë dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferencat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

Humbjet nga zhvlerësimi për kreditë të rëndësishme individualisht janë të bazuar në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme të skontuara të kredive individuale, duke marrë në konsideratë. Pagesa dhe realizimin me çfarëdo lloji asetit që mbahen si kolateral kundrejt huave. Një rritje 10% apo ulje në përvojën aktuale të humbjeve në krahasim me të ardhmen e vlerësuar skontuar flukset monetare nga kreditë të rëndësishme individualisht, të cilat mund të lindin nga dallimet në sasi dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare, do të rezultojë në rritjen në vlerë të zhvlerësimit të huave me

## 4. VLERËSIME DHE GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

429,433 mijë LEK respektivisht, (2012: 312,099 mijë LEK) ose një rënie të humbjeve nga zhvlerësimi të kredisë 708,547 mijë LEK (2012: 139,844 mijë lekë LEK)..

**Rimarrje zhvlerësimi nga provigjionet e zhvlerësimit per kredi dhe paradhanie.** Grupi ktheu provigjion për zhvlerësimin nga kreditë prej 1,537,762 mijë Lek (2012: 1,591,110 mijë Lek) kryesisht si rezultat i përmirësimit të gjendjes financiare të huamarrësit e saj.

### (ii) Përcaktimi i vlerave të drejta

Informacion në lidhje me vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare që janë vlerësuar duke përdorur supozime të cilat nuk janë të bazuara në të dhënat e tregut të vëzhgueshme është paraqitur në Shënimin 37.

## 5. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bene efektive për Grupin që prej 1 Janar 2013:

**SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" (të lëshuara në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013)** zëvendëson të gjithë udhëzimet në kontroll dhe konsolidim të SNK 27 "Pasqyrat financiare të ndara dhe të konsoliduara" dhe KIRFN – 12 "Konsolidimi – entitetet me qëllim të veçantë". SNRF 10 ndryshon përkufizimin e kontrollit në mënyrë që të njëjtat kriteret aplikohen te të gjitha entitetet për të përcaktuar kontrollin. Ky përkufizim mbështetet nga udhëzime më të gjera aplikimi. Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

**SNRF 11 « Marrëveshje të përbashkëta » (i lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013)** zëvendëson SNK 31 "Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta" dhe KIRFN 13 « Entitete të kontrolluara bashkërisht – Kontribute jo monetare nga sipërmarrësit ». Ndryshimet në përkufizime kanë reduktuar numrin e llojeve të marrëveshjeve të përbashkëta në dy: operacione të përbashkëta dhe sipërmarrje të përbashkëta. Zgjedhja e politikës ekzistuese për konsolidimin proporcional të entiteteve të kontrolluara bashkërisht është eliminuar. Kontabiliteti i kapitalit është i detyruar për pjesëmarrësit në sipërmarrje të përbashkëta. Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

**SNRF 12 « Paraqitja e interesave në entitete të tjera » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013)** aplikohet në entitete që kanë interes në një filial, një sipërmarrje të përbashkët, me pjesëmarrje ose një entitet me strukturë të pakonsoliduar. Kjo zëvendëson kërkesat për paraqitje që më përpara gjendeshin te SNK 28 « Investime në Pjesëmarrje ». SNRF 12 u kërkon entiteteve të paraqesin informacionin që ndihmon lexuesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën, riskun dhe efektet financiare të lidhura me interesat e entitetit në filiale, në entitetet me pjesëmarrje, sipërmarrje të përbashkëta dhe entitete me strukturë të pakonsoliduar. Në mënyrë që të arrihen këto objektiva, standardi i ri kërkon paraqitjen në disa fusha, duke përfshirë dhe gjykimet dhe supozimet e bëra nëse një entitet kontrollon, kontrollon bashkërisht, ose ndikon në mënyrë të konsiderueshme interesat e saj në entitete të tjera, shpalosjen e mëtejshme të pjesës së interesave të pakontrolluara në aktivitetet e grupit dhe flukseve të mjeteve monetare, të përmbledhura në informacionin financiar të filialeve me interesa të pakontrolluara materiale, paraqitje të detajuara të interesave në entitete me strukturë të pakonsoliduar. Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

**SNRF 13 « Matje në Vlerën e Drejtë » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013)** përmirësoi konsistencën dhe reduktoi kompleksitetin duke dhënë një përkufizim të rishikuar të vlerës së drejtë, dhe një burim të matjes së vlerës së drejtë dhe kërkesat e paraqitjes për përdorim në të gjithë SNRF-të. Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

**SNK 27 « Pasqyra të Ndara Financiare » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013)** u ndryshua dhe objektivi i saj tashmë është të përcaktojë kërkesat kontabël dhe të paraqitjes për investimet në filiale. Udhëzimi në kontroll dhe pasqyra financiare të konsoliduara u zëvendësua nga SNRF 10 « Pasqyra Financiare të Konsoliduara ». Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

**SNK 28 « Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013).** Ndryshimi i SNK 28 rezultoi nga projekti i Bordit për sipërmarrjet e përbashkëta. Gjatë diskutimit të projektit, Bordi vendosi të përfshijë kontabilitetin për sipërmarrjet e përbashkëta duke përdorur metodën e kapitalit të SNK 28 sepse kjo metodë aplikohet si për sipërmarrjet e përbashkëta ashtu dhe atyre me pjesëmarrje. Përveç këtij rasti, udhëzimet e tjera mbeten të pandryshuara. Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

## 5. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (VAZHDIM)

**SNK 1 i ndryshuar « Prezantimi i Pasqyrave Financiare » (e lëshuar në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013)** ndryshoi paraqitjen e artikujve të prezantuar të të ardhura të tjera të përmbledhura. Ndryshimet kërkojnë që entitetet të ndajnë artikujt e prezantuar në të ardhura të tjera të përmbledhura në dy grupe, bazuar në faktin nëse ato do të riklasifikohen apo jo në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të ardhmen. Titulli i sugjeruar i përdorur nga SNK 1 ka ndryshuar në « pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera të përmbledhura ». Standardi i ndryshuar rezultoi në ndryshimin e prezantimit të pasqyrave financiare, po nuk pati impakt në matjen e transaksioneve apo balanca.

**SNK 19 i ndryshuar « Përfitimet e Punonjësve » (e lëshuar në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013)** rezulton në ndryshime të rëndësishme në njohjen dhe matjen e shpenzimeve për pension dhe për largimin nga puna, si dhe për paraqitjen e të gjitha përfitimëve të punonjësve. Standardi kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në pasivin (aktivin) neto të përcaktuar të përfitimëve, në momentin që ato ndodhin si më poshtë :

- (i) Kosto e shërbimit dhe interesi neto në të ardhura shpenzime dhe
- (ii) Rimatjet e të ardhurave të tjera të përmbledhura

Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

« Paraqitja – Kompensimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare » – Ndryshimet e SNRF 7 (e lëshuar në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013). Ndryshimet kërkojnë paraqitjen në mënyrë të tillë që i mundëson përdoruesit e pasqyrave financiare të Grupit të vlerësojnë efektin ose efektin potencial të netimit të rregullimeve, duke përfshirë të drejtat e netimit. Standardi i ndryshuar nuk ka impakt material në pasqyrat financiare të Grupit.

**Përmirësime të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (e lëshuar në Maj 2012 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013).** Përmirësimet konsistojnë në ndryshimet e pesë standardeve. SNFR 1 ndryshoi në (i) qartësimin se entiteti që përmbledh përgatitjen e Pasqyrave Financiare SNFR mund të ketë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme SNFR 1 ose të gjitha SNFR retrospektivisht pasi nuk kishte ndaluar kurrë së aplikuari ato, dhe (ii) për të shtuar një përjashtim nga zbatimi i SNK 23 «Kostot e huamarrjes», në mënyrë retrospektive nga adoptuesit për herë të parë. SNK 1 është ndryshuar për të qartësuar se shënimet shpjeguese nuk janë të nevojshme për të mbështetur bilancin e tretë bilancin e paraqitur në fillim të periudhës se mëparshme kur ai jepet pasi ndikohet materialisht nga një riparaqitje retrospektive, ndryshime ne politikat kontabël dhe riklasifikime për qëllime prezantimi, ndërkohë që shënimet shpjeguese do të kërkojnë kur një entitet në mënyrë vullnetare vendos të japë pasqyra krahasuese shtese. SNK 16 u ndryshua për të sqaruar që pajisjet për shërbim që janë përdorur për më shumë se një periudhë klasifikohen si aktive fikse, jo si inventar. SNK 32 u ndryshua për të sqaruar se pasojat e caktuara tatimore të shpërndarjeve tek pronarët duhet të kontabilizohen në pasqyrën e të ardhurave si kërkohej gjithmonë nga SNK 12. SNK 34 u ndryshua për të sjellë kërkesat e saj në përputhje me SNRF 8. SNK 34 tani kërkon dhënien e një sasive të totalit të aktiveve dhe detyrimeve për një segment operative vetëm nëse informacioni përkatës i jepet rregullisht vendimmarrësit operacional dhe ka pasur një ndryshim material në ato masa që nga pasqyrat financiare vjetore të fundit. Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

**«Ndryshimet e Udhëzimeve të Tranzicionit në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12» (publikuar në qershor të vitit 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2013).**

Ndryshimet qartësojnë udhëzimet e tranzitore në SNRF 10 « Pasqyrave të Konsoliduara Financiare ». Njësitë ekonomike që adoptojnë SNRF 10 duhet të vlerësojnë kontrollin në ditën e parë të periudhës vjetore në të cilën SNRF 10 është e miratuar, dhe në qoftë se konkluzioni i konsolidimit nën SNRF 10 ndryshon nga SNK 27 dhe KIRFN 12, periudha krahasuese e mëparshme ( pra, viti 2012) është riparaqitur, përveç nëse e pazbatueshme. Ndryshimet gjithashtu të sigurojnë lehtësim tranzicioni shtesë në SNRF 10, SNRF 11 « Marrëveshjet e përbashkëta » dhe SNRF 12 «Shpalosja e interesave në entitete të tjera », duke kufizuar kërkesën për të siguruar informacion të përshtatur krahasues vetëm për periudhën që menjëherë paraprin periudhën krahasuese. Më tej, ndryshimet heqin kërkesën për të paraqitur informacion krahasues për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me subjektet e pakonsoliduara të strukturuar para se SNRF 12 të zbatohet për herë të parë. Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë, përveç zbatimit të lehtësim nga zbulimi i disa informacioneve krahasuese në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

**Standarde dhe interpretime të tjera të rishikuara:** KIRFN (Komiteti i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar) 20 "Kostot e pastrimit të minierave sipërfaqësore në fazën e prodhimit", merr në konsideratë kur dhe si të llogariten përfitimet që rrjedhin nga aktiviteti i pastrimit të sipërfaqes në industrinë e minierave. Interpretimi nuk kishte ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Grupit. Ndryshimet në SNRF 1 «Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për herë të parë – Kreditë qeveritare», të cilat janë lëshuar në Mars 2012 dhe të bëra efektive për periudha njëvjeçare duke filluar nga 1 Janar 2013, ju vijjnë në ndihmë përdoruesve për herë të parë të SNRF-ve nga zbatimi i plotë retrospektiv i kërkesave të kontabilitetit për kreditë e marra nga qeveria me norma më të ulëta se tregu. Ndryshimi nuk është i vlefshëm për Grupin.

## 6. DEKLARIME TË REJA KONTABËL

Janë hartuar disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014 ose më vonë, dhe të cilat nuk janë përdorur nga Grupi më përpara.

**SNRF 9 “Instrumentet Financiare: Klasifikimi dhe vlerësimi”.** Veçoritë kryesore të standardit të hartuar në Nëntor 2009 dhe të ndryshuar në Tetor 2010, Dhjetor 2011 dhe Nëntor 2013 janë:

- Instrumentet financiare kërkohet të klasifikohen në dy kategori: ato që vlerësohen me vlerën e drejtë dhe ato që maten me koston e amortizuar. Vendimi për këtë merret në fazën fillestare të njohjes së instrumentit financiar. Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të njësisë për të menaxhuar këto instrumente dhe karakteristikat e flukseve të mjeteve monetare të kontraktuara të instrumentit.
- Një instrument mbahet me kosto të amortizuar vetëm nëse është instrument borxhi, si dhe (i) objektivi i modelit të biznesit të njësisë është ta mbajë aktivin deri në mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare të kontraktuara dhe (ii) flukset e mjeteve monetare të kontraktuara të aktivit përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (që do të thotë se aktiviteti ka vetëm “karakteristika bazë të kredisë”). Të gjitha instrumentet e tjera të borxhit mbahen me vlerën e drejtë duke krijuar fitim ose humbje.
- Të gjithë instrumentet e kapitalit mbahen me vlerë të drejtë. Instrumentet e kapitalit të mbajtura për shitje do të mbahen me vlerë të drejtë me fitim apo humbje. Për të gjithë investimet e tjera në instrumente kapitali, në fazën e njohjes fillestare bëhet një zgjedhje e pandryshuar për të njohur fitimet apo humbjet e realizuara ose të porealizuara në të ardhurat e tjera përmbledhëse në vend të fitimit ose humbjes. Nuk duhet bërë riciklim i fitimeve nga vlera e drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kjo zgjedhje mund të bëhet në bazë të instrumentit. Dividendët paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për sa kohë që ata përfaqësojnë një kthim nga investimi.
- Shumë nga kërkesat e SNK 39 për klasifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve financiare kaluan të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi i vetëm konsiston në kërkesën që njësia të paraqesë efektet e ndryshimeve në riskun e kredisë të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Ndryshimet e bëra në SNRF 9 në Nëntor 2013 hoqën datën efektive të detyrueshme, duke bërë zbatimin e standardit vullnetarisht. Kompania nuk synon të përshatë versionin aktual të SNRF 9.

**“Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare” – Ndryshimet e SNK 32 (lëshuar në Dhjetor 2011 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014 ose më pas).** Ndryshimet shtuan udhëzime të aplikimit të SNK 32 për të trajtuar mospërputhjet e identifikuar gjatë aplikimit të kriterëve të netimit. Kjo përfshin qartësimin e kuptimit të “aktualisht ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për netim” dhe që disa sisteme pagesash bruto mund të konsiderohen ekuivalente me pagesa neto. Grupi po shqyrton implikimet e ndryshimeve dhe ndikimin në Grup.

**Ndryshimet e SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – Njësiti investuese” (lëshuar në 31 Tetor 2012 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014).** Ndryshimi paraqiti një përkufizim të një njësie investuese si një njësi që (i) siguron fonde nga investitorë me qëllim shpërblimin e tyre me shërbime të menaxhimit të investimeve, (ii) angazhohet tek investitorët që qëllimi i biznesit është investimi i fondeve vetëm për rritjen e vlerës së kapitalit ose të ardhurave nga investimi dhe (iii) mat dhe vlerëson investimet e saj në bazë të vlerës së drejtë. Një njësi Investuese kërkohet të përllogarisë për filialet vlerën e drejtë me fitim apo humbje dhe të konsolidojë vetëm ato filiale që ofrojnë shërbime të lidhura me aktivitetet investuese të njësisë. SNRF 12 u ndryshua për të futur mënyra të reja paraqitjeje, duke përfshirë gjykime të rëndësishme në përcaktimin nëse një njësi investuese dhe nëse informacioni financiar ose jo për një filial të pa konsoliduar është një synim apo i është ofruar filialit. Grupi nuk pret që ndryshimi të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

**KIRFN 21 – “Mbledhja e taksave (lëshuar në 20 Maj 2013 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014).** Interpretimi qartëson kontabilizimin e një detyrimi për të paguar taksa/tatime që nuk janë tatim fitim. Ngjarja që shkakton një detyrim është ajo ngjarje e identifikuar nga legjislacioni që shoqëron detyrimin me një pagesë takse. Fakti që njësia është ekonomikisht e detyruar të vazhdojë të operojë në një periudhë të ardhshme, ose përgatit pasqyrat financiare me supozimin e vazhdimësisë, nuk krijon një detyrim. Të njëjtat parime njohjeje aplikohen në pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore. Zbatimi i interpretimit të detyrimeve që rrjedhin nga skemat e tregtimit të emetimeve është fakultativ. Grupi po vlerëson aktualisht ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.

**Ndryshimet e SNRF 36 – “Paraqitjet e vlerës së rikuperueshme nga aktivitet jo-financiare” (lëshuar në Maj 2013 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014;** zbatimi më përpara lejohet vetëm nëse SNRF 13 aplikohet për të njëjtën periudhë kontabël dhe krahasuese). Ndryshimet heqin kërkesat për paraqitjen e vlerës së rikuperueshme kur një Njësi Gjeneruese e Mjeteve Monetare përmban emër të mirë ose aktive jomateriale me jetë të papërcaktuar, por që nuk janë zhvlerësuar. Grupi po vlerëson aktualisht ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.

## 6. DEKLARIME TE REJA KONTABEL (VAZHDIM)

**Ndryshimet e SNRF 39 – “Ndryshimet e derivativeve dhe vazhdimësia e kontabilitetit të mbrojtjes” (lëshuar në Qershor 2013 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014).** Ndryshimet do të lejojnë vazhdimin e kontabilitetit të mbrojtjes në një situatë ku një derivativ, i cili është trajtuar si një instrument mbrojtës, është ndryshuar (p.sh. palët kanë vendosur të zëvendësojnë palën tjetër) me qëllim që të ndikojë kompensimin me një palë tjetër qendrore si rezultat i ligjeve ose rregulloreve, nëse përmbushen disa kushte specifike. Grupi po vlerëson aktualisht ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.

**Ndryshimet e SNK 19 – “Plani i përcaktuar i përfitimeve: kontributet e punonjësve” (lëshuar në Nëntor 2013 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Korrik 2014).** Ndryshimi i lejon njësitë të njohin kontributet e punonjësve si një reduktim i kostove të shërbimit në periudhën në të cilën shërbimi i punonjësit është dhënë, në vend që të atribuohet kontributi në periudhën e shërbimit, nëse shumën e kontributeve të punonjësve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit. Ndryshimi nuk pritet të ketë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Grupit.

Përveçse ndryshe nga sa është përcaktuar më sipër, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

## 7. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Arka	2,455,397	2,459,612
Banka Qëndrore		
Llogari rrjedhëse	1,401	96,952
Depozita	-	1,300,000
Interesi i përllogaritur i depozitave	-	80
Banka		
Llogari rrjedhëse me bankat rezidente	39,434	58
Llogari rrjedhëse me bankat jo- rezidente	260,942	4,721,931
Depozita me bankat rezidente me maturitetet me të vogël se tre muaj	-	2,673,025
Depozita me bankat jo- rezidente me maturitetet me të vogël se tre muaj	32,637,657	26,901,431
<b>Totali</b>	<b>35,394,831</b>	<b>38,153,089</b>

Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qëndrore nuk fitojnë interes

Normat vjetore të interesit mbi depozitat me afat me bankat jo-rezidente më 31 Dhjetor 2013 variojnë nga 0.05% deri në 0.75% (31 dhjetor 2012: 0.05% deri në 0.58%). Normat vjetore të interesit mbi depozitat me afat me bankat rezidente më 31 Dhjetor 2013 asnjë (31 dhjetor 2012: 3.90% deri në 4.60%).

## 8. SHUMA TË KUSHTËZUARA

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Banka Qëndrore		
Rezerva e detyrueshme	24,019,125	27,679,797
Banka		
Llogari garancie	507,899	563,361
<b>Totali</b>	<b>24,527,024</b>	<b>28,243,158</b>

## 8. SHUMA TË KUSHTËZUARA (VAZHDIM)

Rezerva e detyrueshme me Bankën Qëndrore nuk është për përdorim të përditshëm nga Banka dhe përfaqëson një rezervë minimale depozite, të kërkuar nga Banka Qëndrore e Shqipërisë. Rezerva të tilla llogariten si 10% i shuma mesatare e depozitave për muajin të detyruar ndaj bankave dhe klientëve, dhe janë si në LEK dhe në monedhë të huaj (USD dhe EUR).

Analiza e cilësisë së parasë në Banka dhe shumave të kushtëzuara mund të përmblihet bazuar vlerësimet e Standard and Poor si më poshtë më 31 dhjetor 2013:

	2013	2012
As në vonesë apo të zhvlerësuara		
A-1	24,513,854	29,735,610
A-1+	3,233,166	1,681,088
A-2	15,965	26,241
B	26,638	26,522
Të pavlerësuara	29,676,836	34,926,728
<b>Vlera Kontabël</b>	<b>57,466,459</b>	<b>66,396,189</b>

## 9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË

### 9.1 Investime të mbajtura për tregtim

Letrat me vlerë të tregëtueshme përfshijnë bonot e thesarit të qeverisë shqiptare dhe Obligacione të qeverisë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Obligacione të qeverisë	350,836	358,760
Bono thesari	43,517,130	40,922,410
<b>Totali</b>	<b>43,867,966</b>	<b>41,281,170</b>

Bonot e thesarit më 31 Dhjetor 2012 i referohen bonove të qeverisë me kupon zero me normë të brendshme kthimi që varion nga 3.63% deri në 6.64% në vit (31 dhjetor 2012: nga 6.35% deri në 7.37%).

Obligacionet e qeverisë më 31 dhjetor 2013 kanë të bëjnë me obligacionet në Lek 2- vjeçare, 3- vjeçare, 5- vjeçare dhe 7- vjeçare të emetuara nga qeveria e Shqipërisë me normë kuponit nga 4.69% deri në 11.00% në vit (31 dhjetor 2012: nga 7.56% deri në 11.00%).

### 9.2 Investime të mbajtura deri në maturim

Investime të mbajtura deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë shqiptare si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Bono thesari (Shënimi 9.2.1)	16,013,434	17,926,923
Obligacione të qeverisë (Shënimi 9.2.2)	47,641,842	63,454,759
Bonde korporatash (9.2.3)	2,230,652	-
<b>Totali</b>	<b>65,885,928</b>	<b>81,381,682</b>

Më 31 Dhjetor 2013 nuk janë mbajtur bono thesari si garanci për portofolin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (2012: asnjë)

## 9. INVESTIME NE LETRA ME VLERE (VAZHDIM)

### 9.2 Investime të mbajtura deri në maturim (vazhdim)

#### 9.2.1 Bono thesari

Bonot e thesarit më 31 Dhjetor 2013 kanë të bëjnë me Bonot e Thesarit të Qeverisë së Shqipërisë me kupon zero dhe norma të brendshme të kthimit nga 3.63% në 7.10% në vit (31 dhjetor 2012: nga 4.99% në 7.10%).

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Vlera nominale e obligacioneve	16,406,757	18,630,597
Zbritja e paamortizuar	(393,323)	(703,674)
<b>Totali</b>	<b>16,013,434</b>	<b>17,926,923</b>

#### 9.2.2 Obligacionet e qeverisë

Obligacionet e qeverisë më 31 Dhjetor 2013 kanë të bëjnë me obligacionet në LEK 2-year, 3-vjeçare, 5-vjeçare, 7-vjeçare dhe 10-vjeçare të emtuara nga qeveria e Shqipërisë me përqindje kuponi nga 4.69% në 11.00% në vit (31 dhjetor 2012: nga 7.38% në 11.00%).

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Vlera nominale e bondeve	46,703,645	62,048,971
Primi i paamortizuar	10,574	13,656
Interesi i përlogaritur	927,623	1,392,132
<b>Totali</b>	<b>47,641,842</b>	<b>63,454,759</b>

#### 9.2.3 Bondet e Korporatave

Obligacionet e Korporatave më 31 dhjetor 2013 përfaqësojnë bonde 1-vjeçare në EUR me përqindje kuponi që varion nga 3.25% në 3.75% në vit (31 dhjetor 2012: 0).

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Vlera nominale e bondeve	2,145,060	-
Primi i paamortizuar	6,546	-
Interesi i përlogaritur	79,046	-
<b>Totali</b>	<b>2,230,652</b>	<b>-</b>

Instrumentat financiare te borxhit janë pa kolateral.

Analiza sipas cilësisë së kredisë së letrave me vlerë të investimit është përmbledhur si më poshtë në 31 dhjetor 2013 dhe 2012:

	Investime të mbajtura për tregtim		Investime të mbajtura deri në maturim	
	2013	2012	2013	2012
As në vonesë as të zhvlerësuara	-	-	-	-
B	43,867,966	41,281,170	63,655,275	81,381,682
AA+	-	-	725,369	-
BBB+	-	-	633,562	-
BBB	-	-	723,472	-
Të pavlerësuara	-	-	148,250	-
<b>Vlera Kontabël</b>	<b>43,867,966</b>	<b>41,281,170</b>	<b>65,885,928</b>	<b>81,381,682</b>



## 10. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Hua dhe paradhënie për klientët	128,452,725	135,995,090
Provigjone për zhvlerësimin e huave	(12,106,877)	(11,418,371)
<b>Vlera neto</b>	<b>116,345,848</b>	<b>124,576,719</b>

Lëvizjet në provigjonet për zhvlerësimin e huave janë si më poshtë::

	2013	2012
Balance at the beginning of the year	11,418,371	10,865,948
Allowance for loan loss impairment	5,580,950	4,412,006
Release for loan loss impairment	(1,537,762)	(1,591,110)
Loans written off	(3,354,682)	(2,268,473)
<b>Balance at the end of the year</b>	<b>12,106,877</b>	<b>11,418,371</b>

Përqindjet e interesit për huatë dhe paradhëniet për klientët variojnë nga 1.82% në 9.58% në vit në monedhë të huaj dhe nga 6.57% në 19.02% në vit në LEK (31 dhjetor 2012: nga 2.34% në 10.22% në vit në monedhë të huaj dhe nga 7.12% në 19.36% në vit në LEK).

Huatë dhe huadhëniet për klientët të detajuara sipas segmenteve të biznesit më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

31 dhjetor 2013						
	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	TOTALI
<b>Overdraft</b>	<b>1,629,311</b>	<b>47,351,926</b>	<b>5,219,787</b>	<b>705,274</b>	<b>68,521</b>	<b>54,974,819</b>
<b>Karta krediti</b>	<b>379,433</b>	<b>59</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>41,184</b>	<b>420,676</b>
<b>Kredi</b>						
Afat-shkurtër	131,326	1,997,372	111,396	6,129	1,521	2,247,744
Afat-mesëm	3,429,569	20,065,084	3,113,586	690,218	107,897	27,406,354
Afat-gjatë	7,046,818	17,854,134	3,258,323	385,376	214,321	28,758,972
	<b>10,607,713</b>	<b>39,916,590</b>	<b>6,483,305</b>	<b>1,081,723</b>	<b>323,739</b>	<b>58,413,070</b>
<b>Hipotekë</b>	<b>8,218,561</b>	<b>-</b>	<b>289,252</b>	<b>254,990</b>	<b>2,461,470</b>	<b>11,224,273</b>
<b>Të tjera</b>	<b>353,239</b>	<b>2,484,969</b>	<b>757,104</b>	<b>245,639</b>	<b>18,843</b>	<b>3,859,794</b>
<i>Minus tarifë administrimi</i>	(158,103)	(219,751)	(48,807)	(13,246)	-	(439,907)
<b>TOTALI</b>	<b>21,030,154</b>	<b>89,533,793</b>	<b>12,700,641</b>	<b>2,274,380</b>	<b>2,913,757</b>	<b>128,452,725</b>

## 10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET (VAZHDIM)

31 dhjetor 2012						
	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	TOTAL
<b>Overdraft</b>	<b>2,137,172</b>	<b>46,733,603</b>	<b>5,716,631</b>	<b>1,125,523</b>	<b>68,125</b>	<b>55,781,054</b>
<b>Karta krediti</b>	<b>328,290</b>	-	-	-	<b>39,892</b>	<b>368,182</b>
<b>Huatë</b>						
Afat-shkurtër	149,280	764,404	128,729	12,373	1,229	<b>1,056,015</b>
Afat-mesëm	3,518,209	24,855,866	3,107,301	1,337,698	127,920	<b>32,946,994</b>
Afat-gjatë	8,303,794	18,778,852	3,081,429	453,544	351,364	<b>30,968,983</b>
	<b>11,971,283</b>	<b>44,399,122</b>	<b>6,317,459</b>	<b>1,803,615</b>	<b>480,513</b>	<b>64,971,992</b>
<b>Hipotekë</b>	<b>8,813,112</b>	-	<b>62,630</b>	<b>316,515</b>	<b>1,875,804</b>	<b>11,068,061</b>
<b>Të tjera</b>	<b>545,324</b>	<b>2,519,473</b>	<b>967,959</b>	<b>289,424</b>	<b>3,583</b>	<b>4,325,763</b>
Minus tarifë administrimi	(169,236)	(273,473)	(53,282)	(23,971)	-	<b>(519,962)</b>
<b>TOTALI</b>	<b>23,625,945</b>	<b>93,378,725</b>	<b>13,011,397</b>	<b>3,511,106</b>	<b>2,467,917</b>	<b>135,995,090</b>

Përqëndrimet e riskut në sektorin ekonomik brenda portofolit të kredive të klientëve është si më poshtë:

<i>In thousands of LEK</i>	2013		2012	
	Shuma	%	Shuma	%
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiake	43,223,407	34%	46,286,756	34.0%
Individë	23,942,915	19%	26,093,861	19.2%
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	19,346,678	15%	18,673,599	13.7%
Industria e përpunimit	10,273,526	8%	10,613,443	7.8%
Ndërtim	9,521,395	7%	12,331,468	9.1%
Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	6,780,955	5%	6,474,686	4.8%
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni	4,416,410	3%	4,259,132	3.1%
Industria nxjerrëse	3,299,586	3%	4,070,535	3.0%
Bujqësia dhe gjuetia	2,197,762	2%	2,147,694	1.6%
Kolektive, sociale dhe personale	2,117,384	2%	2,298,686	1.7%
Shëndetësi dhe punë sociale	1,642,342	1%	1,404,930	1.0%
Të tjera	1,690,364	1%	1,340,300	1.0%
<b>Totali i huave dhe huadhëniesve për klientët (përpara zhvlerësimit)</b>	<b>128,452,724</b>	<b>100%</b>	<b>135,995,090</b>	<b>100%</b>

## 10. HUA DHE PARADHËNIE PER KLIENTET (VAZHDIM)

Më 31 Dhjetor 2013 Grupi kishte 21 huamarrës (2012:21 huamarrës) me shumën e kredisë mbi 1,000,000 mijë lekë. Totali i kredisë së marrë nga këta klientë është 53,983,544 mijë (2012: LEK 54,892,033 mijë) ose 42% e totalit të portofolit të kredisë (2012: 41%). Informacioni mbi kolateralin më 31 Dhjetor 2013 është si më poshtë:

	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	Totali
Kredi te pasiguruara	12,043,636	1,895,787	56,355	1,285,885	1,052,314	16,333,977
Kredi te siguruara nga banka te tjera	-	893,654	-	-	-	893,654
Kredi te siguruara nga te trete	421,443	16,788,684	52,959	-	2,407	17,265,493
Kredi te kolateralizuara me:	-	-	-	-	-	-
- pasuri te paluajtshme rezidente	6,756,203	9,751,407	2,321,169	388,570	1,786,876	21,004,225
- te tjera pasuri te paluajtshme	837,361	16,950,812	7,045,332	287,213	52,986	25,173,704
- investime te tregtueshme	622,290	838,642	24,657	13,178	800	1,499,567
- depozite cash	31,312	39,948,469	2,447,571	69,945	-	42,497,297
- Makuna dhe active te levizshme/ Mjete	317,908	2,466,337	752,598	229,590	18,375	3,784,808
<b>Totali i Hua dhe paradhënie për klientët</b>	<b>21,030,153</b>	<b>89,533,792</b>	<b>12,700,641</b>	<b>2,274,381</b>	<b>2,913,758</b>	<b>128,452,725</b>

Informacioni mbi kolateralin më 31 dhjetor 2012 është si më poshtë:

	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	Totali
Kredi te pasiguruara	13,514,768	2,720,344	70,004	1,561,503	889,724	18,756,343
Kredi te siguruara nga banka te tjera	-	1,137,756	-	-	-	1,137,756
Kredi te siguruara nga te trete	442,910	17,257,627	40,334	9,288	11,202	17,761,361
Kredi te kolateralizuara me:						
- pasuri te paluajtshme rezidente	7,067,425	9,936,570	2,443,802	903,215	1,504,345	21,855,357
- te tjera pasuri te paluajtshme	1,028,757	17,079,934	7,111,193	536,519	46,331	25,802,734
- investime te tregtueshme	1,170,647	906,722	24,888	-	13,961	2,116,218
- depozite cash	-	41,871,499	2,369,516	244,874	-	44,485,889
- Makuna dhe active te levizshme/ Mjete	401,438	2,468,273	951,662	255,707	2,352	4,079,432
<b>Totali i Hua dhe paradhënie për klientët</b>	<b>23,625,945</b>	<b>93,378,725</b>	<b>13,011,399</b>	<b>3,511,106</b>	<b>2,467,915</b>	<b>135,995,090</b>

Mjete të tjera përfshijnë kryesisht pajisje dhe llogaritë e arkëtueshme. Paraqitja e mësipërme përfaqëson vlerën më të ulët midis vlerës kontabël neto të kredisë ose të kolateralit marrë, pjesa e mbetur është shpalosur në ekspozimet e të pasigurta. Vlera e mbartur e huave është ndarë në bazë të likuiditetit të aktiveve të marra si kolateral.

## 10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET (VAZHDIM)

Duke filluar nga dhjetori 2013, Grupi ka implementuar një sistem të ri vlerësimi për konsumatorët jo-të vegjël (Korporatave dhe SME-ve). Kreditë e zhvlerësuara janë kredi për të cilat Grupi konstaton se është e mundshme nëse ato do të jenë në gjendje të rikuperojnë principalin dhe interesin e duhur, në bazë të kushteve kontraktuale të marrëveshjes së kredisë. Këto kredi janë të vlerësuara në intervale prej 1A deri në 10C në sistemin e vlerësimit të brendshëm të rrezikut të kredisë së Grupit (2012: Shënimi 5).

Analiza e cilësisë së kredisë të huave dhe paradhënieve në 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Korporata	SME	Mikro biznes	Individë	Totali
<b>Kredi as në vonesë e as të zhvlerësuara:</b>					
Shkalla 2C	3,505,579	-	-	-	3,505,579
Shkalla 3B	1,528,004	-	-	-	1,528,004
Shkalla 4A	623	-	-	-	623
Shkalla 4B	-	497,329	-	-	497,329
Shkalla 5B	113,720	1,464,410	-	-	1,578,130
Shkalla 5C	668,178	-	-	-	668,178
Shkalla 6A	84,469	824,158	-	-	908,627
Shkalla 6B	623,477	601,070	-	-	1,224,547
Shkalla 6C	1,618,885	519,149	-	-	2,138,034
Shkalla 7A	1,636,618	866,689	-	-	2,503,307
Shkalla 7B	2,989,918	893,522	-	-	3,883,440
Shkalla 7C	2,574,448	590,096	-	-	3,164,544
Shkalla 8A	23,520,594	328,656	-	-	23,849,250
Shkalla 8B	4,859,119	466,440	-	-	5,325,559
Shkalla 8C	5,451,605	69,695	-	-	5,521,300
Shkalla 9A	7,017,116	-	-	-	7,017,116
Shkalla 9B	2,386,830	998,981	-	-	3,385,811
Shkalla 9C	1,877,844	-	-	-	1,877,844
Shkalla 10A	23	56	-	-	79
Shkalla (pa klasifikuar)	1,229,135	1,991	1,326,079	20,144,593	22,701,798
<b>Totali i kredive as në vonesë e as të zhvlerësuara:</b>	<b>61,686,185</b>	<b>8,122,242</b>	<b>1,326,079</b>	<b>20,144,593</b>	<b>91,279,099</b>
<b>Kredi ne vonesë, por jo të zhvlerësuara:</b>					
	Korporata	SME	Mikro biznes	Individë	Totali
- më pak se 30 dite vonesë	6,805,150	1,237,790	206,357	1,196,965	9,446,262
- 30 deri ne 60 dite vonesë	5,199,315	689,182	96,398	300,894	6,285,789
- 60 deri ne 90 dite vonesë	1,872,162	101,901	75,565	277,195	2,326,823
- 90 deri ne 180 dite vonesë	197,968	128,188	79,155	302,935	708,246
- 180 deri ne 360 dite vonesë	667,933	102,102	11,129	76,354	857,518
- mbi 360 dite vonesë	782,510	397,158	76,480	58,551	1,314,699
<b>Totali i kredive ne vonesë, por jo të zhvlerësuara</b>	<b>15,525,038</b>	<b>2,656,321</b>	<b>545,084</b>	<b>2,212,894</b>	<b>20,939,337</b>

## 10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET (VAZHDIM)

<b>Kredi të zhvlerësuara individualisht (bruto)</b>					
- më pak se 30 dite vonesë	-	-	1,121	22,379	23,500
- 30 deri ne 60 dite vonesë	-	-	653	2,457	3,110
- 60 deri ne 90 dite vonesë	-	-	581	525	1,106
- 90 deri ne 180 dite vonesë	5,716,836	123,957	7,543	18,427	5,866,763
- 180 deri ne 360 dite vonesë	1,472,377	108,188	114,227	683,584	2,378,376
- mbi 360 dite vonesë	5,134,347	1,689,935	279,096	858,056	7,961,434
<b>Totali i kredi të zhvlerësuara individualisht (bruto)</b>	<b>12,323,560</b>	<b>1,922,080</b>	<b>403,221</b>	<b>1,585,428</b>	<b>16,234,289</b>
<b>Minus provigjonet</b>	(8,898,160)	(1,427,382)	(319,900)	(1,461,435)	(12,106,877)
<b>Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët</b>	<b>80,636,623</b>	<b>11,273,261</b>	<b>1,954,484</b>	<b>22,481,480</b>	<b>116,345,848</b>

Analiza e cilesisë së kredisë të huave dhe paradhënieve më 31 Dhjetor 2012 është si më poshtë:

	<b>Korporata</b>	<b>SME</b>	<b>Mikro biznes</b>	<b>Individë</b>	<b>Totali</b>
<b>Kredi as në vonesë apo të zhvlerësuara</b>	-	189,384	-	-	189,384
Shkalla 1	2,291,300	618,152	-	-	2,909,452
Shkalla 1.5	1,381,646	1,286,514	-	-	2,668,160
Shkalla 2	8,845,441	1,253,352	-	-	10,098,793
Shkalla 2.5	7,573,394	934,222	-	-	8,507,616
Shkalla 3	32,104,674	1,101,140	-	-	33,205,814
Shkalla 3.5	3,474,796	1,427,039	-	-	4,901,835
Shkalla 4	7,000,340	1,261,404	-	-	8,261,744
Shkalla 4.5	150,194	152,896	-	-	303,090
Shkalla 5	1,907,712	44,952	1,932,201	19,730,812	23,615,677
Shkalla(pa klasifikuar)	-	6,939	155,502	256,747	419,188
<b>Totali i Kredive as në vonesë apo të zhvlerësuara</b>	<b>64,729,497</b>	<b>8,275,994</b>	<b>2,087,703</b>	<b>19,987,559</b>	<b>95,080,753</b>
<b>Kredi në vonesë por jo të zhvlerësuara</b>					
- me pak së 30 dite vonesë	16,817,628	1,387,911	349,146	1,798,846	20,353,531
- 30 deri në 90 dite vonesë	3,016,071	1,042,711	140,297	561,173	4,760,252
- 90 deri në 180 dite vonesë	636,993	184,985	135,542	361,040	1,318,560
- 180 deri në 360 dite vonesë	95,842	335,614	17,401	5,942	454,799
- mbi 360 ditë vonesë	304,050	140,369	50,659	5,411	500,489
<b>Totali i kredive në vonesë por jo të zhvlerësuara</b>	<b>20,870,584</b>	<b>3,091,590</b>	<b>693,045</b>	<b>2,732,412</b>	<b>27,387,631</b>
<b>Kredi te zhvlerësuara individualisht (bruto)</b>					
- me pak së 30 dite vonesë	1,052,421	63,331	17,836	304,150	1,437,738
- 30 deri në 90 dite vonesë	1,360,017	1,489	9,950	132,719	1,504,175
- 90 deri në 180 dite vonesë	1,956,783	81,701	27,219	105,336	2,171,039
- 180 deri në 360 dite vonesë	980,595	379,453	142,253	449,923	1,952,224
- mbi 360 ditë vonesë	2,428,830	1,164,738	486,201	2,381,761	6,461,531
<b>Totali i kredive të zhvlerësuara individualisht (bruto)</b>	<b>7,778,646</b>	<b>1,690,712</b>	<b>683,459</b>	<b>3,373,889</b>	<b>13,526,706</b>
<b>Minus provigjonet</b>	(6,176,727)	(1,348,985)	(666,564)	(3,226,094)	(11,418,371)
<b>Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët</b>	<b>87,202,000</b>	<b>11,709,311</b>	<b>2,797,643</b>	<b>22,867,766</b>	<b>124,576,719</b>

## 10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET (VAZHDIM)

### Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Grupi ka përcaktuar se është e mundur që ajo mos të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe principalit të huasë në bazë të kushteve të kontratës. Këto hua vlerësohen me shkallën 0.5 deri në 5 në sistemin e brendshëm të kategorizimit të rrezikut.

### Hua me vonesë por jo të zhvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë ku pagesat e interesit ose pagesat e principalit janë me vonesë, por që Grupi beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të shkallës së garancive / kolateralit të vlefshëm dhe /ose shkallës së arkëtimit të shumës së huasë.

### Hua me kushte të rinegociueshme

Hua me kushte të rinegociueshme janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Grupi ka bërë lëshime, të cilat nuk do t'i bënte në rast të kundërt. Në momentin që huaja është ristrukturuar, qëndron në të njëjtën kategori, edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet. Me 31 Dhjetor 2013 hua të ristrukturuara ishin LEK 18,022,824 mijë (2012:LEK 19,224,525 mijë).

### Fondi për zhvlerësim

Grupi vendos një provigjion për humbjet nga zhvlerësimet që përfaqëson vlerësimin e Grupit për humbjet e ndodhura të portofolit. Përbërësit kryesorë të këtij provigjioni janë: një komponent për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme individualisht dhe një provigjion i përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara, por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime.

### Politikat e fshirjes

Grupi fshin një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjion për humbjet nga zhvlerësimi) kur Komiteti i Kredive Problematike të Grupit vendos që huatë/letrat me vlerë janë të pa arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhia e ngjarjeve të konsiderueshme, të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total. Më poshtë është paraqitur analiza e shumave neto dhe bruto (e provigjioneve për zhvlerësim) të aktiveve individualisht të zhvlerësuar, sipas shkallës së rrezikut. Më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012, huatë dhe paradhëniet e klientëve në lidhje me balancën dhe llogaritja e zhvlerësimi është si më poshtë:

Hua dhe paradhënie klientëve		
	Bruto	Neto
<b>31 dhjetor 2013</b>		
Të zhvlerësuar individualisht	16,234,289	6,680,380
<b>Totali</b>	<b>16,234,289</b>	<b>6,680,380</b>
<b>31 dhjetor 2012</b>		
Të zhvlerësuar individualisht	13,526,706	3,920,772
<b>Totali</b>	<b>13,526,706</b>	<b>3,920,772</b>

Grupi mban kolaterale për huatë dhe paradhëniet e klientëve në formën e hipotekave për pasuritë, letra të tjera me vlerë të bllokuara dhe garanci. Vlerësimet e vlerave të drejta bazohen në vlerën e kolateralit në kohën kur merret huaja dhe në përgjithësi ri-vlerësohen çdo vit nga vlerësues të jashtëm dhe të brendshëm. Për huatë që i jepen bankave të tjera nuk mbahet kolateral, përveç rasteve kur letrat me vlerë mbahen si pjesë e riblerjeve të anasjellta dhe aktivitetit huamarrës të letrave me vlerë. Në përgjithësi nuk mbahet kolateral për investimet në letrat me vlerë. Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 nuk është mbajtur një kolateral i tillë.

## 10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET (VAZHDIM)

	Kundrejt zhvlerësimeve individuale	Kundrejt zhvlerësimeve në grup	Totali
Prona	4,740,155	30,005,671	34,745,826
Peng	1,697,129	13,908,589	15,605,718
Para	-	1,510,568	1,510,568
Garanci	32,056	800,778	832,834
<b>Totali</b>	<b>6,469,340</b>	<b>46,225,606</b>	<b>52,694,946</b>

Kolaterali i lënë peng për huatë e zhvlerësuar individualisht më 31 Dhjetor 2012 ishte 3,714,710 mijë Lek.

### **Efeki financiar i kolateralit mbi provigjionin**

Efeki financiar i kolateralit prezantohet si ndikim i kolateralit dhe përmirësimit të kredive të tjera nga provigjionet e zhvlerësimit të njohura në fund të periudhës raportuese. Pa mbajtjen e kolateralit dhe përmirësimeve të tjera të kreditit, dispozitat nga zhvlerësimi do të ishin më të larta nga shumtat e mëposhtme:

	31 December 2013	31 December 2012
Korporata	3,390,595	2,382,560
Mikro Biznes	129,466	145,921
Individe	299,876	254,027
SME	943,361	854,681

## 11. LETRAT ME VLERË TË VLEFSHME PËR SHITJE

Grupi kishte në pronësi 2,355 aksione të Visa Inc me një vlerë totale kontabël të 37,785 mijë lekë në 31 dhjetor 2012. Ato janë shitur në gjatë vitit 2013 për një shumë prej 32.340 mijë lekë.

## 12. AKTIV TATIMOR I SHTYRË

Lëvizja në aktivin tatimor të shtyrë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Gjendja në fillim të periudhës	(262)	(125,375)
Shpenzimet nga tatimi i shtyrë lidhur me krijimin dhe rimarrjen e diferencave të përkohshme (Shënimi 32)	74,164	125,113
<b>Gjendja në fund të periudhës</b>	<b>73,902</b>	<b>(262)</b>

Lëvizjet në diferencat e përkohshme gjatë vitit njihen dhe paraqiten në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave. Aktiv i tatimor i shtyrë është llogaritur në bazë të normës së tatimit sipas legjislacionit shqiptar për 2013 është 10% (2012: 10%). Për 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 tatimi i shtyrë i aktiveve dhe detyrimeve është njohur për zërat më poshtë.

## 12. AKTIV TATIMOR I SHTYRË (VAZHDIM)

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
<b>Aktiv tatimor i shtyrë</b>		
Zhvlërësim kontabël i përshpejtuar	71,260	82,047
Tarifa e shtyrë e disbursimit të qerasë	1,615	181
	<b>72,875</b>	<b>82,228</b>
<b>Detyrim tatimor i shtyrë</b>		
Provigjone për humbje nga rënia në vlerë	1,027	(82,490)
	<b>1,027</b>	<b>(82,490)</b>
<b>Aktiv tatimor i shtyrë neto</b>	<b>73,902</b>	<b>(262)</b>

## 13. EMRI I MIRË

Gjatë vitit 2008, Raiffeisen Bank bleu 100% të aksioneve të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. ("Raiffeisen INVEST"), për një shumë prej 109,648 mijë lekë. Blerja është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë bazuar në vendim Nr.30, të datës 26 mars 2012, të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Shqipërisë më 23 prill. Raiffeisen INVEST ka një kapital të paguar prej 90 milionë lekë më 31 dhjetor 2013 (2012: 90 milionë lekë).

Emri i mirë në datën e blerjes është llogaritur si tejkalim i kostos së kombinimit të biznesit mbi aktivet neto të njësive ekonomike të blerë që janë identifikuar, duke rezultuar në një shumë prej 92,783 mijë lekë. Aktivet neto të njësive ekonomike të blerë në datën e blerjes të identifikuar përafrohen me vlerën e tyre të drejtë prej 16.865 mijë lekë.

Emri i mirë testohet për zhvlërësim të paktën çdo vit ose sa herë që ka tregues se emri i mirë mund të jetë çvlerësuar. Më 31 dhjetor 2013 vlera kontabël e filialit (njësia gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë), nuk e tejkalon vlerën e rikuperueshme dhe për këtë arsye emri i mirë konsiderohet të mos jetë i zhvlërësuar. Nuk ka humbje nga zhvlërësimi të njohur në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (2012: zero).

## 14. AKTIVE JO-MATERIALE

Lëvizjet e aktiveve jo-materiale për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2013 dhe 2012 detajohen si më poshtë:

	Software	Liçensa	Totali
<b>Kosto</b>			
Gjendja më 1 Janar 2012	1,028,439	292,999	1,321,438
Shtesa	693,349	45,218	738,567
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>1,721,788</b>	<b>338,217</b>	<b>2,060,005</b>
<b>Gjendja më 1 Janar 2013</b>	1,721,788	338,217	2,060,005
Shtesa	307,417	22,143	329,560
Nxjerrje jashtë përdorimi	(96,255)	(8,181)	(104,436)
Transferim nga punime në proces	(2,534)	2,534	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1,930,416</b>	<b>354,712</b>	<b>2,285,129</b>



## 12. AKTIVE JO-MATERIALE (VAZHDIM)

<b>Amortizimi i akumuluar</b>			
Gjendja më 1 Janar 2012	(483,861)	(228,519)	(712,380)
Amortizimi gjatë vitit	(77,778)	(43,921)	(121,699)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>(561,639)</b>	<b>(272,440)</b>	<b>(834,079)</b>
<b>Gjendja më 1 Janar 2013</b>			
Gjendja më 1 Janar 2013	(561,639)	(272,440)	(834,079)
Amortizimi gjatë vitit	(103,188)	(9,912)	(113,100)
Nxjerrje jashtë përdorimi	96,131	8,181	104,312
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>(568,696)</b>	<b>(274,171)</b>	<b>(842,867)</b>
<b>Vlera e mbetur neto:</b>			
<b>Më 1 Janar 2012</b>	<b>1,160,149</b>	<b>65,777</b>	<b>1,225,926</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1,361,720</b>	<b>80,541</b>	<b>1,442,261</b>

Nuk ka asnjë aktiv të vendosur si kolateral më 31 dhjetor 2013 (2012: asnjë)

## 15. NDËRTESA DHE PAJISJE

Lëvizjet në ndërtesa dhe pajisje për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë detajuar si më poshtë:

	<b>Toka dhe ndërtesa</b>	<b>Kompjuterë &amp; ATM</b>	<b>Automjete</b>	<b>Punë në proces</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>						
Gjendja më 1 Janar 2012	1,223,543	2,149,415	323,061	155,817	609,268	4,461,104
Shtesa	423	237,921	42,322	311,932	40,476	633,074
Nxjerrje jashtë përdorimi	(316)	(155,975)	(3,740)	-	(52,152)	(212,183)
Transferim nga punime në proces	142,539	75,579	6,918	(242,815)	17,779	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>1,366,189</b>	<b>2,306,940</b>	<b>368,561</b>	<b>224,934</b>	<b>615,371</b>	<b>4,881,995</b>
Gjendja më 1 Janar 2013	1,366,189	2,306,940	368,561	224,934	615,371	4,881,995
Shtesa	36,495	158,167	27,349	112,608	28,698	363,317
Nxjerrje jashtë përdorimi	(11,827)	(316,921)	(18,832)	-	(26,610)	(374,190)
Transferim nga punime në proces	96,025	185,797	2,239	(293,433)	9,372	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1,486,882</b>	<b>2,333,983</b>	<b>379,317</b>	<b>44,109</b>	<b>626,831</b>	<b>4,871,122</b>
<b>Zhvlrësimi i akumuluar</b>						
Gjendja më 1 Janar 2012	(424,209)	(1,653,780)	(173,668)	-	(401,329)	(2,652,986)
Zhvlrësimi gjatë vitit	(91,343)	(219,975)	(55,383)	-	(84,062)	(450,763)
Nxjerrje jashtë përdorimi	316	155,183	3,739	-	49,590	208,828
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>(515,236)</b>	<b>(1,718,572)</b>	<b>(225,312)</b>	<b>-</b>	<b>(435,801)</b>	<b>(2,894,921)</b>

## 15. NDËRTESA DHE PAJISJE (VAZHDIM)

Gjendja më 1 Janar 2013	(515,236)	(1,718,571)	(225,312)	-	(435,802)	(2,894,921)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(98,868)	(251,764)	(47,507)	-	(65,721)	(463,860)
Nxjerrje jashtë përdorimi	10,668	315,390	18,631	-	24,566	369,255
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>(603,436)</b>	<b>(1,654,945)</b>	<b>(254,188)</b>	<b>-</b>	<b>(476,957)</b>	<b>(2,989,526)</b>

### Vlera e mbetur neto:

<b>Më 1 dhjetor 2012</b>	<b>850,953</b>	<b>588,368</b>	<b>143,249</b>	<b>224,934</b>	<b>179,570</b>	<b>1,987,074</b>
--------------------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	------------------

<b>Më 1 dhjetor 2013</b>	<b>883,446</b>	<b>679,038</b>	<b>125,129</b>	<b>44,109</b>	<b>149,874</b>	<b>1,881,596</b>
--------------------------	----------------	----------------	----------------	---------------	----------------	------------------

Nuk ka asnjë aktiv të vendosur si kolateral më 31 dhjetor 2013 (2012: asnjë).

## 16. AKTIVE TË TJERA

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Inventarët	1,197,523	845,049
TVSH e arketueshme	592,258	660,544
Debitorë të tjerë, neto	163,607	116,465
Shpenzimet e parapaguara dhe të përlogaritura	135,986	115,932
Money gram	13,864	11,057
<b>Totali</b>	<b>2,103,238</b>	<b>1,749,047</b>

Më 31 Dhjetor 2013 kolateralët e marrë në riposedim nga Grupi kanë vlerën e 1,197,523 mijë LEK (2012: mijë 845,049 LEK). Kolaterali i zotëruar është i përbërë nga toka dhe ndërtesa të blera nga Grupi në shlyerjen e kredive në vonesë. Grupi pret ti shesë aktivet në të ardhmen e afërt. Pasuritë nuk plotësojnë përkufizimin e aktiveve afatgjatë të mbajtur për shitje, dhe klasifikohen si inventar në përputhje me SNK 2 «Inventarët». Pasuritë njihen fillimisht me vlerën e drejtë kur blihen.

Debitorë të tjerë, përfshin zërat e mëposhtëm:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Debitorë të tjerë	175,190	128,048
Provizion për humbjet nga debitorë të tjerë	(11,583)	(11,583)
<b>Debitorë të tjerë, neto</b>	<b>163,607</b>	<b>116,465</b>

Lëvizja në provigjionet për debitorë të tjerë paraqitet si më poshtë:

	2013	2012
Gjendja në fillim të periudhës	11,583	13,553
Ndikimi i kursit të këmbimit	-	(1,970)
<b>Gjendja në fund të periudhës</b>	<b>11,583</b>	<b>11,583</b>

## 17. DETYRIMET NDAJ BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE BANKARE

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
<b>Llogari rrjedhëse</b>		
Bankat dhe institucionet financiare rezidente	256,840	138,380
Bankat dhe institucionet financiare jo-rezidente	13,990	421,744
Interesi i përlllogaritur	2,357	2,458
	<b>273,187</b>	<b>562,582</b>
<b>Depozita</b>		
Depozite me Banken Qendrore	210,000	-
Bankat dhe institucionet financiare rezidente	3,892,934	1,376,727
Bankat dhe institucionet financiare jo-rezidente	232,252	-
Interesi i përlllogaritur	2,421	1,803
<b>Totali</b>	<b>4,610,794</b>	<b>1,941,112</b>

Normat e interesit vjetor për fondet e marra hua nga institucionet financiare variojnë nga 0.06% në 4.75% gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2013 (2012: 0.10% në 5.05%). Normat e interesit vjetor për fondet e marra hua nga institucionet financiare jorezidente variojnë nga 0.19% në 0.35% gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2013 (2012: 0).

## 18. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Llogari rrjedhëse	61,445,038	49,394,687
Depozita	181,592,691	231,275,044
Llogari të tjera	3,408,228	3,726,095
<b>Totali</b>	<b>246,445,957</b>	<b>284,395,826</b>

Normat vjetore të interesit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat të aplikuara gjatë periudhës nga 1 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor 2013 për afate të ndryshme janë si më poshtë:

(in %)	LEK	USD	EUR
Llogari rrjedhëse	0.01-1.50	0.01-0.30	0.01-0.50
Depozita pa afat	0.25-3.00	0.10-0.90	0.10-1.70
Depozita me afat – 3 mujore	0.20-3.30	0.10-1.35	0.10-1.30
Matjet e vlerës së drejtë analizohen nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë: (i) niveli parë janë një matje me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktive ose detyrime të njëjta, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknika të vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose pasivin në mënyrë të drejtpërdrejtë (që është, si çmimet) ose indirekt (domethënë, rrjedhin nga çmimet), dhe (iii) të nivelit të tre matjet janë vlerësimet jo të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme në treg (pra, jo të inpleteve vëzhgueshme). Drejtimi aplikon gjykimin në kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse matja e një vlere të drejtë përdor të dhëna të vëzhgueshme që kërkojnë rregullim të rëndësishëm, ajo matje është matje e Niveli 3. Rëndësia e një inputi vlerësimi vlerësohet kundrejt matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e tij. Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ata që standarde të kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese. Vlerat e drejta të analizuara nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerat kontabël të aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	2013			2012	
	Vlera e drejtë Nivel 1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	Totali	
<b>Hua dhe paradhënie me bankat</b>	-	26,913,259	30,551,799	<b>57,425,628</b>	<b>63,839,683</b>
<b>Hua dhe paradhënie për klientët</b>	-	-	128,452,726	<b>128,452,726</b>	<b>124,576,719</b>
<b>Letrat me vlerë të tregëtueshme</b>	-	43,867,966	-	<b>43,867,966</b>	<b>41,281,169</b>
<b>Investime të mbajtura në maturim</b>	-	66,284,834	-	<b>66,284,834</b>	<b>81,381,795</b>
<b>Detyrime nga bankat</b>	-	-	4,610,794	<b>4,610,794</b>	<b>1,941,112</b>
<b>Depozita nga klientet</b>	-	-	246,469,202	<b>246,469,202</b>	<b>288,488,241</b>

## 37. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### **Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijn depozita ndërmjet bankave dhe mjete të tjera në procesin e arkëtimit. Duke qënë se këto balanca kanë afat të shkurtër dhe janë me norma interesi të ndryshueshme, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën kontabël.

### **Investimet në letrat me vlerë**

Investimet në letrat me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e rrjedhjeve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur.

### **Hua dhe paradhënie klientëve**

Huatë dhe paradhëniet mbarten me vlerën e mbetur pakësuar nga provigjonet. Portofoli i huave të Grupit ka një vlerë të drejtë të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të afërta me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të huave është subjekt i rçmimeve brenda një viti.

### **Detyrime nga/ ndaj bankave dhe institucioneve financiare**

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve ndaj bankave dhe institucioneve financiare është pothuajse e barabartë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të përafërta me normat e tregut

### **Depozita nga klientët**

Vlera e drejtë e depozitave pa afat, që përfshijn dhe depozitat pa interes, është vlera që i paguhet klientit sipas kërkesës.

## 38. PARAQITJA E INSTRUMENTAVE FINANCIARË SIPAS KATEGORISË SË MATJES

Për qëllime matjeje, SNK 39 "Instrumentat financiare: Njohja dhe Matja", i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: (a) hua dhe paradhënie; (b) aktive financiare të mbajtura për shitje; (c) aktive financiare të mbajtura në maturim dhe (d) aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarive të fitim humbjes ("FVTPL"). Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarive të fitim humbjes ndahen në dy kategori: (i) aktive të destinuara si të tilla që në njohje dhe (ii) ato të klasifikuara të mbajtura për tregtim. Qeraja financiare është një kategori më vete. Tabela e mëposhtme paraqet aktivet financiare sipas këtyre kategorive të matjes në 31 Dhjetor 2013:

	Hua dhe paradhnie	Investime të mbajtura për shitje	Investime të mbajtura për tregtim	Investime të mbajtura në maturim	Totali
<b>Aktivët</b>					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	35,394,831	-	-	-	35,394,831
Shuma të kushtëzuara	24,527,024	-	-	-	24,527,024
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	43,867,966	-	43,867,966
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	65,885,928	65,885,928
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	116,345,848	-	-	-	116,345,848
<b>Total Aktive financiare</b>	<b>176,267,703</b>	<b>-</b>	<b>43,867,966</b>	<b>65,885,928</b>	<b>286,021,597</b>

## 38. PARAQITJA E INSTRUMENTAVE FINANCIARË SIPAS KATEGORISË SË MATJES (VAZHDIM)

Tabela e mëposhtme paraqet aktivet financiare sipas këtyre kategorive të matjes në 31 Dhjetor 2012:

	Hua dhe paradhenie	Investime te mbajtura per shitje	Investime te mbajtura per tregtim	Investime te mbajtura ne maturim	Totali
<b>Aktivët</b>					
Paraqja dhe ekuivalentët e saj	38,153,089	-	-	-	38,153,089
Shuma të kushtëzuara	28,243,158	-	-	-	28,243,158
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	41,281,170	-	41,281,170
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	81,381,682	81,381,682
Hua dhe paradhenie për klientët, neto	124,576,719	-	-	-	124,576,719
Investime të mbajtura për qëllime shitje		37,785	-	-	37,785
<b>Total Aktive financiare</b>	<b>190,972,966</b>	<b>37,785</b>	<b>41,281,170</b>	<b>81,381,682</b>	<b>313,673,603</b>

Në 31 Dhjetor 2013 and 31 Dhjetor 2012, të gjitha detyrimet financiare të Grupit përveç derivativeve mbahen me vlerë të mbetur.

## 39. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët, ose njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore. Transaksionet me palët e lidhura përbëhen nga transaksione me Raiffeisen International AG, Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft (RZB AG), me filialet e Bankës, me drejtorët dhe me zyrtarët ekzekutivë. Vlera agregate e transaksioneve të kryera dhe gjendjet pezull me palët e lidhura janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
<b>Kërkesa nga</b>		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	17,726,555	18,898,394
Të tjera kompani të lidhura	25,612	18,853
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>17,752,167</b>	<b>18,917,247</b>
<b>Detyrimet ndaj</b>		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	(7,388,266)	(658)
Të tjera kompani të lidhura	(18,324)	(399,643)
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>(7,406,590)</b>	<b>(400,301)</b>

**39. PALET E LIDHURA (VAZHDIM)**

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
<b>Të ardhurat nga interesi, neto</b>		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	(133,733)	21,490
Të tjera kompani të lidhura	(13,109)	(2,423)
<b>Totali të ardhurat nga interesi, neto</b>	<b>(146,842)</b>	<b>19,067</b>
<b>Shpenzime komisioni, neto</b>		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	(22,715)	(18,739)
Të tjera kompani të lidhura	(159,074)	(118,978)
<b>Totali shpenzime komisioni, neto</b>	<b>(181,789)</b>	<b>(137,717)</b>
<b>Shpenzime administrative</b>		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	(379,255)	(308,453)
Të tjera kompani të lidhura	(31,663)	(36,770)
<b>Totali shpenzime administrative</b>	<b>(410,918)</b>	<b>(345,223)</b>
<b>Totali</b>	<b>(739,549)</b>	<b>(463,873)</b>

**Personeli kyç i manaxhimit**

Vlera totale e transaksioneve dhe bilanceve të papaguara që lidhen me personelin drejtues kryesor ishin si më poshtë:

	2013	2012
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>		
Detyrimet nga	37,576	108,438
Detyrimet ndaj	(79,258)	(50,989)
<b>Tepricat neto</b>	<b>(41,682)</b>	<b>57,449</b>
<b>Shpenzime</b>		
Pagat dhe shpërblimet	(307,192)	(225,305)
<b>Totali</b>	<b>(307,192)</b>	<b>(225,305)</b>

**40. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Ne 27 Shkurt 2014, aksionarët e Raiffeisen Leasing sh.a miratuan ndarjen e 75% të fitimit neto pas tatimit për vitin 2013 për Raiffeisen Bank sh.a. për t'u shpërndarë në formën e dividendit në shumën 47,665 mijë lekë.

Ne 28 Shkurt 2014, aksionarët e Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive" sh.a. miratuan ndarjen e fitimit neto pas tatimit për vitin 2013 për Raiffeisen Bank sh.a. për t'u shpërndarë në formën e dividendit në shumën 122,982 mijë lekë.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat kërkojnë rregullim apo paraqitje në pasqyrat e konsoliduara financiare.





#### **Raiffeisen Bank, sponsorizime në Sarandë**

Raiffeisen Bank ka vijuar më tej me kontributin e saj edhe në qytetin e Sarandës. Në kuadër të bashkëpunimit me Bashkinë e këtij qyteti, Raiffeisen Bank ka sponsorizuar rikonstruksionin e pishinave të qytetit. Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm Kryetari i Bashkisë, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank.

# Raiffeisen Leasing

Gjatë vitit 2013, Raiffeisen Leasing Albania ja doli mbanë të mbajë dhe forcojë më tej pozitën e tij si numri një në tregun shqiptar të finacimit nëpërmjet qirasë financiare, me më tepër se 45 përqind të tregut vendas

Për herë të parë Raiffeisen Leasing ka shpërndarë dividend tek aksioneret e tij.

Vlera e financuar për vitin 2013, ka arritur shifrat 8.48 milion Euro, ku 7.59 milion Euro janë për mjete të lëvizshme dhe 0.89 milion Euro për pajisje.

Qëllimi i Raiffeisen Leasing ka qenë kryesisht në forcimin e bashkëpunimit afatgjatë me klientët e Grupit Raiffeisen, duke ofruar mbështetje të frytshme për nevojat e tyre në biznes. Gjithashtu, për të qenë më pranë, Raiffeisen Leasing, i ka kushtuar kujdes të veçantë forcimit dhe vendosjes së bashkëpunimit strategjik me rrjetin e koncensionarëve të shitjeve të makinave që operojnë në Shqipëri.

Viti 2013 ka qenë një vit me sfida për tregun shqiptar të automjeteve, i cili shënoi një rënie prej më shumë se 15 përqind për makinat e reja. Kriza ekonomike e vendeve fqinjë dhe legjislacioni shqiptar, ka favorizuar importin e makinave të përdorura, gjë që është reflektuar dhe në ecurinë e tregut të makinave të reja

Raiffeisen Leasing, i ofron klienteve të saj produkte dhe shërbime me cilësi superiore, si dhe informacion të plotë lidhur me strukturën dhe thjeshtësinë e të gjitha veprimeve të qirasë financiare.

Produktet kryesore të Raiffeisen Leasing janë financimi i mjeteve të lëvizshme dhe pajisjeve.

Të gjithë produktet e lizingut u janë ofruar segmenteve të biznesit si korporatat dhe bizneset e mesme, ndërkohë që individët e përdorin kryesisht për makina personale.

Një tjetër iniciativë gjatë këtij viti, me qëllim rritjen e gamës së produkteve të ofruara është financimi i mjeteve lundruese, gjë që na bën të vetmen kompani lizingu në vend që ofron këtë lloj shërbimi.

Pjesë e aktivitetit është edhe rimarketimi e rishitja e mjeteve. Përsa i përket rishitjes është implementuar procedura që e kanë pozicionuar Raiffeisen Leasing si ekspert për vendosjen e standardeve në treg. Gjithsesi kompania ka përdorur njohuritë dhe eksperiencën e Raiffeisen Leasing International si dhe të kompanive të tjera të lizingut që operojnë në rajon lidhur me produktet dhe shërbimet e qirasë financiare, si dhe në fushën e marketingut. Për më tepër, kompania ka akses të plotë në rrjetin e madh të furnitorëve ndërkombëtarë të makinave me tonazh të rëndë, makinerive dhe paisjeve, me të cilët Grupi Raiffeisen ka lidhje të qëndrueshme, në dobi të klientëve ekzistues dhe potencialë të kompanisë për realizimin e planeve të tyre investuese.

Deri në fund të vitit 2013, Raiffeisen Leasing ka patur 17 punonjës, që i ofrojnë klientëve shërbime të shpejta dhe të përshtatshme për nevojat e tyre.

Raiffeisen Leasing publikon një gamë të gjerë materiale si të printuar ashtu edhe në faqen e internetit [www.raiffeisen-leasing.al](http://www.raiffeisen-leasing.al). Gjatë vitit 2013 Raiffeisen Leasing Sh.a ka ndërmarrë fushatë marketingu, kryesisht të bazuar dhe të koordinuar me politikat dhe aktivitetet e marketingut të konçesionarëve vendas si partnerët kryesorë në biznes.

Menaxhimi dëshiron të përfitojë nga kjo mundësi për të falenderuar klientët dhe partneret tanë të biznesit për bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë 2013 dhe sidomos për besimin që ata na kanë dhënë. Gjithashtu jemi shumë mirënjohës ndaj punonjësve tanë për përkushtimin dhe përpjekjet, duke shprehur bindjen tonë që ekipi i Raiffeisen Leasing do të ëe mundur që të jemi lider edhe për vitin 2014

Raiffeisen Leasing është krijuar me qëllim shtimin dhe promovimin e veprimtarisë së qirasë financiare në Shqipëri, dhe në të njëjtën kohë rritjen e gamës së shërbimeve të ofruara nga grupi i bankës Raiffeisen në këtë treg.

Raiffeisen Leasing Sh.a, themeluar në Prill të vitit 2006, është regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë numër 35733, datë 15.05.2006, me aksionerë Raiffeisen Bank Sh.a me 75 përqind të aksioneve dhe Raiffeisen Leasing International GmbH me 25 përqind të aksioneve.

## Drejtesit dhe administratorët më 31 dhjetor 2013

### Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikqyrës)

Dieter Scheidl	Kryetar
Alketa Gjoçaj	Anëtare
Elona Koçi	Anëtare

### Bordi Drejtues

Ankleida Shehu	Drejtores e Përgjithshme
Merita Bejtja	Zv. Drejtores e Përgjithshme

## Perspektivat për vitin 2014

Në sajë të standardeve të larta profesionale dhe ekspertizës së grupit, që janë shumë të forta edhe në kohë të vështirë, Raiffeisen Leasing do të jetë në pozita që të mbështesë në mënyrë aktive bizneset në planet e tyre të investimeve edhe gjatë 2014, duke ofruar financimin e mjeteve të lëvizshme dhe pajisjeve. Raiffeisen Leasing do të jetë tërësisht i përkushtuar në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit afatgjatë me klientët dhe konçesionarët dhe do të vazhdojë në mënyrë aktive t'ju përgjigjet nevojave të tyre me gamën e produkteve dhe shërbime.

Duke patur parasysh ndryshimet e mjedisit të biznesit, objektivat kryesore do të jenë rritja e biznesit, përmirësimi i shitjeve të kryqezura me të gjithë segmentet e bankës, përmirësimin e vazhdueshëm të produkteve ekzistuese dhe zhvillimin e të reja, manaxhimin e riskut të përshtatshëm, reduktimi i kostove dhe përmirësimi i efikasitetit. Raiffeisen Leasing është tërësisht i dedikuar për të mbajtur qëndrueshmërinë e portofolit aktual duke aplikuar principin e cilësisë, në vend të madhësisë dhe politike risku të fortë.

Ekspierienca dhe mbështetja e Grupit Raiffeisen, baza e fortë e kapitalit dhe cilësia e portofolit përfaqësojnë garanci që Raiffeisen Leasing do të mbetet një partner i sigurt dhe i përgjegjshëm për klientët dhe konçesionarët në periudhën në vazhdim.

# Rreth Raiffeisen INVEST Sh.a

2013-a ishte një vit i shkëlqyer për Raiffeisen INVEST Sh.a. Vetëm në vitin e dytë të aktivitetit si shoqëria e vetme administruese e licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për administrimin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (fondeve të investimit) dhe Fondeve të Pensionit Vullnetar, Raiffeisen INVEST regjistroi rritje të lartë të asetëve nën menaxhim dhe numrit të investitorëve.

Asetet nën menaxhim tejkaluan shifrën 360 milione Euro, ndërsa numri i investitorëve, të cilët i besuan Raiffeisen INVEST menaxhimin e investimit të tyre tejkaloi 30,000.

Fondet e investimit vazhdojnë të jenë relativisht pak të njohura nga investitori shqiptar, i cili është tradicionalisht i fokusuar në produkte bankare. Megjithatë, suksesi i vazhdueshëm i Raiffeisen INVEST gjatë vitit 2013 tregoi që ky produkt i ri i tregut të kapitalit tashmë ka zënë një vend të pamohueshëm në planet financiare të investitorëve vendas. Fondet e investimit i ofrojnë publikut mundësi për të investuar kursimet e tyre në Lek dhe në Euro në mënyrë fitimprurëse, dhe njëkohësisht të diversifikojnë investimet jashtë spektrit të produkteve thjesht bankare.

Fondet e Raiffeisen INVEST janë krijuar për investitorin e gjerë, me një propozim vlere të qartë, dhe me fare pak kompleksitet, çka e bën procesin e investimit të lehtë, komod dhe kohë kursyes. Rritja e lartë e regjistruar gjatë vitit 2013 është tregues i qartë i apelit të gjerë që fondet e investimit kanë, dhe ky apel mund t'i atribuohet kthimit të lartë të fondeve, tarifave të ulta, dhe avantazhit që paraqet likuiditeti. Gjatë vitit 2013, Raiffeisen INVEST përbushi premtimin e saj për të gjeneruar një kthim neto që tejkalonte gjerësisht normat e interesit të depozitave me afat të ofruara nga bankat e nivelit të dytë, dhe çka është më e rëndësishme, kjo u arrit me shumë pak ose aspak luhatshmëri të çmimeve. Kjo reflekton qasjen e kujdesshme të shoqërisë administruese në lidhje me politikat e investimit dhe menaxhimit të riskut.

## Performanca e Fondeve

Më konkretisht, gjatë vitit 2013 fondet e gjeneruan një kthim neto nga investimi (pas zbritjes së tarifës së administrimit) si më poshtë:

- Fondi vullnetar i Pensionit: 8.7 përqind,
- Fondi i investimit Raiffeisen Prestigj: 8.1 përqind
- Fondi i investimit Raiffeisen Invest Euro: 2.9 përqind

Politika e investimit, e miratuar gjatë vitit 2013 ishte në përputhje me synimin e përgjithshëm të secilit fond për t'i ofruar investitorit të ardhura më të larta nëpërmjet investimit të asetëve të tij në përputhje me këtë objektiv dhe objektivin e ruajtjes së likuiditetit. Përbërja e portofoleve të investimeve përshtaten sipas nevojës, dhe pasqyrojnë zhvillimet e tregut, duke rezultuar në një përzgjedhje të kujdesshme të instrumenteve financiare. Në varësi të fondit, asetet mund të investohen në instrumente të ndryshme financiare në Lekë dhe në Euro, në tregun shqiptar dhe / ose tregjet ndërkombëtare.

## Përgjegjësia sociale

Përveçse një viti të suksesshëm, të karakterizuar nga një rritje e lartë e asetëve nën menaxhim dhe numrit të investitorëve, Raiffeisen INVEST dha një kontribut të rëndësishëm për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare gjatë vitit 2013, nëpërmjet një programi sponsorizimesh i cili u realizua në bashkëpunim të ngushtë me Raiffeisen Bank në Shqipëri. Raiffeisen INVEST mbështeti me donacione të konsiderueshme shoqata bamirësie, institucione të ndryshme jo-fitimprurëse si dhe projekte që kanë për qëllim përmirësimin e jetës ekonomiko-sociale të qytetarëve shqiptarë.

## Pritshmëritë për vitin 2014

Për shkak të vështirësive të brendshme dhe të jashtme, viti 2014 ka të ngjarë të jetë një vit sfidues për ekonominë shqiptare dhe tregjet financiare. Problemet e lindura gjatë 2013-s, të tilla si kërkesa e ulët konsumatore, niveli i lartë i kredive me probleme dhe një aktivitet anemik i biznesit mund të zgjasin edhe gjatë vitit 2014. Raiffeisen INVEST do të vazhdojë të ndjekë strategjinë e saj të rritjes, në përputhje me objektivat afatmesme të biznesit, duke pasur si qëllim përfundimtar përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë. Përveç ruajtjes së performancës së lartë të fondeve aktuale dhe shërbimit cilësor për investitorët, fokusi do të vihet në zgjerimin e gamës së produkteve me fonde të reja, me profil të ndryshëm rreziku të cilat do të projektohen për t'u ofruar investitorëve më shumë mundësi diversifikimi të investimeve të tyre.

Çdo produkt i ri do të ofrojë mundësi të reja dhe interesante investimi për investitorët, dhe ata do të mund të zgjedhin midis një game më të gjerë fondesh të cilët do të reflektojnë politika të ndryshme investimi dhe rreziku, dhe për rrjedhojë potencial të ndryshëm kthimi nga investimi. Raiffeisen INVEST do të synojë të shfrytëzojë çdo mundësi për rritjen e biznesit, duke u mbështetur në kërkesën e qëndrueshme për fondet aktuale të investimeve, si dhe në mundësinë e krijimit të biznesit të ri nëpërmjet fondeve të reja që do të hapen në të ardhmen.

*\* Misioni i Raiffeisen Invest është të jetë lider në tregun shqiptar, duke i ofruar klientëve një shërbim të shkëlqyer dhe manaxhim cilësor të aseteve të tyre, si dhe duke i garantuar për integritet, profesionalizëm dhe transparencë gjatë të gjithë etapave të procesit të investimit.*

# Një vështrim mbi Raiffeisen Bank International

Një bankë lidere në Evropën Qëndrore dhe Lindore, përfshirë Austrinë

Raiffeisen Bank Shqipëria është një degë e Raiffeisen Bank International AG (RBI), e cila e konsideron Evropën Qëndrore dhe Lindore (duke përfshirë Austrinë), si tregun e saj amëtar. Për gati 25 vjet, RBI ka funksionuar në rajonin e Evropës Qëndrore dhe Lindore (CEE), ku sot ajo mban një rrjet të ndërthurur ngushtësisht të bankave ndihmëse, të kompanive të lisingut dhe të ofruesve të shumtë të shërbimit financiar të specializuar në 15 tregje. Si një bankë universale, RBI renditet ndër bankat kryesore në rajon. Roli i fuqishëm që luan banka është mbështetur nga brandi Raiffeisen, i cili është një prej brandeve më të njohura gjerësisht në rajon. Me kalimin e kohës, RBI e ka pozicionuar veten si një grup bankar i shitjeve me pakicë dhe i korporateve, i cili është integruar plotësisht në Evropën Qëndrore dhe Lindore. Banka jo vetëm që ka qasje të mirë ndaj konsumatorëve të shitjeve me pakicë dhe të korporatave, por gjithashtu ofron një paketë të plotë të produktit. Në fund të vitit 2013, një personel prej rreth 55,000 vetësh i shërbeu afërsisht 14.6 milionë klientëve në rreth 3,000 njësi të biznesit në Evropën Qëndrore dhe Lindore.

Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore të korporatave dhe të investimeve. Ajo u shërben kryesisht klientëve austriakë, por edhe atyre ndërkombëtarë, si dhe klientëve kryesorë shumëkombësh që veprojnë në CEE. Për më tepër, RBI është e përfaqësuar në qendrat financiare botërore dhe operon degë dhe zyra përfaqësuese në Azi. Numri total i personelit të punësuar nga RBI është rreth 58,000 vetë dhe asetit total i saj ka një vlerë prej rreth 131 miliard Euro.

Degët bankare të RBI-së veprojnë në tregjet e mëposhtme të CEE:

• Shqipëri	Raiffeisen Bank Sh.a.
• Bjellorusi	Priorbank, JSC
• Bosnje dhe Hercegovinë	Raiffeisen Bank d.d Bosna i Hercegovina
• Bullgari	Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD
• Kroaci	Raiffeisenbank Austria d.d
• Republika Çeke	Raiffeisenbank a.s.
• Hungari	Raiffeisen Bank Zrt.
• Kosovë	Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
• Poloni	Raiffeisen Bank Polska S.A.
• Rumani	Raiffeisen Bank S.A.
• Rusi	ZAO Raiffeisenbank
• Serbi	Raiffeisen banka a.d
• Sllovaki	Tatra banka, a.s.
• Slloveni	Raiffeisen Banka d.d
• Ukrainë	Raiffeisen Bank Aval JSC

Si kompani mëmë e këtyre bankave, përqindja e aksionve të RBI-së në këto banka arrin në, ose afërsisht 100 për qind në shumicën e rasteve.



### **Raiffeisen Bank sponsorizon ngritjen e këndit të lojrave në qytetin e Lezhës**

Raiffeisen Bank me mbështetjen e saj ndaj Bashkisë Lezhë ka bërë të mundur ngritjen e një këndi të ri lojrash për fëmijët e këtij qyteti në afërsi të përmendores së Skënderbeut dhe zonës arkeologjike, në lulishten kryesore të Lezhës.

Z. John McNaughton, Antar Bordi për Retail në Raiffeisen Bank shprehu kënaqësinë që ishte prezent në atmosferën festive të fëmijëve të Lezhës, gjatë përrurimit të këtij këndi të ri lojrash, dhe njëherësh premtoi se bashkëpunimi me Bashkinë e Lezhës do të vazhdojë sërish edhe në realizimin e projekteve të tjera, të ngjashëm me këtë që po përurojmë sot. Prindër të fëmijëve falenderuan Bashkinë e Lezhës dhe Raiffeisen Bank për financimin dhe zbatimin e këtij projekti, në një vend mjaft piktoresk dhe të përshtatshëm për argëtimin e fëmijëve.

# Zhvillimi i RBI-së

RZB u formua në vitin 1927 si “Genossenschaftliche Zentralbank”. Raiffeisen e fitoi terrenin e saj të parë në Evropën Qëndrore dhe Lindore në vitin 1987. Degë të tjera të saj janë krijuar që nga ai vit. Nga viti 2000 e këtej, shtrirja e Raiffeisenit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore është arritur kryesisht duke blerë bankat ekzistuese, të cilat u shkrinë në një kompani aksionere, të cilat që nga viti 2003 operjnë nën emrin e Raiffeisen International. Në Prill të vitit 2005 Raiffeisen International u përfshi në listat e bursës në mënyrë që të mund të financonte zgjerimin e saj në të ardhmen në mënyrë sa më efikase. Si rrjedhojë, RBI u krijua në vitin 2010 përmes bashkimit të Raiffeisen International me fushat kryesore të biznesit të Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB).

RBI është përfshirë në listën e bursës së Vjenës që më 25 Prill 2005 (deri më 12 Tetor 2010 si Raiffeisen International). RZB-ja e cila funksionon si instituti qendror i Austrian Raiffeisen Banking Group (RBG), vazhdon të mbajë shumicën e aksioneve pas bashkimit, duke mbajtur rreth 78.5 përqind të aksioneve, deri në 31 Dhjetor 2013. Pjesa tjetër e mbetur e aksioneve të RBI-së, prej 21.5 përqind, ndodhen në qarkullim të lirë. Si pasojë e rritjes së kapitalit në fillim të vitit 2014 aksionet e lira u rritën ndjeshëm në rreth 39.3 përqind pasi RZB-ja hoqi dorë nga të drejtat e saj dhe morri një shumë prej vetëm 750 milion Euro. Në fund të afatit RZB-ja mbajti 60.7 përqind të aksioneve të RBI-së.

Për më shumë informacion ju lutemi referojuni [www.rbinternational.com](http://www.rbinternational.com) dhe [www.rzb.at](http://www.rzb.at).



# Rrjeti i Raiffeisen Bank Sh.a

## **Distrikti Tirana 1**

"Rruga e Kavajës" Tiranë  
 Tel: +355 4 2253 644/6;  
 +355 4 2233 396;  
 +355 4 2224 540  
 Fax: +355 4 2230 013;  
 +355 4 2247 912

## **Distrikti Tirana 2**

Kompleksi "Gintash" Laprakë, Tiranë  
 Tel: ++355 4 2357828

## **Distrikti Perëndimor**

L3, Rruga Hamdi Troplini,  
 pranë Bashkisë Durrës  
 Tel: +355 52 254 95;  
 +355 52 25 027  
 L. "28 Nëntori", Berat  
 Tel: +355 32 32628

## **Distrikti Jugor**

Lagja 18 Shtatori, Qender, Gjirokaster  
 Tel: + 355 84 682 86  
 + 355 84 625 97

## **Distrikti Verior**

Sheshi Demokracia,  
 Hotel Rozafa, Shkoder  
 Tel: +355 22 43171;  
 +355 22 43764  
 L. 5, Kukës  
 Tel: +355 24 22279

## **Distrikti Elbasan**

Lagja «Qemal Stafa»,  
 Rruga 11 Nentori, Elbasan  
 Tel: +355 54 42260

## **Distrikti Jug lindor**

Shëtitore "Fan Noli", Sky Center, Korçë  
 Tel: +355 82 43179  
 Fax: +355 82 45870

Ju lutem vizitoni web site-in tonë: [www.raiffeisen.al](http://www.raiffeisen.al)

# Adresa dhe Kontakte

## Raiffeisen Bank International AG

### Austria

Am Stadtpark 9  
1030 Vienna  
Tel: +43-1-71 707-0  
Fax: +43-1-71 707-1715  
www.rbinternational.com  
ir@rbinternational.com  
rbi-pr@rbinternational.com

## Rrjeti Bankar

### Shqipëri

**Raiffeisen Bank Sh.a.**  
"European Trade Center"  
Bulevardi "Bajram Curri"  
Tirana  
Tel: +355-4-23 8 1000  
Fax: +355-4-22 755 99  
SWIFT/BIC: SGSBALTX  
www.raiffeisen.al

### Bjellorusi

**Priorbank JSC**  
V. Khoruzhey Str. 31-A  
220002 Minsk  
Tel: +375-17-28 9-9090  
Fax: +375-17-28 9-9191  
SWIFT/BIC: PJCBY2X  
www.priorbank.by

## Bosnje dhe Hercegovinë

### Raiffeisen BANK d.d.

Bosna i Hercegovina  
Zmajka od Bosne bb  
71000 Sarajevo  
Tel: +387-33-287 101  
Fax: +387-33-21 385 1  
SWIFT/BIC: RZBABA2S  
www.raiffeisenbank.ba

### Bullgari

**Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD**  
Ulica N. Gogol 18/20  
1504 Sofia  
Tel: +359-2-91 985 101  
Fax: +359-2-94 345 28  
SWIFT/BIC: RZBBBGSF  
www.rbb.bg

### Kroaci

**Raiffeisenbank Austria d.d.**  
Petrinjska 59  
10000 Zagreb  
Tel: +385-1-45 664 66  
Fax: +385-1-48 116 24  
SWIFT/BIC: RZBHHR2X  
www.rba.hr

### Republika Çeke

**Raiffeisenbank a.s.**  
Hv zdova 1716/2b  
14078 Prague 4  
Tel: + 420-221-141-111  
Fax: +420-221-142-111  
SWIFT/BIC: RZBCCZPP  
www.rb.cz

### Hungari

Raiffeisen Bank Zrt.  
Akadémia utca 6  
1054 Budapest  
Tel: +36-1-48 444-00  
Fax: +36-1-48 444-44  
SWIFT/BIC: UBRTHUHB  
www.raiffeisen.hu

### Kosovë

**Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.**  
Rruga UÇK, No. 51  
10000 Pristina  
Tel: +381-38-22 222 2  
Fax: +381-38-20 301 130  
SWIFT/BIC: RBKORS22  
www.raiffeisen-kosovo.com

### Poloni

**Raiffeisen Bank Polska S.A.**  
Ul. Pi kna 20  
00-549 Warsaw  
Tel: +48-22-58 5-2000  
Fax: +48-22-58 5-2585  
SWIFT/BIC: RCBWPLPW  
www.raiffeisen.pl

### Rumani

**Raiffeisen Bank S.A.**  
246 C Calea Floreasca  
014476 Bucharest  
Tel: +40-21-30 610 00  
Fax: +40-21-23 007 00  
SWIFT/BIC: RZBRROBU  
www.raiffeisen.ro

### Rusi

**ZAO Raiffeisenbank**  
Smolenskaya-Sennaya Sq. 28  
119002 Moscow  
Tel: +7-495-72 1-9900  
Fax: +7-495-72 1-9901  
SWIFT/BIC: RZBMRUMM  
www.raiffeisen.ru

### Serbi

**Raiffeisen banka a.d.**  
Djordja Stanojevic 16  
11070 Novi Beograd  
Tel: +381-11-32 021 00  
Fax: +381-11-22 070 80  
SWIFT/BIC: RZBSRSBG  
www.raiffeisenbank.rs

### Slllovaki

**Tatra banka, a.s.**  
Hodžovo námestie 3  
P.O. Box 42  
85005 Bratislava 55  
Tel: +421-2-59 19-1111  
Fax: +421-2-59 19-1110  
SWIFT/BIC: TATRSKBX  
www.tatrabanka.sk

### Slloveni

**Raiffeisen Banka d.d.**  
Zagrebska cesta 76  
2000 Maribor  
Tel: +386-2-22 931 00  
Fax: +386-2-30 344 2  
SWIFT/BIC: KREKS122  
www.raiffeisen.si

### Ukrainë

**Raiffeisen Bank Aval JSC**  
9, Vul Leskova  
01011 Kiev  
Tel: +38-044-49 088 88  
Fax: +38-044-295-32 31  
SWIFT/BIC: AVALUAUK  
www.aval.ua

## Kompani Lizingu

### Austria

#### **Raiffeisen-Leasing International GmbH**

Am Stadtpark 3  
1030 Vienna  
Tel: +43-1-71 707-2071  
Fax: +43-1-71 707-76 2966  
www.rli.co.at

### Shqipëri

#### **Raiffeisen Leasing Sh.a.**

"European Trade Center"  
Bulevardi "Bajram Curri"  
Tirana  
Tel: +355-4-22 749 20  
Fax: +355-4-22 325 24  
www.raiffeisen-leasing.al

### Bjellorusi

#### **JLLC "Raiffeisen-Leasing"**

V. Khoruzhey 31-A  
220002 Minsk  
Phone: +375-17-28 9-9394  
Fax: +375-17-28 9-9974  
www.rl.by

### Bosnje dhe Hercegovinë

#### **Raiffeisen Leasing d.o.o.**

**Sarajevo**  
Danijela Ozme 3  
71000 Sarajevo  
Tel: +387-33-25 435 4  
Fax: +387-33-21 227 3  
www.rlbh.ba

### Bullgari

#### **Raiffeisen Leasing Bulgaria OOD**

Mladost 4, Business Park Sofia  
Building 7B, 4th floor  
1766 Sofia  
Tel: +359-2-49 191 91  
Fax: +359-2-97 420 57  
www.rlbgbg

### Kroaci

#### **Raiffeisen Leasing d.o.o.**

Radnicka cesta 43  
10000 Zagreb  
Tel: +385-1-65 9-5000  
Fax: +385-1-65 9-5050  
www.rl-hr.hr

### Republika Çeke

#### **Raiffeisen-Leasing s.r.o.**

Hvězdova 1716/2b  
14078 Prague 4  
Tel: +420-221-511-611  
Fax: +420-221-511-666  
www.rl.cz

### Hungari

#### **Raiffeisen Lizing Zrt.**

Váci ut 81-85  
1139 Budapest  
Tel: +36-1-298 8000  
Fax: +36-1-298 8010  
www.raiffeisenlizing.hu

### Kazakistan

#### **Raiffeisen Leasing Kazakhstan LLP**

Shevchenko Str. 146, No. 12  
050008 Almaty  
Tel: +7-727-37 8-5430  
Fax: +7-727-37 8-5431  
www.rlkz.at

### Kosovë

#### **Raiffeisen Leasing Kosovo**

Gazmend Zajmi n.n., Sunny Hill  
10000 Pristina  
Tel: +381-38-22 222 2  
Fax: +381-38-20 301 136  
www.raiffeisenleasing-kosovo.com

### Moldavi

#### **I.C.S. Raiffeisen Leasing S.R.L.**

Alexandru cel Bun 51  
2012 Chişinău  
Tel: +373-22-27 931 3  
Fax: +373-22-22 838 1  
www.raiffeisen-leasing.md

### Poloni

#### **Raiffeisen-Leasing Polska S.A.**

Ul. Prosta 51  
00-838 Warsaw  
Tel: +48-22-32 636-66  
Fax: +48-22-32 636-01  
www.rl.com.pl

### Rumani

#### **Raiffeisen Leasing IFN S.A.**

246 D Calea Floreasca 014476  
Bucharest  
Tel: +40-21-36 532 96  
Fax: +40-37-28 799 88  
www.raiffeisen-leasing.ro

### Rusi

#### **OOO Raiffeisen-Leasing**

Stanislavskogo Str. 21/1  
109004 Moscow  
Tel: +7-495-72 1-9980  
Fax: +7-495-72 1-9572  
www.raiffeisen-leasing.ru

### Serbi

#### **Raiffeisen Leasing d.o.o.**

Djordja Stanojevic 16  
11070 Novi Beograd  
Tel: +381-11-220 7400  
Fax: +381-11-228 9007  
www.raiffeisen-leasing.rs

### Slovakia

#### **Tatra-Leasing s.r.o.**

Hodžovo námestie 3  
81106 Bratislava  
Tel: +421-2-59 19-3168  
Fax: +421-2-59 19-3048  
www.tatraleasing.sk

### Sloveni

#### **Raiffeisen Leasing d.o.o.**

Zagrebška cesta 76  
2000 Maribor  
Tel: +386-1-28 162 00  
Fax: +386-1-24 162 68  
www.rl-sl.si

### Ukrainë

#### **LLC Raiffeisen Leasing Aval**

9, Moskovskiyi Av.  
Build. 5 Office 101  
04073 Kiev  
Tel: +38-044-59 024 90  
Fax: + 38-044-20 004 08  
www.rla.com.ua

## Kompani Lizingu për Pasuritë e Paluajtshme

### Republika Çeke

#### **Raiffeisen Leasing Real Estate s.r.o.**

Hvězdova 1716/2b  
14078 Prague 4  
Tel: +420-221-511-610  
Fax: +420-221-511-641  
www.rlre.cz

## Zyra e përfaqësimit në Evropë

### Francë

#### **Zyra përfaqësuese e RBI-së në Paris**

9-11 Avenue Franklin D. Roosevelt  
75008 Paris  
Tel: +33-1-45 612 700  
Fax: +33-1-45 611 606

### Gjermani

#### **Dega e RBI-së në Frankfurt**

Mainzer Landstraße 51  
60329 Frankfurt  
Tel: +49-69-29 921 918  
Fax: +49-69-29 921 9-22

### Suedi

#### **Zyra përfaqësuese e RBI-së**

në Vendet Nordike  
Drottninggatan 89, 14th floor  
113 60 Stockholm  
Tel: +46-8-440 5086  
Fax: +46-8-440 5089

**Mbretëria e Bashkuar  
Dega e RBI-së në Londër**

10 King William Street  
London EC4N 7TW  
Tel: +44-20-79 33-8000  
Fax: +44-20-79 33-8099

**Zyrat e përfaqësimit  
në Azi dhe Amerikë**

**Kina**

**Dega e RBI-së në Pekin**

Beijing International Club Suite 200  
2nd floor  
Jianguomenwai Dajie 21  
100020 Beijing  
Tel: +86-10-65 32-3388  
Fax: +86-10-65 32-5926

**Zyra përfaqësuese e RBI-  
së në Harbin**

Room 1104, Pufa Piazza No. 209  
Chang Jiang Street  
Nang Gang District  
150090 Harbin  
Tel: +86-451-55 531 988  
Fax: +86-451-55 531 988

**Dega e RBI-së në Hong  
Kong**

Unit 2102, 21st Floor,  
Tower One, Lippo Centre  
89 Queensway, Hong Kong  
Tel: +85-2-27 30-2112  
Fax: +85-2-27 30-6028

**Zyra e RBI-së në Xiamen**

Unit B, 32/F, Zhongmin Building,  
No. 72 Hubin North Road,  
Xiamen, Fujian Province  
361013, P.R. China  
Tel: +86-592-26 2-3988  
Fax: +86-592-26 2-3998

**Zyra përfaqësuese e RBI-  
së në Zhuhai**

Room 2404, Yue Cai Building  
No. 188, Jingshan Road, Jida,  
Zhuhai, Guangdong Province  
P.R. China  
Tel: +86-756-32 3-3500  
Fax: +86-756-32 3-3321

**Indi**

**Zyra përfaqësuese e RBI në  
Mumbai**

803, Peninsula Heights  
C.D. Barfiwala Road, Andheri (W)  
400 058 Mumbai  
Tel: +91-22-26 230 657  
Fax: +91-22-26 244 529

**Korea**

**Zyra përfaqësuese e RBI-së  
në Kore**

# 1809 Le Meilleur Jongno Tower  
24 Jongno 1-ga  
Seoul 110-888  
Republic of Korea  
Tel: +82-2-72 5-7951  
Fax: +82-2-72 5-7988

**Malajzi**

**Dega e RBI-së në Labuan**

Licensed Labuan Bank No. 110108C  
Level 6 (1E), Main Office Tower  
Financial Park  
Labuan  
Malaysia  
Tel: +607-29 1-3800  
Fax: +607-29 1-3801

**Singapor**

**Dega e RBI-së në Singapor**

One Raffles Quay  
#38-01 North Tower  
Singapore 048583  
Tel: +65-63 05-6000  
Fax: +65-63 05-6001

**SHBA**

**RB International Finance (USA)  
LLC**

1133 Avenue of the Americas,  
16th Floor  
10036 New York  
Tel: +01-212-84 541 00  
Fax: +01-212-94 420 93

**Përfaqësues i Zyrës së RZB**

**Austria në Nju Jork**

1133 Avenue of the Americas,  
16th Floor  
10036 New York  
Tel: +01-212-59 3-7593  
Fax: +01-212-59 3-9870

**Vietnam**

**Zyra përfaqësuese e RBI-së në  
Qytetin e Ho-Chi-Minh**

35 Nguyen Hue Str.,  
Harbour View Tower  
Room 601A, 6th Floor, Dist 1  
Ho-Chi-Minh-City  
Tel: +84-8-38 214 718,  
+84-8-38 214 719  
Fax: +84-8-38 215 256

**Raiffeisen  
Zentralbank AG**

**Austria**

Am Stadtpark 9  
1030 Vienna  
Tel: +43-1-26 216-0  
Fax: +43-1-26 216-1715  
www.rzb.at

**Kompani të  
Specializuara  
Raiffeisen**

**F.J. Elsner Trading GmbH**

Am Heumarkt 10  
1030 Vienna  
Tel: +43-1-79 736-0  
Fax: +43-1-79 736-230  
www.elsner.at

**Kathrein Privatbank  
Aktiengesellschaft**

Wipplingerstraße 25  
1010 Vienna  
Tel: +43-1-53 451-300  
Fax: +43-1-53 451-8000  
www.kathrein.at

**Raiffeisen Centrobank AG**

Tegetthoffstraße 1  
1015 Vienna  
Tel: +43-1-51 520-0  
Fax: +43-1-51 343-96  
www.rcb.at

**ZUNO BANK AG**

Muthgasse 26  
1190 Vienna  
Tel: +43-1-90 728 88-01  
www.zuno.eu

# Fjalori Raiffeisen

## Kryqi Gable

Kryqi Gable është pjesë e markës së përdorur kryesisht nga të gjitha kompanitë e Grupit të Bankave Raiffeisen dhe Grupit RZB në Evropën Qendrore dhe Lindore. Ai përfaqëson dy koka kuajsh, të kryqësuar dhe të ngjitura në kulmin e shtëpisë. Ai është një simbol i rrënjësor i traditës Evropiane: kryqi gable mbi çati besohet se mbron shtëpinë dhe antarët e saj nga reziqet e jashtme dhe për të shmangur të keqen. Ai simbolizon mbrojtjen dhe sigurinë që anëtarët e bankave Raiffeisen kanë nëpërmjet zgjedhjes së tyre për bashkëpunim. Sot kryqi gable është një nga markat më të njohura në Austri dhe e mirë njohur në Evropën Qendrore dhe Lindore.

## Raiffeisen Bank International

Raiffeisen International Bank AG (RBI) ka shtrirë aktivitetin e saj tregëtar në rajonet kryesore të Evropës Qendrore dhe Lindore përfshirë këtu edhe Austrinë. Në Evropën Qendrore dhe Lindore RBI operon si bankë universale që ka në vartësi një rrjet bankar, kompanish lizingu dhe disa shërbime të specializuara shërbimesh financiare në 15 vende. Në fund të vitit 2013 rreth 55,000 punonjës shërbyen rreth 14.6 milion klientë në rreth 3,000 qendra biznesi në CEE. Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore tregëtare dhe investuese. Mbit ë gjitha, RBI është e përfaqësuar në qendrat botërore financiare dhe operon me degë dhe zyra përfaqësie në Azi. Në total, RBI ka punësuar rreth 58,000 punonjës dhe ka një total asetesh afërsisht 131 miliard Euro.

RBI është përfshirë në listën e bursës së Vjenës që më 25 Prill 2005 (deri më 12 Tetor 2010 si Raiffeisen International). RZB, e cila funksionon si institucioni qendror i Austrian Raiffeisen Banking Group (RBG), vazhdon të mbajë shumicën e aksioneve pas bashkimit, pra rreth 78.5 përqind të aksioneve deri në 31 Dhjetor 2013. Pjesa tjetër e mbetur e aksioneve të RBI-së, prej 21.5 përqind, ndodhen në qarkullim të lirë. Si pasojë e rritjes së kapitalit në fillim të vitit 2014 aksionet e lira u rritën ndjeshëm në rreth 39.3 përqind pasi RZB-ja hoqi dorë nga të drejtat e saj dhe morri një shumë prej vetëm 750 milion Euro. Në fund të afatit RZB-ja mbajti 60.7 përqind të aksioneve të RBI-së.

## RZB

Themeluar më 1927, Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB) është institucioni qendror i Austrian Raiffeisen Banking Group (RBG) dhe vepron si qendra e grupit për të gjithë grupin RZB, duke përfshirë këtu edhe RBI-në. RZB funksionon si lidhja kryesore midis Austrian Raiffeisen Banking Group dhe RBI-së, me rrjetin e saj bankar në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe disa veprimtarive ndërkombëtare.

## Grupi RZB

Grupi zotërohet dhe drejtohet nga RZB-ja. Raiffeisen Bank International është njësisia më e madhe e këtij grupi.

## Raiffeisen Banking Group

Grupi Bankar Raiffeisen (RBG) është grupi më i madh bankar në Austri për nga totali i aktiveve. Bazuar në shifrat për fundvitin 2012, bilanci i konsoliduar i RBG në total arriti në 291 miliard Euro. Kjo përfaqëson rreth një të katërtën e të gjithë biznesit të brendshëm bankar në Austri dhe përbën rrjetin më të madh bankar me afërsisht 2,285 pika biznesi dhe rreth 29,700 punonjës. RBG përbëhet nga Bankat Raiffeisen në nivel lokal, Bankat Raiffeisen Rajonale, në nivel krahine dhe RZB si institucion qendror. RZB vepron gjithashtu si “ndërmjetës” mes operacioneve të saj ndërkombëtare dhe RBG-së. Bankat Raiffeisen janë institucione krediti kooperative private, të cilat funksionojnë si banka me një shërbim të përgjithshëm për individë. Çdo bankë Raiffeisen krahinore është pronare e bankës rajonale Raiffeisen respektive që në tërësinë e tyre zotërojnë rreth 90 përqind të aksioneve të RZB.

Banka Raiffeisen i ka fillimet nga iniciativa e një reformatori social Gjerman Friedrich Wilhelm Raiffeisen (1818-1888), i cili me krijimin e kooperativës bankare më 1862, vuri themelin e organizimit global të shoqërive kooperative Raiffeisen. Vetëm 10 vjet pas themelimit të kooperativës bankare Austriake Raiffeisen në 1886, rreth 600 banka kursimi dhe krediti funksiononin sipas sistemit Raiffeisen në të gjithë vendin. Sipas parimit themelor të vetë-ndihmës, promovimi i interesave të anëtarëve është objektivi kryesor i politikave të tyre të biznesit.





EUROPEAN SENIOR  
WEIGHTLIFTING  
CHAMPIONSHIPS

TIRANA 2013  
ALBANIA

### **Raiffeisen Bank sponsor kryesor i Kampionatit Evropian të Peshëngritjes**

Me një ceremoni të denjë për një eveniment të përmasave gjigande që zhvillohet për herë të parë në Shqipëri, është zhvilluar Kampionati Evropian i Peshëngritjes ku Raiffeisen Bank ka qenë sponsor gjeneral dhe ku për herë të parë në Shqipëri organizohet një ngjarje e këtij niveli dhe është një lajm i shkëlqyer për sportin e peshëngritjes, një nga sportet më popullore, ku Shqipëria ka arritur rezultatet më të mira në dekada.

### **Raiffeisen Bank general sponsor of the European Weightlifting Championships**

Raiffeisen Bank has been the general sponsor of the European Weightlifting Championships, a unique event happening for the very first time in Albania. This was excellent news for the sport of weightlifting, one of the most popular sports, where Albania has achieved the best results in decades.

